

UNited Nations
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration Intérimaire
des Nations Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 19 DHE 23 DHJETOR 2002

T R A N S K R I P T

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 19. I 23. 12. 2002. GODINE

DHJETOR – DECEMBAR
2002



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

PROPOZIMI I RENDIT TË DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Procesverbali nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Inspektoriatin e Punës në Kosovë (2002/9)
4. Parashtrimi i pyetjeve

Vrejtje : *Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë*

“Pyetjet për përgjigjet me gojë duhet ti dorzohen Zyrës për parashtrësia të paktën pesë ditë pune por jo më shumë se dhjetë ditë pune para kohës kur duhet përgjigjur në to “.
(Rregulla 19.2 nga Rregullorja e përkohshme e punës)

ПРЕДЛОГ ДНЕВНОГ РЕДА

1. Усвајање дневног реда
2. Записник од претходне седнице
3. Друго разматрање – Нацрта Закона о Инспекцији Рада на Косову (2002/9)
4. Постављање питања

Опомена : *Питања утучена Владџа за усмене одговоре*

“Питања која захтевају усмени одговор морају да буду достављена у пријемну канцеларију барем пет радних дана, али не више од десет радних дана пре него што се ођекује одговор”
(Правило 19.2 са Привремени пословник)



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Vazhdimi i Seancës Plenare nga 19 dhjetori 2002
2. Parashtrimi i pyetjeve

Vrejtje : Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë

“Pyetjet për përgjigjet me gojë duhet ti dorzohen Zyrës për parashtrësia të paktën pesë ditë pune por jo më shumë se dhjetë ditë pune para kohës kur duhet përgjigjur në to “.
(Rregulla 19.2 nga Rregullorja e përkohshme e punës)

ДНЕВНИ РЕД

1. Наставак Седнице Скупштине са 19 децембра 2002 год.
2. Постављање питања

Опомена : Питања упучена Влади за усмене одговоре

“Питања која захтевају усмени одговор морају да буду достављена у пријемну канцеларију барем пет радних дана, али не више од десет радних дана пре него што се очекује одговор”
(Правило 19.2 са Привремени пословник)

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 19 DHE 23 DHJETOR 2002

Seanca filloi punën në orën 10,10.

Seancën e kryesoi Akademik NEXHAT DACI, kryetar i Kuvendit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes dhe mirë se keni ardhur në Seancën e rregullt plenare. Mendoj se temperatura e ulët në sallë është një vërejtje që duhet t'i kryejmë punët tona dhe besoj se do të ulet temperatura e debatit mbi ligje dhe çështje tjera. Do të thotë është një inhibitor i proceseve.

Shpresoj se materialet e duhura për rendin e ditës me kohë i keni marrë. Si gjithmonë, pikë e parë e rendit të ditës është – Miratimi i agjendës për këtë seancë plenare.

Urdhëroni, profesor Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI:

I nderuari kryetar, kolegë deputetë,
Jemi në fund të vitit kur duhet të aprovohet buxheti i Kosovës për vitin 2003. Në bazë të Kornizës kushtetuese, kreu V, pika 5 a) dhe b) Kuvendi i Kosovës ka përgjegjësitë rreth diskutimit dhe aprovimit të buxhetit të Kosovës. Si organ më i lartë përfaqësues, Kuvendi mban përgjegjësinë për shfrytëzimin e taksave të cilat qytetarët po paguajnë thuaja në mënyrë vullnetare, në një sistem ende jofunksional të mbledhjes së tyre.

Në emër të Grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kërkoj që, me procedurë të shpejtë, të vëhet në rend dite të Kuvendit të sotëm buxheti i Kosovës për vitin 2003 dhe Ligji për buxhetin e Kosovës për vitin 2003.

Besoj se do të pajtoheni me këtë propozim. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemndereit. Urdhëroni, zonja Flora.

FLORA BROVINA:

Zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Çështja të cilën desha ta shtroj kishte të bëjë për buxhetin, në rend të parë. Dhe, çështja e dytë është për personat që janë të zhdukur, në të vërtetë, janë persona të kidnapuar e për të cilët s'dijmë asgjë.

Kur është fjala për buxhetin, jemi në fund të vitit e ende nuk dijmë dhe s'kemi njohuri, nuk kemi debatuar e as që kemi aprovuar buxhetin e Kosovës për vitin 2003. Shtrohet pyetja – a guxojmë të hyjmë në vitin e ri pa buxhet, pa e aprovuar atë dhe në rend të parë si është përcaktuar përqindja e buxhetit me të cilin menaxhon kryeadministratori. A kemi ndonjë informatë për procedurat dhe destinimin e këtyre mjeteve. Kur është fjala për mjetet e qytetarëve të Kosovës gjithçka duhet të jetë transparente dhe në harmoni me procedurat paraprake të njohura për ne. Nëse janë të vërteta dyshimet se këto përqindje do të përdoren për projekte mediale multietnike ose të integritetit, siç thuhet, unë mendoj se kemi probleme shumë më emergjente, kurse programet në fjalë mund të përkrahen proporcionalisht dhe me integrimin e participimin e komunitetit në fjalë, në buxhetin e Kosovës.

Propozoj që kjo çështje të vëhet në rend të ditës dhe njëherit përkrahu Grupin parlamentar të Lidhjes Demokratike.

Sa i përket pikës numër dy, zoti kryetar dhe Kryesi e nderuar, ju e dini se Komisioni për personat e rrëmbyer dhe të zhdukur gjatë luftës, ka kërkuar që të vëhet në rend dite çështja e problematikës së këtyre personave që është mjaft urgjente dhe shumë e dhembshme për Kosovën. Ajo po prolongohet të shqyrtohet tani e tre vjet. Më datë 18.11. kemi kërkuar dhe ende s'kemi marrë përgjigje lidhur me këtë. Ndoshta mund të na përgjigjeni ju publikisht. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Udhëroni, zoti Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

Edhe Grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës pajtohet me kërkesën e Grupit të LDK-ës dhe PDK-ës që të futet kjo çështje në rend të ditës. Normalisht, ndoshta në këtë seancë nuk do të mund ta përmbyllim këtë çështje si çështje shumë me rëndësi, por do të vazhdohej debati edhe në seancën tjetër.

Kam një çështje dhe i kisha bërë lutje këtu edhe Kryesisë, kryetarit dhe Kuvendit, por edhe të gjithë deputetëve: Çështjet që diskutohen në këtë Kuvend të përfundojnë këtu e mos të ndodhë sikur rasti presedan kur në dy seanca plenare diskutuam për emërimin e gjyqtarëve dhe ndodhi ajo që kryeadministratori t'na anashkaloi e të bëjë shkelje edhe të Kornizës kushtetuese edhe të akteve e parimeve elementare të demokracisë duke anashkaluar vullnetin e këtij Kuvendi. Unë mendoj se atë që ka bërë nuk është një punë legjitime dhe ata gjyqtarë nuk janë legjitimë pa marrë besimin nga ky Kuvend. Ky është qëndrim yni dhe ju kisha lutur që çështjet në të cilat shtrohen për debat t'i debatojmë dhe të qëndrojmë deri në fund në ato parime, pa marrë parasysh se ç' do të ndodhë më tej. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Udhëroni, zoti Hasan.

HASAN META:

I nderuari zoti kryetar, e nderuara Kryesi, zonja e zotërinj deputetë, Unë përkras këto dy iniciativa por do thoja - a jemi të gatshëm sot, pa materialin e duhur, ta shqyrtojmë buxhetin e Kosovës? Këtë do ta shikojmë më tutje!?. Unë më shumë dola për një shkak tjetër këtu. E kam patur një kërkesë më parë për çështjen e decentralizimit që të debatohet në Kuvend. Kryesia ka shqyrtuar atë dhe për të nuk kam marrë përgjigje. Besoj është temë shumë me rëndësi e cila ka krijuar konfuzion në popullatë, është shumë e paqartë dhe kishte qenë e udhës që ta kemi në ndonjë seancë të këtij Parlamenti për diskutim. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Urdhëroni. E ka fjalën zoti ministër, Ali Sadriu.

ALI SADRIU:

Kryesi e nderuar, kolegë deputetë të nderuar, Kam kënaqësinë që kemi rastin sot të bisedojmë për një çështje shumë të rëndësishme dhe legjitime në këtë institucion siç është Kuvendi. Me kënaqësi do pranojmë që të diskutojmë çdoherë për proceset e tilla, sepse ato janë procese jetike që rregullojnë të tanishmen dhe të ardhmen tonë.

Ju lutem, kam një kërkesë. Ministria për Ekonomi e Financa dhe Qeveria nuk obligohen me asnjë rregullore dhe asnjë ligj që të bëjnë diçka të tillë. Kjo nuk do të thotë se do t'i ikim këtij obligimi. Përkundrazi, unë jam i gatshëm që të vij dhe të raportoj në detaje për të gjitha ato që kanë ndodhë dhe do të ndodhin. E shtroj këtë për të marrë vëmendjen tuaj për një moment. Ligji mbi buxhetin është Ligj sistemor që rregullon dhe u japë fuqi Ministrisë për Ekonomi e Financa dhe Qeverisë, e në këtë rast, edhe Kuvendit për të operuar me proceset të tilla. Ligji ka

qenë i gatshëm edhe më herët. Kur them - më herët, ai ka qenë diku në prill, është shtyrë, është zhagitur, ka kaluar shumë labirintha e shumë diskutime dhe si i tillë, më në fund, ka një version i cili mund të distribuohet në tri gjuhët dhe të diskutohet e të na japë një fuqi ligjore në bazë të të cilit do të veprojmë. Mendoj se kjo duhet të jetë parësore.

Së dyti, ose paralel me të, ne do t'ua distribuojmë pavarësisht se ai nuk është i miratuar. Sepse ligji ka procedurat e veta të miratimit, e ju të ishit në rrjedhë të të gjitha këtyre veprimeve po të kishte qenë ligji i miratuar në atë kohë. Ministria për Ekonomi e Financa dhe Qeveria bashkërisht kanë bërë ç'është e mundur që në kohë të aprovohet dhe të krijojë bazën mbi të cilën do të operohet. Sot kur bisedojmë nuk kemi mundësi ta bëjmë, se nuk kam pasur njohuri që t'ju distribuoj materialin. Por mund ta caktojmë nesër a pasnesër dhe që ju paraprkisht ta lexoni materialin dhe këtu të bisedojmë konkretisht. Ne do të jemi të gatshëm të japim gjithë kontributin tonë në sqarimin e pozicioneve të caktuara. Po të ishte miratuar atëherë, këto procedura do t'ishin diskutuar këtu në tetor, kurse dihet se më 31 dhjetor buxheti duhet të miratohet. Do të bjerë një ironi mbi të cilën vjen Kuvendi që të bisedojë për një çështje kaq jetike dhe për procedura që veç kanë kaluar. Megjithatë, ne jemi orvatur që ta lëmë së paku një pjesë të tërë asaj materie ku do të mund të reflektohet vullneti dhe reflektimet tuaja. Edhe një herë, ju lutem – na krijoni bazën mbi të cilën do të punojmë. Ne nuk kemi bazë për të ardhë dhe për të raportuar këtu. Unë kam thënë edhe në instanca më të larta, e them edhe këtu publikisht, është çështje tjetër e mjeteve të informimit: “Unë jam ministër i atij Kuvendi dhe i përgjigjem vetëm atij Kuvendi”. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit zoti ministër. E ka fjalën Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI:

Pozdravljam radno Predsedništvo, gospodina predsednika i kolege poslanike. Kao član Komisije za budžet, podržavam predlog da u novu 2003 ne udjemo bez donošenja ove odluke. Medjutim, ovom prilikom pokrenuo bih jedno pitanje koje je jedan od prethodnih diskutanata pokrenuo a koje se posebno reflektuje na predstavnike manjebrojnih zajednica na Kosovu. Naime, pripadam Bošnjackoj zajednici a tako je i sa drugim manjebrojnim zajednicama. Pitanje koje je pokrenuo Specijalni predstavnik Generalnog sekretara o decentralizaciji Kosova naišlo je svakako na veliku pažnju u javnosti i u medijima. Medjutim, ja ovde izjavljujem odgovorno, da mi kao predstavnici i legitimni predstavnici manjinskih zajednica, nismo niti pozvani na razgovor niti upoznati sa ovom izuzetno značajnom problematikom a koja može da ima određene insinuacije za lokalitete gde živimo, jer se već paralelno tome postavlja problem drugih zajednica i koje ishitrno govore o svom statusu a da veoma često se zapostavlja i status drugih zajednica manjebrojnih koje žive recimo u sredinama kao što je Prizrenski region i

tako dalje. S toga, jesam jedan od podržavalaca da se ovo pitanje dobro pripremi i pokrene na jednoj od narednih sednica ovog organa. Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Profesor Hamiti, urdhëroni.

SABRI HAMITI:

I nderuari kryetar, ju e patë që përpiqesha të jam shumë-shumë substancial dhe i shkurtër. Mendoj se nuk është koha të bëhet debat. Unë kujtoj s'kemi nevojë të bëjmë debat më tutje për arsye apo joarsye. Është fundi i vitit e Kuvendi duhet të artikulojë për probleme më të mëdha të Kosovës. Një nga problemi më i madh ose detyrë themelore është buxheti i vitit të ardhshëm. Kur duhet tash të thomë, kur të debatojmë pse – pse vijmë ne në “cajt not”. Unë kujtoj që ky Kuvend ka vetëdije ta bëjë këtë punë pa diskutime dhe ta vëjë në rend të ditës e atëherë do të bisedojmë si kolegë edhe për përgjegjësit tjerë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Mendoj se është kërkesë unanime e të gjitha grupeve parlamentare në debate dhe ka përkrahje që të vëhet në rend të ditës të seancës plenare dhe për këtë nuk ka asnjë arsye të mos bëhet. Dhe, në të njëjtën kohë, është insistim i ministrit që sa kohë, do të thotë i bashkëngjitet të gjitha dëshirave në Parlament, që të funksionalizohet kjo çështje edhe me ligj. Mendoj se në pauzë, që do ta kemi gjatë seancës plenare, Kryesia do të tërhiqet dhe të marrë qëndrim për këtë. Mendoj për dy arsye që sot nuk mund të futet në rend të ditës, deputetët s'pari duhet ta kenë materialin dhe kohën e nevojshme të shqyrtimit. Po them se Kryesia duhet të takohet dhe ta caktojë datën e mbajtjes së seancës, do të thotë gjithësesi në kohën e duhur kur mund të veprohet dhe të ndikohet.

Prandaj, e vë këtë në votim.

Kush është për ta futur debatimin për buxhet në rend të ditës të kësaj seance. Ju falemnderit. Shumica është - për, por prap do të pyes:

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush. Ju falemnderit.

Konstatohet se njëzëri miratohet kërkesa që të futet në rend të ditës të seancës së sotme plenare çështja e debatimit për buxhet.

Shqetësimet që bëhen për decentralizim nga të gjitha anët! Ekziston një bindje e përgjithshme, besoj edhe në Parlament, që asnjë vendim aq i rëndësishëm nuk duhet ta anashkalojë Parlamentin dhe ky do të jetë qëndrim unanim. Sepse, tek e fundit, kur të kryhen të gjitha studimet, të gjitha analizat, të gjitha propozimet ato duhet të finalizohen në formë të një dokumenti i cili “ponë” ose “jonë” do ta kenë

këtu. Unë mendoj se kjo është vetëm hapje e procesit akademik të diskutimeve profesionale dhe po ju them, e shfrytëzoj një rast takimi kur një francez, me post shumë të lartë në Kosovë, që thotë: 25 vite debatohet në Francë, me një traditë aq të lartë demokratike dhe ende nuk ka përfunduar, dhe nuk e shoh të arsyeshme që t'i ngrisim tensionet këtu e kjo do të thotë se është hapur çështja politikisht dhe Parlamenti do të jetë në rrjedha dhe, në momentin e caktuar, zoti deputet, do të kyçet në procedurë. Prandaj, mendoj që sot vetëm duhet ta shtojmë në agjendë çështjen që e votuam. Ju falemnderit.

Çështjen që parashtroi zonja Brovina, është çështje e diskutuar edhe në Kryesi dhe ka përkrahje të plotë, por ekziston një renditje tjetër. Mendohet se është krijuar rishtas si çështje dhe sipas mundësive të punës, në momentin kur kemi ndonjë dokument, ndonjë material, ndonjë rezultat – të dalim në seancë plenare dhe ta finalizojmë atë. Parimi i Kryesisë dhe imi është që të mos krijojmë një "Haidparkor" në Parlament - të debatohet ndoshta kot e pastaj të dalim pa konkluzë dhe pa rezultate. Prandaj, kjo është një prej çështjeve shumë të rëndësishme, vitale dhe me prioritet. Por ju lus, ne votuam për këtë dhe në një prej mbledhjeve tjera, pasi t'na propozoni çka është bërë, cilat janë të arriturat, cilat janë pengesat e pastaj ta vëmë në rend të ditës dhe gjithësesi do të debatohet. Kjo është përgjigja ime. Urdhëro, zoti Hydajet.

HYDAJET HYSENI:

Zoti kryetar, zonja e zotërinj deputetë,

Po na përsëritet një praktikë, e cila gjithmonë pastaj duhet të ketë edhe rishikim, të thuash, procedural. Po bisedojmë për çështje urgjente. Ne po na ndodh që t'i anashkalojmë e të mos fusim në rend dite çështjet që janë urgjente dhe duhet trajtuar si të tilla dhe po ashtu po na ndodh që në të njëjtën kohë të fusim si çështje urgjente çështje të cilat do të mund dhe do të duhej të ishin shtruar në procedurë të rregullt. Edhe kur janë të bazuara, do të duhet dalluar ato që janë çështje urgjente dhe të tilla mund të konsiderohen çështje që kanë ndodhur ndërkohë, midis dy seancave e për të cilat nuk ka pasur kohë të shtrohen në procedurë të rregullt. Prandaj, unë po ju përkujtoj se Grupi parlamentar i Partisë Demokratike ka shtruar një sërë çështjesh për procedurë të rregullt, përfshirë edhe këtë që e shtroi zonja Brovina. Kemi shtruar dhe është në procedurë kërkesa për gjendjen në gjyqësinë e Kosovës, e cila, pastaj do të absolvonte edhe këtë që u tha këtu me të drejtë, atë që ka ndodhur me listën e gjyqtarëve dhe prokurorëve të propozuar e që pastaj u krijua gjithë ai mbështjellim pa nevojë. Unë do të kisha dashur të gjej rastin për ta informuar Kuvendin dhe opinionin për procedurën krejt të paligjshme, për shkeljet evidente dhe për manipulimet që janë bërë me këtë rast. Kjo është çështje urgjente sepse ka ndodhur midis dy seancave dhe ne s'kemi pasur mundësi ta shtrojmë këtë çështje në procedurë të rregullt.

Për çështjet që i kemi shtruar në Kryesi ne s'kemi pasur përkrahjen e duhur. Unë habitem – pse!? Dhe, tani ne shtrojmë çështjen e buxhetit! S'kam asgjë kundër, por çështja e buxhetit ka pasë mundësi të shtrohet në procedurë të rregullt. Unë mund

t'ju përkujtoj se në Kryesinë e Kuvendit të Kosovës është shtruar së paku 7-8 herë kjo çështje dhe është kërkuar që të kemi informacion të duhur. Është heshtur. Nuk është paraqitur as në Kuvend. Tani na shtrohet si çështje urgjente! Janë edhe një sërë çështjesh tjera që duhet shtruar. E shtrojmë pasi është nxjerrë urdhëri ekzekutiv i Përfaqësuesit special apo zëvendësit të tij për buxhetin. Praktikisht, si thonë, si "kofini pas të vjelave". Dakord, por po e tërheq vërejtjen që të mos lejojmë praktikën e procedurave si i tekët dikujt. Heqim atë që s'duhet hequr. Fusim në rend dite atë që do të mund të shtrohej me procedurë..., shtrojmë me procedurë të rregullt dhe kështu disi po e ngatërrojmë edhe funksionimin e Kuvendit. Ne kemi kërkuar po ashtu, si Grup parlamentar, në një nga seancat e kaluara dhe kjo çështje është shtyrë pastaj seancë pas seance, të shtrohet edhe çështja e funksionimit të Kuvendit. Shumëka që ne na del këtu si defekt është pasojë e mossqarimit të funksionimit të Kuvendit dhe ngatërresave që krijohen atje.

Kërktoj që këto çështje megjithatë të shtrohen, nëse jo sot, së paku në seancën e ardhshme siç jemi marrë vesh. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI:

Zoti kryetar,
Unë sot dola këtu vetëm për një çështje procedurale. Nga kolegët deputetë u shtruan disa propozime. Për propozimin e parë u konsultuat me deputetët, për çka konsideroj se bëtë mirë. Për propozimet tjera vendosët vetë, çka konsideroj se nuk bëtë mirë. Ju kisha lutur që të merret një vendim se si shtrohen çështjet, kush merr vendim për futjen e pikave të rendit të ditës në Parlament. Do të ishte vërtetë kohë e fundit që këtë çështje ta sqarojmë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Përgjigjen e keni në Kornizën kushtetuese dhe në Rregulloren për funksionimin e Kuvendit dhe ato do të rrespektohen. Udhëroni zoti Meta, për së dyti.

HASAN META:

Zoti kryetar,
Më duket se nuk është hera e parë, edhe një herë kam dalur me një propozim këtu dhe nuk është shtruar në procedurë si çdo propozim që mund shtrohet. Më vjen keq, por edhe këtë që kam parashtruar me kohë në Kryesi të Kuvendit nuk ka dalur fare në Kuvend. Edhe sot vendosët vetë në një mënyrë. Më duket se çështja e

decentralizimit nuk është çështje e një individi këtu por është çështje e të gjithëve, është çështje shummadhore, sepse po manipulohet shumë me këtë çështje dhe kishte me qenë e rendit që të vijë në procedurë në njërin nga seancat e ardhme. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Zoti deputet, ndiej rrespekt për t'u përgjigjur ju sepse keni ardhur vonë. Çështja e futjes së buxhetit në rend dite u debatua dhe e përkrahën të gjitha grupet parlamentare. Unë nuk e parashtrova në votim dhe prita. Rregullorja kërkon që 25 deputetë duhet ta mbështesin propozimin. Unë desha me ju kursy, sepse asnjë nuk kërkoi fjalë për këtë. Prandaj, unë nuk vendosa asgjë. Thash rendin e ditës, thuhet në Rregullore, nuk e bën kryetari. Në momentin kur grupet parlamentare, një grup parlamentar e ngritë një çështje, vetëm po ju përkujtoj, dhe mbështetet nga grupet tjera parlamentare, ajo nënkupton se janë plotësuar të gjitha kushtet. Edhe anëtarët e Kryesisë, mos t'i përgjigjem për atë, e kanë këtë në dijeni. Me kërkesë të Grupit parlamentar të Partisë Demokratike ka qenë në rend të ditës, është aprovuar dhe Kryesia është pajtuar njëzërit dhe e kemi në rend të ditës. Edhe ato tjerat, për të cilat po debatohet, në momentin kur krijohen kushtet do të jenë të shtruara. Prandaj, nuk kemi çka këtu, në qoftë se ndjeket procedura, kështu do të vazhdojë të ndjeket sepse e kemi obligim. Nuk mund të punojmë jashtë procedurave dhe jashtë Kornizës kushtetuese. Nuk ka tjetër sqarim. Prandaj, unë thash, po i pranoj të gjitha kritikën, jam mësuar me i bartë, do t'i barti aq sa jam dhe sa mund t'i bart, por do të rrespektohen të gjitha normativat me të cilat punojmë deri ta kemi rregulloren e re të punës. Edhe një gjë deputetëve t'u sqaroj. Është kërkuar nga fillimi i punës së Parlamentit që ta nxjerrim rregulloren vendore të punës. Nuk është gati ende dhe nuk është lehtë pa të. Prandaj, derisa ta kemi rregulloren e re duhet ta rrespektojmë këtë që kemi dhe ju lus mos ta zgjasim meqë kemi tema të rëndësishme të procedojmë sipas rendit të ditës.

Në rend dite është procesverbali nga seanca e kaluar – pika e dytë e rendit të ditës.

Ne jemi marrë vesh në parim, në qoftë se ka jokorrektësi në procesverbal mënyra më e mirë është që me shkrim të paraqiten dhe vërtetë le të jetë ashtu. Por nëse ndonjë deputet e ndien të arsyeshme që edhe oralisht ta bëjë këtë, atëherë urdhëroni. Meqë nuk paraqitet askush, shkojmë më tej.

Kalojmë në pikën tjetër – shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Inspektoratin e Punës në Kosovë.

Ky shqyrtim përfundimtar ose shqyrtim i dytë qet në pah diskajshmërinë e punës tonë. Ligji përmban 8 nene. Janë diku 44 amendamente, që do të thotë Parlamenti punon, komisionet punojnë, por është një diskrepancë dhe i tërhiqet vërejtje

edhe Qeverisë por në të njëjtën kohë edhe Parlamentit që në një mënyrë të jenë pak më të harmonizuar lidhur me këtë.

Që të mos humbim kohë dhe për t'i lënë vend vendosjes si duhet, vazhdojmë me diskutimin dhe aprovimin e amendamenteve të propozuara.

Amendamenti 1: Komisioni për punë dhe mirëqenie sociale, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Mendoj që çdo deputet ka marrë me kohë materialin dhe nuk shoh të arsyeshme që ta lexojmë çka shkruan atje dhe këtu, por në qoftë se ka ndokush që është kundër këtyre amendamenteve dhe ndien të arsyeshme që të marrë fjalën le të urdhërojë.

E ka fjalën zoti Kosumi.

BAJRAM KOSUMI:

Mendoj se për amendamentin e parë, dje Komisioni për buxhet është marrë vesh ndryshe, ka vendosur ndryshe dhe këtu është ndryshe. Ne dje kemi propozuar një amendament në një formë tjetër, në të cilin amendament – fjalia e parë, hiqet krejt: “duke u bazuar në Rregulloren 99/1 të Misionit të administratës” dhe po ashtu “duke marrë parasysh Rregulloren 2001/9, të datës 25”, hiqet krejt. Amendamenti i ri ka qenë kështu: “Duke u mbështetur në Kornizën kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë” dhe vazhdohet më tej. Kështu ka qenë amendamenti i Komisionit për buxhet dje, por sot nuk qenka i paraqitur ashtu.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Të falemnderit zoti Kosumi. E ka fjalën Haki Shatri, nga Komisioni për buxhet.

HAKI SHATRI:

Të falemnderit zoti kryetar,
Është e vërtetë ajo që tha Bajrami. Ne kemi përkrahur amendamentin siç shkruan këtu por vetëm me një modifikim: hiqen 4 rreshtat e parë dhe fillon prej “duke u nisur nga Korniza kushtetuese” e vazhdohet tutje. Dhe, meqenëse jam këtu, të sqaroj edhe për një amendament, ku shkruan se: – është me kuptim të ndryshëm me amendamentin e Komisionit për mirëqenie sociale. Nuk është me kuptim të ndryshëm, por vetëm shtohet fjala “kryeinspektori” dhe vëhet fjala “zëvendësit”,

sepse është harruar dhe kjo nuk është në kundërshtim... Më vonë vjen ajo por e shfrytëzova rastin që të mos dal edhe një herë për këtë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Urdhëroni. Komisioni për punë dhe mirëqenie sociale, zonja Nafije.

NAFIJE BERISHA:

E nderuara Kryesi, të nderuar deputetë,
E pash për obligim që, si nënkryetare e parë e Komisionit për punë dhe mirëqenie sociale, t'i them disa fjalë. Ky Komision ka bërë një punë mjaft intensive lidhur me shqyrtimin e këtij Projektligji mbi Inspektoratin e Punës në Kosovë. Ky Projektligj me 8 nene, i përkthyer shumë dobët, me paqartësi të mëdha mbi funksionimin e autoritetit të inspektoratit të punës, me autorizimet, konfuzet e kryeinspektorit të punës dhe inspektorit për punë, si dhe me formulim shumë të dobët sa që në shumë raste Komisioni nuk ka mund të kuptojë qëllimin e nenit apo arsyeshmërinë e nenit. Për këtë arsye, Komisioni, duke pranuar amendamentet e profesor Fatmirit si dhe disa komente të këshilltares ekonomike të Kuvendit të Kosovës, ka bërë gjithsej 42 amendamente, që do të thotë diku afër 100% e tekstit të Ligjit është ndryshuar.

Përveç shqyrtimit të amendamenteve, për të cilat nuk do t'u merrja kohë deputetëve e t'i komentojmë të gjitha me radhë, sepse gjatë aprovimit ato do t'i komentojmë, por dëshiroj t'i njoftoj deputetët që ne si Komision jemi pajtuar që nenit 5 t'i shtohet pika 9 që ka të bëjë me transparencën e inspektorit të punës, ku inspektori i punës gjatë inspektimit është i obliguar që të marrë me vete këtë ligj i cili aprovohet, ligjin e punës dhe të gjitha aktet tjera normative të cilat botohen në tri gjuhë në Gazetën zyrtare këtu në Kosovë. Pastaj, te neni 6, e keni si plotësim të Komisionit, ku flet mbi procedurën sipas ankesës e cila absolutisht nuk ka qenë e përfshirë në ligj. Neni 6 i ka rreth katër pika dhe këtë e keni para vetes e nëse keni ndonjë pyetje për Komisionin gjatë aprovimit mund ta parashtroni.

Gjithashtu kemi shikuar disa amendamente të Komisionit për komunitete, siç është fjala për amendamentin me nenin 4, pika 3. Komisioni ynë ka dhënë një formulim pak më të gjatë të atij neni, kurse Komisioni për komunitete propozon një amendament më të shkurtër e më të qartë por nuk ndërron përmbajtjen dhe unë personalisht, si anëtare e Komisionit, pajtohem me atë amendament të Komisionit për komunitete. Komisioni për buxhet shtron një çështje për të cilën ne si Komision nuk e kemi përfshirë por kemi pasë dilema rreth asaj çështjeje. Domethënë, në nivel të Kosovës, ekziston autoriteti i inspektoriatit të punës të cilin e udhëheq kryeinspektori, mirëpo çështja e inspektorit ka qenë e pashtuar në ligj se a duhet të jetë ai i lidhur drejtpërsëdrejti me kryeinspektorin në nivel të Kosovës. Domethënë, ka munguar niveli komunal. Kurse, Komisioni për buxhet, meqë ai ka dijeni sa ka mjete, atëherë ai ka propozuar që edhe në nivel komunal të zgjidhet çështja e

inspektorit të punës dhe unë, po ashtu si anëtare e Komisionit për punë, përkrahu amendamentin e Komisionit për buxhet. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Sipas Rregullores në fuqi, a ka kush që e kundërshton këtë amendament? Nuk ka.

Atëherë, ju lus, kush është për amendamentin e propozuar, me ndryshimet si është formuluar? Unë po shoh se të gjithë janë për. Ju falemnderit.

Pyes, a ka ndokush kundër? Askush. Ju falemnderit.

A abstenon ndokush nga votimi? Dy deputetë. Ju falemnderit.

Amendamenti numër 2. Komisioni funksional, deputeti Fatmir Sejdiu, i përkrahur nga komisionet kryesore.

A ka ndokush që do ta kundërshtojë këtë amendament? S'ka. Ju falemnderit.

Atëherë, kush është për këtë amendament, i lutem ta çojë dorën.

A ka ndokush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Një. Ju falemnderit. Është e drejtë demokratike.

Amendamenti numër 3. Komisioni funksional, deputeti Fatmir Sejdiu, i përkrahur nga komisionet kryesore.

A ka ndokush që ka mendim tjetër dhe don ta arsyetojë mendimin tjetër? Nuk ka. Ju falemnderit.

Kush është për, i lutem le ta çojë dorën. Ju falemnderit.

A ka ndokush kundër? Asnjë kundër.

A ka ndokush që abstenon nga votimi? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti numër 4. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

A ka ndonjë diskutim që është opozitar me këtë mendim? Nuk ka.

Kush është për, i lutem le ta çojë dorën. Ju falemnderit..

A ka ndokush kundër, ju lutem. Asnjë.

A abstenon ndokush nga votimi? Asnjë. Ju falemnderit.

Ju lutem, para se të kalojmë në amendamentin e pestë, një sqarim. Të pranishëm janë 88 deputetë. Do të thotë është një përmirësim pranë për vendimmarrje dhe për këtë ju falënderoj shumë.

Amendamenti 5. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Ju falemnderit. Njëzërit aprovohet.

Amendamenti 6. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

A ka kush mendim tjetër që do ta shprehë jashtë këtyre komisioneve. Urdhëroni, zoti Pireva.

ILAZ PIREVA:

Vetëm desha të shtoj diç lidhur me amendamentin 6. Në Projektligj ka qenë fjala “shpërdorim”, për të cilën mendoj se duhet të jetë prap ashtu si ka qenë, sepse këtu është zëvendësuar me fjalën “shkelje” dhe kanë ndryshim fjala “shpërdorim” me “shkelje”. Jam i mendimit që të mbetet fjala “shpërdorim”. Këto janë dy kategori të ndryshme dhe nuk janë sinonime.

Po ashtu, edhe te amendamenti 7 është e njëjta gjë. Pra, le të mbetet fjala “shpërdorim” edhe këtu. Kaq, ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Unë mendoj se do të ishim demokratë të vërtetë në qoftë se japim mendim ose propozim tjetër që kontribuonin kur janë të qëlluar, dhe t'i përkrahim.

Kush është për propozimin e zotit deputet ashtu që të ngelë si ka qenë në Projektligj, lus ta çojë dorën. Shumica absolute. Ju falemnderit.

Kush është kundër? Një votë kundër. Ju falemnderit.

A abstenon ndokush nga votimi? Një. Ju falemnderit.

Amendamenti numër 7. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Mendoj se është ndërhyrje e njëjtë edhe në këtë amendament dhe kuptohet se aprovohet propozimi i deputetit. Viojmë me:

Amendamenti numër 8. Deputeti Fatmir Sejdiu, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe Komisioni funksional.

A ka ndonjë mendim tjetër që kundërshtohet ky amendament. Nuk ka.
Kush është për? Ju falemnderit.

A ka ndokush kundër? Askush kundër.

A abstenon ndokush? Asnjë. Ju falemnderit.

Amendamenti numër 9. Janë dy formulime të ndryshme: 1) Komisioni funksional, i përkrahur nga Komisioni për komunitete, në nenin 3.2. dhe 2) Komisioni për buxhet.

Unë jam për atë të përkrahën komunitetet. Urdhëroni zoti Shatri.

HAKI SHATRI:

Ju falemnderit. Më vjen keq, ndoshta po e teproj që po dal shpesh por ky është neni që thash se nuk është në kundërshtim si shkruan këtu, por vetëm për një plotësim, do të thotë të shtohet edhe “zëvendësit e tij”. Një fjalë duhet të jetë plus në amendamentin e Komisionit për buxhet dhe nuk është në kundërshtim.

Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Urdhëroni...

NAFIJE BERISHA:

Thash edhe më herët se personalisht, si nënkryetare e Komisionit, përkrah këtë amendament të Komisionit për buxhet. Mirëpo, për hirë të unitetit të fjalive në ligj, zotri kryetar i Komisionit për buxhet, edhe në këtë amendamentin tuaj duhet të jetë “inspektorati i punës” e jo “inspeksionet e punës” për shkak se del diçka ndryshe dhe në tërë ligjin është përdorur ky term dhe pastaj “inspektorit kryesor”.

Faktikisht në krejt ligjin e kemi “kryeinspektorit” dhe mendoj se duhet të jetë edhe amendamenti juaj unik me krejt ligjin dhe këto dy terma duhet përshtatur me tekstin tjetër. Përndryshe, nuk e kontestojmë amendamentin si amendament.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ishte e arsyeshme, sepse ishin dy komisione dhe kanë propozim të kundërt dhe është normale, me votimin 2:1 do të kalonte.

Prandaj, pyes – kush është për amendamentin 9 në version të Komisionit funksional, i përkrahur nga Komisioni për komunitete. Ju falemnderit.

Kush është kundër? Një.
Kush abstenon nga votimi? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 10. Komisioni funksional, i përkrahur nga Komisioni për komunitete.

Komisioni për buxhet a është kundër? Domethënë as s'e përkrah e as s'e hudhë.
E mbështesin.

Kush është për? Ju falemnderit.
A ka ndonjë votë kundër? Asnjë.
A ka ndokush që abstenon? Asnjë. Ju falemnderit.

Amendamenti 11. Komisioni për buxhet.

Prandaj, na duhet mendimi i Komisionit funksional dhe i atij për mbrojtjen e interesit të komuniteteve. A kanë mendim tjetër apo e mbështesin Komisionin për buxhet.

NAFIJE BERISHA:

Komisioni funksional ka shqyrtuar këtë çështje dhe nuk kemi pasur ndonjë zgjidhje, por e pranojmë amendamentin e Komisionit për buxhet. Edhe këtu duhet të bëhen ato përmirësime siç ishin "inspektorin kryesor" në "kryeinspektorin", domethënë ato përmirësimet gjuhësore.

RYESUESI NEXHAT DKACI:

Ju falemnderit. Udhëroni.

SADUDIN BERISHA:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë,
Kur është fjala për amendamentin 11, neni 3.4. "inspektori kryesor" duhet të jetë "kryeinspektorin e punës e emëron Qeveria". Mendoj se kjo nuk duhet të jetë kompetencë e Qeverisë, por duhet të jetë kompetencë e Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, të cilin e mbështetë Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Pika 3.5. mbështetet.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Dy komisione kanë propozime. Kush është propozim të Komisionit për buxhe, i mbështetur nga Komisioni funksional... Urdhëroni.

BAJRAM KOSUMI:

Në fakt këtu janë dy amendamente, por janë të futura me një amendament. Thotë: 3.4. dhe 3.5. Për 3.4.-shin nuk po flas, por po flas për 3.5.-shin. Unë jam kundër këtij amendamenti që të miratohet kështu dhe dje në Komision kam qenë kundër. Kemi debatuar gjatë dhe, më lejoni këtu të jap vetëm një sqarim pse jam kundër kësaj që “inspektorët në komunë t’i zgjedhë kuvendi komunal”. Nën një: kjo e prishë tërë strukturën e ligjit. Ligji është ndërtuar i tillë që kryeinspektori dhe inspektorati t’i kontrollojnë inspektorët e punës nëpër komuna. Dhe nëse kuvendi komunal ose ekzekutivi i komunës zgjedh inspektorët atëherë kryeinspektori dhe inspektorati s’kanë çka të lypin më aty. Komuna i kontrollon e jo kryeinspektori. Prandaj, prishet struktura e ligjit. Kjo është arsyeja e parë.

Arsyeja e dytë: Ministria e punës dhe e mirëqenies sociale është e thirrur për të mbrojtur të drejtën e punëtorit, Ligjin e punës dhe të drejtën e punës, e jo kuvendi komunal ose ekzekutivi komunal. Prandaj, kjo e drejtë i takon qeverisë qendrore përkatësisht ministrisë. Unë jam për atë që kjo të mos futet dhe ju ftoj që mos ta votoni 3.5.-shin për arsye që të mbetet si ka qenë në Projektligj. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën zonja Brovina.

FLORA BROVINA:

Komisioni për punë këtë amendament numër 11 nuk e ka diskutuar, prandaj sigurisht se deputeti që diskutoi më parë ka të drejtë kur thotë se prishet struktura e tërë ligjit nëse komuna zgjedhë inspektorët komunalë. Prandaj, ne mund të tërhiqemi e të diskutojmë si Komision se a e aprovon Komisioni për buxhet.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Po them se s’ka debate. E dëgjuam arsyetimin e mirë të deputetit që është kundër dhe votimi është që vendos.

Kush është për propozimin ashtu si figuron në amendamente, ju lutem ta çojë dorën. Duhet të numërohen votat që të mos bëjmë ndonjë lëshim.

Kush është kundër? Ju falemnderit.

Për propozimin janë 52 vota.

Kundër janë 23.

Kanë abstenuar 3.

Prandaj, miratohet propozimi i Komisionit për buxhet..

Amendamenti 12. Deputeti Fatmir Sejdiu, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe Komisioni funksional.

A ka ndonjë mendim të kundërt?

Kush është për këtë amendament? Ju falemnderit.

A ka ndokush kundër? Asnjë.

A abstenon ndokush nga votimi? Asnjë. Ju falemnderit.

Amendamenti 13. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

A ka ndonjë mendim të kundërt që do ta kundërshtojë këtë amendament.

Urdhëroni zoti Pireva.

ILAZ PIREVA:

Këtu do ta bëja një vërejtje parimore. Kur bëhet numërimi në gjithë ligjin, besoj edhe në ligjet tjera, le të bëhet sipas alfabetit të gjuhës shqipe. Pra a,b,c,ç,d,dh, e kështu me radhë, e jo sipas asaj që na është bërë. Po ashtu, kur është fjala te ky amendament, thotë: “secilën gjobë të veçantë që jepet”. Gjoha shqiptohet e nuk jepet dhe le të bëhet ky përmirësim. Dhe këtu ndërron po ashtu në pikën d) “inspektorët e punës nuk mund të shqiptojnë gjobë të përcaktuar me nenin 25.2. dhe 25.3. derisa të nxirret akti normativ”, duhet të jetë “derisa të mos nxirret akti normativ”, sepse ndërron krejtësisht kuptimi.

Ka, po them kështu, edhe disa çështje të tjera të cilat unë besoj në tekstin e spastruar duhet këto të vëhen në vendin e vet. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Zoti Pireva, ju falemnderit. Unë mendoj që profesionalizmi, do të thotë gjuhësia duhet t'i përmirësojë këto, që është kompetente dhe të aprovohen, kurse këto të tjerat duhet të votohen.

Unë s'kam propozim të komuniteteve këtu. Ju lutem, amendamenti 13, në materialin që unë e kam – Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore. Nuk ka amendament të komisionit...

Kush është për propozim të tri komisioneve relevante dhe besoj të përkrahura nga kjo që tha për shqipërim të drejtë të kësaj.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka ndokush kundër? Asnjë.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 14. Dy propozime të ndryshme: 1) Komisioni për punë dhe mirëqenie sociale, i përkrahur nga Komisioni për buxhet dhe 2) Komisioni për komunitete.

Do të thotë, janë dy propozime të ndryshme për këtë amendament. Duhet t'i vë në votim. Urdhëroni ju nga Komisioni funksional.

NAFIJE BERISHA:

Komisioni për komunitete ka amendament në pikën d) të nenit 4.3. e jo në tërë nenin. Domethënë pika d), sipas Komisionit, të saktësoj se cila nga gjoba është e arsyeshme dhe proporcionale për shkeljen e bërë: “Inspektorët e punës nuk mund të shqiptojnë gjoba të përcaktuara me nenin 25.2, 25.3 derisa të nxirret akti normativ në bazë të nenit 4.3. të këtij ligji”, kurse Komisioni për komunitete e thjeshtëson pak këtë dhe thotë: “Qeveria e Kosovës me propozim të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale do të nxjerrë akt nënligjor i cili do të përcaktojë lartësinë e gjobës varësisht nga shkelja e dispozitave ligjore”. Kjo do të thotë se nuk ka amendament në tërë nenin për shkak se neni 4.3. e ka pikën a), pikën b) dhe pikën c) që janë shumë të rëndësishme të qëndrojnë këtu ku janë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Zoti Berisha, urdhëroni edhe ju për një sqarim.

SADUDIN BERISHA:

Komisioni për komunitete ka pasë në shqyrtim amendamentin plotësues përkatësisht një nen të ri të Komisionit për punë dhe mirëqenie sociale, ashtu siç është i përshkruar në nenin 4.3. Megjithatë, duke pasur parasysh mangësitë që ka Ligji themelor mbi punën, që është aprovuar nga administrata ndërkombëtare me plotë mangësi të saj, kemi vlerësuar dhe për ta thjeshtësuar përmbajtjen e gjithë kësaj që është propozuar, Komisioni për punë dhe mirëqenie sociale del me një propozim tjetër dhe atë: “Qeveria e Kosovës, me propozim të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale do të nxjerrë akt nënligjor i cili do të përcaktojë lartësinë e gjobës varësisht nga shkeljet e dispozitave ligjore” dhe kështu do të rumbullakësojë të gjithë këtë duke krijuar hapësirë më të madhe të veprimit përmes kësaj norme shtesë të këtij projektligji. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Më lejoni ta bëjmë një fuzionim, një përmbledhje. Zoti Sejdiu besoj se pajtohet me këtë.

Kush është për propozimin e Komisionit funksional dhe të atij për buxhet por të plotësuar vetëm me këtë pjesë të Komisionit për komunitete.

Ju lutem, edhe një herë po e përsëris: amendamenti 14 ka dy propozime të ndryshme.

Kush është për propozimin e parë të dy komisioneve? Ju falemnderit shumë.
Kush është kundër këtij propozimi? Gjashtë vota kundër. Ju falemnderit.
A abstenon ndokush nga votimi? Tre. Ju falemnderit.

Amendamenti 15. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

A ka ndonjë deputet që ka mendim tjetër? Nuk ka.
Kush është për këtë amendament? Ju falemnderit.
A ka ndokush kundër? Askush.
A abstenon ndokush nga votimi? Akush. Ju falemnderit.

Amendamenti 16. Deputeti Fatmir Sejdiu, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për, i lutem le ta çojë dorën. Ju falemnderit.
A ka kush kundër? Asnjë kundër. Ju falemnderit.
A abstenon ndokush nga votimi? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 17. Deputeti Fatmir Sejdiu, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
A ka kush kundër? Askush.
A abstenon ndokush nga votimi? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 18. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për, i lutem le ta çojë dorën. Ju falemnderit.
A ka kush kundër? Askush.
A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 19. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për, i lutem ta çojë dorën. Ju falemnderit.
A ka ndonjë votë kundër? Asnjë.
A abstenon ndokush nga votimi? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 20. Propozime të ndryshme: 1) Komisioni funksional, i përkrahur nga Komisioni për komunitete; 2) Komisioni për buxhet.

Kush është për variantin e dy komisioneve të para?

Ju lutem, kush është për propozimin e Komisionit funksional, i përkrahur nga Komisioni për komunitete. Ju lutem, numëroni votat. Duhet të jemi korrekt.

Kush është kundër, domethënë për variantin e dytë, i lutem ta çojë dorën. Numëroni votat për atë se kush është kundër. Fatmir, sqarimi është i qartë. Kush është për dy komisionet, u bë votimi. Ai që është për variantin 2, do të thotë Komisionin për buxhet dhe këtu është e qartë.

A abstenon ndokush nga votimi, ju lutem. Numëroni votat. Ka tri abstenime.

Rezultati është: 47 vota për; 5 kundër; 3 të abstenuar, prandaj miratohet varianti i parë. Ju falemnderit.

Amendamenti 21. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për, i lutem le ta çojë dorën. Ju falemnderit.,

A ka ndokush kundër? Asnjë.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 22. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka ndonjë votë kundër? Asnjë.

A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 23. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 24. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 25. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit...

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 26. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush. Ju falemnderit.

A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 27. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Amendamenti 28. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Një. Ju falemnderit.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Amendamenti 29. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Asnjë.

A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 30. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 31. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Asnjë votë kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 32. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka ndonjë votë kundër? Nuk ka.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 33. Janë dy propozime: 1) Komisioni për punë dhe mirëqenie sociale, i përkrahur nga Komisioni për komunitete dhe 2) Komisioni për buxhet.

Për mos me pasë konfuzion – kush është për propozimin e dy komisioneve: funksional dhe atë të komuniteteve. Urdhëroni, zoti Shatri.

HAKI SHATRI:

Ju falemnderit zoti kryetar. Komisioni për buxhet ka debatuar këtë çështje dhe mendojmë se është shumë me rëndësi të përcaktohem për mënyrën si ne kemi propozuar dhe të zgjidhet ky problem. Është fjala për një çështje – respektivisht mundësia që inspektori i punës ta keqpërdorë detyrën e tij pa lënë gjurmë për punën që ka bërë te ndonjë subjekt ku ka bërë inspektimin. Ne kërkojmë që inspektori i punës me rastin e kryerjes së detyrës, pas çdo pune që kryen, me lënë një raport me shkrim përmes të cilit shihet qartë se ai ka punuar në një vend, e me këtë nuk i lihet mundësia që ditë me radhë të shkojë të bëjë presion ose edhe ndonjë shpërdorim detyre dhe në fund ta denojë ndokend me ose pa bazë. Këtu është qëllimi që Komisioni për buxhet ka insistuar në këtë formulim të cilin ju e keni para veti. Prandaj, ju kisha ftuar që me vëmendje ta shqyrtojmë dhe votojmë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Urdhëroni, zonja Berisha.

NAFIJE BERISHA:

Vërtetë më vjen keq, por është gabim. Ne nuk jemi kundër amendamentit të Komisionit për buxhet. Mirëpo është vënë amendamenti i Komisionit për buxhet kundër amendamentit të Komisionit në amendamente të kundërta. Shkaku qëndron në këtë: neni 5.5.e) nga Komisioni është “mund të zbatohet pas miratimit nga ministria të aktit plotësues normativ i cili përcakton standarde konkrete nga lëmi i shëndetësisë dhe sigurisë në punë” që është shumë i lidhur me nenin 5.5. pika d) ku në raste të caktuara inspektori i punës mund të ndalojë edhe prodhimin në një organizatë punuese ku bëhet shkelja e të drejtave të punëtorit ose ku mbrojtja e punëtorit nuk është sipas standardeve. Domethënë, neni 5.5.d) është ngusht e lidhur sepse ministria për punë duhet të japë një akt i cili parasheh standarde të mbrojtjes së puntërit në punë dhe të shëndetësisë e sigurisë në punë. Me amendamentin e Komisionit për buxhet ne pajtohemi dhe mendojmë se këtu është gabimi teknik por unë kërkoj që kryetari ta paraqesë në votim amendamentin 33 si amendament të

Komisionit për punë dhe mirëqenie sociale, sepse e aprovuam amendamentin 32, kurse pa amendamentin 33 të Komisionit për punë dhe mirëqenie sociale nuk ka kuptim amendamenti 32.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Të kemi kujdes ju lutem këtu. Sipas diskutimeve të dy komisioneve del se qëndrojnë në pozicione të veta secila. Prandaj, nuk janë dy amendamente por një. Zoti Kosumi, nuk mund të themi ashtu se atëherë e gjithë procedura që kemi bërë deri këtu do të thotë e kemi bërë kot.

(Bëhet polemikë nga vendi, nuk dëgjohej)

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Atëherë, shikoni. Amendament i ri i Komisionit për buxhet dhe përkrahet nga Komisioni funksional, por të shkojmë me radhë.

Kush është që amendamenti 33.a) i propozuar nga këto dy komisione të përkrahet? Ju falemnderit.

A ka ndonjë votë kundër këtij propozimi? Asnjë.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush. Ju falemnderit.

Dhe, kush është për amendamentin 33.b) nga Komisioni për buxhet, i përkrahur nga këto komisione. Ju falemnderit.

A ka ndokush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Një. Ju falemnderit.

Amendamenti 34. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për, i lutem le ta çojë dorën. Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Akush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 35. Dy propozime të ndryshe: 1) Komisioni funksional, i përkrahur nga Komisioni për komunitete dhe 2) Deputeti Fatmir Sejdiu, i përkrahur nga Komisioni për komunitete.

Varianti i parë. Kushë për? Ju falemnderit.

A ka ndokush kundër? Dy vota kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Një abstenim.

Do të thotë heq dorë propozuesi profesor Fatmir Sejdiu, prandaj edhe nuk do ta qesim në votim.

Amendamenti 36. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
 A ka ndonjë votë kundër? Nuk ka.
 A abstenon ndokush nga votimi? Ju falemnderit.

Amendamenti 37. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
 A ka kush kundër? Askush.
 A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 38. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
 Kush është kundër? Askush.
 A abstenon ndokush? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 39. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
 Kush është kundër? Askush.
 A abstenon ndokush? Një. Ju falemnderit.

Amendamenti 40. Komisioni funksional, i përkrahur nga të dy komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
 A ka ndonjë votë kundër? Dy vota kundër.
 A abstenon ndokush nga votimi? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 41. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
 A ka ndokush kundër? Askush.
 A abstenon ndokush nga votimi? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 42. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
 Kush është kundër? Askush.
 A abstenon ndokush nga votimi? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 43. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush. Ju falemnderit.

Amendamenti 44. Deputeti Fatmir Sejdiu, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush. Ju falemnderit.

Para se ta qesim në votim tërë ligjin, unë do të shprehja një kënaqësi ndaj komisioneve kësaj radhe që kanë ardhur me propozime të unifikuara, të punuara mirë dhe po ashtu për pjesëmarrjen e deputetëve. Tani duhet ta votojmë ligjin në tërësi.

Kush është për?

A ka ndokush kundër, ju lutem. Asnjë votë kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Një abstenim. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For:.....	Të gjithë – Svi - Majority
Kundër – Protiv – Against.....	00
Abstenim – Uzdržanih – Abstained.....	01

(Duartrokitje)

Ju lutem, gjysmë ore pauzë. Kryesia e Kuvendit, ju lutem, të mblidhet te unë.

(Vijon p a u z a)

(Pas pauze, Seanca vazhdoi punën me kryesuesin: Xhavit Haliti).

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Të nderuar deputetë dhe deputete, po procedojmë me Seancën parlamentare.

Pikë vijuese e rendit të ditës është: Gjendja energjetike në Kosovë, e parashtruar nga Grupi parlamentar i Partisë Demokratike për debat.

Të gjithë kemi informata, të gjithë i dijmë kompetencat që i kemi si Kuvend dhe mendoj se nuk është thirrë debati për ta nxjerrë sot përgjegjësinë që s'kemi energji elektrike, sepse ka shumë faktorë që ndërlidhen në atë se kush është përgjegjës dhe, për të mos e zgjatë me fjalim, mendoj se përfaqësuesi i Grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, si propozues, ka të drejtë të thotë mendimin e vet dhe pastaj sipas radhës të marrin pjesë edhe grupet tjera të deputetëve. Fjalën e ka zoti Limaj.

FATMIR LIMAJ:

Zoti kryesues, të nderuar deputetë,

Fatmirësisht pas 28 kërkesave me shkrim, duke rrespektuar Rregulloren e punës së Kuvendit, që Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ia ka paraqitur në vazhdimsi Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, për herë të parë ka gjend vend në rendin e ditës një nga ato kërkesa. Thash fatmirësisht por njëkohësisht mund të them edhe lirisht që megjithëse është paraqitur sot për rend dite një nga kërkesat e Grupit tonë parlamentar që të bisedohet për gjendjen në energjetikë në Kosovë, Kryesia e Parlamentit të Kosovës, nuk ka marrë ose nuk ka përgatitur si duhet këtë pikë të rendit të ditës ashtu siç e kemi bërë ne me kërkesën tonë. Dua t'ju lexoj kërkesën e Grupit parlamentar si iu kemi drejtuar Kryesisë:

Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, kërkon nga Kryesia e Kuvendit që në seancën e ardhshme të Parlamentit të Kosovës të futet në rend dite çështja e energjetikës në Kosovë, duke kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që të ftojë njerëzit e autorizuar ose bordin mbikëqyrës të KEK-ut dhe të merr informacione të plota ose raport mbi gjendjen aktuale energjetike në Kosovë dhe ato informacione t'i posedojnë të gjithë deputetët mbi bazën e së cilës do të debatojnë.

Ne jemi dëshmitarë të gjithë që kjo nuk është bërë, do të thotë pjesa e dytë dhe, siç po shihet, Kryesia e Kuvendit nuk ka biseduar të paktën dhe mund të sypozojmë se s'ka biseduar meqë që nuk kemi materiale dhe kjo pikë e rendit të ditës po shihet se është gjysmake dhe e pa përgatitur. Me një fjalë, udhëheqësia e Kuvendit nuk ka kryer detyrën e vet. Sido që të jetë, është mirë që Parlamenti i Kosovës, në tërësi, ka filluar dhe duhet të fillojë definitivisht të mirret me problemet praktike të qytetarëve tanë. Kosova futet edhe këtë vit, siç është futur, në një kolaps energjetik dhe në një gjendje të rëndë energjetike, gjendje e cila po i tejkalon kufijt e durueshmërisë së qytetarëve. Prandaj, ne kemi parë si të domosdoshme, si Grup parlamentar, që kjo çështje jetike për qytetarët dhe për të gjithë neve të gjejë vend dhe të debatohet në Parlamentin e Kosovës nga deputetët dhe deputetët e Parlamentit të Kosovës të marrin informacione mbi gjendjen aktuale energjetike aktuale në Koorporatën e vetme energjetike në Kosovë – KEK-u, për atë se: si është gjendja momentale; sa ka kapacitet prodhues KEK-u sot për sot në Kosovë; sa

importohet ose eksportohet; sa janë investimet dhe si kanë shkuar ato investime; sa kanë qenë të suksesshme dhe sa kanë dështuar; a ka keqpërdorime apo s'ka keqpërdorime; t'na i paraqesin cilat janë ato objektivat për të dalë nga kjo gjendje ose nga ky kaos energjetik që ka kapluar sot Kosovën.

Këto çështje që ngrita unë këtu, kanë për obligim që drejtuesit, jo në këtë rast vetëm të KEK-ut por edhe personat e autorizuar, ata të cilët janë të autorizuar në këtë lëmë t'ia paraqesin Kuvendit të Kosovës dhe deputetëve të dhënat dhe duhet të ndërpritet praktika që të paktën deputetët e Parlamentit të Kosovës të informohen vetëm përmes mediave për zhvillimet që po ndodhin, për zhvillimet që janë jetike dhe në interes të qytetarëve ose ata persona të autorizuar të na japin raportet e tyre përmes ndonjë konference shtypi. Është arsyeja pse e them këtë. Për arsye se ne të gjithë kemi një bazë zgjedhore dhe para se gjithash kemi obligim para votuesve tanë, para qytetarëve tanë të mirremi me shqetësimet e tyre të përditshme.

Unë mendoj se Parlamenti i Kosovës nuk është parlament apo institucion i cili duhet vetëm të fabrikojë ose të nxjerrë ligje. Ne duhet të mirremi me të gjitha problemet të cilat janë shqetësim për qytetarët dhe ato probleme të debatohen, të adresohen përgjegjësitë, të adresohen edhe meritat, të adresohen njëkohësisht edhe objektivat se si mendojnë njerëzit kompetent në lëmi të caktuara për t'i realizuar ose për të dalë nga gjendja aktuale.

Duke marrë parasysh atë që thash për mendimin tim kjo pjesë ose kjo pikë e rendit të ditës nuk është në tërësi e përgatitur dhe mendoj se ne nuk jemi këtu vetëm sa për të debatuar por duhet të debatojmë me përmbajtje. Në esencë unë propozoj para jush që Kuvendi i Kosovës të autorizojë një nga komisionet për afërsisht përkatëse ose ta ngrisë një komision ad hoc dhe mendoj se më mirë do të ishte ta autorizojmë Komisionin për tregti dhe industri dhe ky Komision t'i ftojë përgjegjësit e këtij institucioni, kësaj kompanie publike, që të debatojë e të marrë informacione të nevojshme dhe Komisioni pastaj të përgatisë një informatë apo një raport ku do t'u shpërndahej deputetëve dhe deputetët mbi bazën e kësaj informate të zhvillojnë debat rreth gjendjes energjetike në Kosovë. A ka mundësi Komisioni ta bëjë një gjë të tillë apo a ka mundësi Parlamenti? Nisem nga një fakt. Sipas informatave të paktën që kemi, sepse këtu asnjëherë nuk është biseduar zyrtarisht mesa unë e di, Qeveria e Kosovës përfaqësohet me dy nga ministrat në bordin mbikëqyrës në KEK dhe përmes tyre Kuvendi i Kosovës ka të drejtë, Kryesia po edhe Komisioni, që t'i ftojë të paktën ministrat tanë, të ftojë në tërësi Qeverinë dhe Qeveria të kërkojë nga bordi mbikëqyrës që të japë një informatë të plotë mbi gjithë atë çka ka ndodhur në KEK për këto tri vite dhe cilat janë objektivat zhvillimore, cilat janë objektivat për të sanuar dhe për të dalë nga kjo gjendje kaotike dhe katastrofale energjetike në Kosovë.

Në qoftë se pajtoheni edhe ju, unë kisha kërkuar që pasi ta autorizojmë komisionin përkatës, komisioni në një kohë sa më të shpejtë të mblidhet dhe në seancën e ardhshme të vazhdohet debati për gjendjen energjetike në vend. Përsëri po e them, ne duhet të jemi të interesuar që këtu të diskutohet dhe të debatohet seriozisht, duke

patur materialin përkatës e jo vetëm sa të hapen çështjet e pastaj të mbesin pa informatë të mjaftueshme sepse me këtë rast deputetët janë në një situatë jo të mirë derisa nuk kanë informacione të plota apo raport mbi bazën e së cilës kishin me diskutuar.

Kërkoj në këtë drejtim që edhe ju, të nderuar deputetë, ta mbështetni këtë propozim të Grupit tanë parlamentar dhe njëkohësisht kërkoj nga Kryesia e Kuvendit t'i ndalojë praktikën e votimeve të rendit të ditës në Kryesinë e Kuvendit për arsye se me Rregulloren secili grup parlamentar ka të drejtë të paraqesë kërkesë për ndonjë çështje të rendit të ditës. Kryesia e Kuvendit, mesa unë e di, ka të drejtë vetëm të përcaktojë seancën, ditën se kur mund të futet ajo çështje në rend dite, por jo edhe ta vlerësojë a bën apo nuk bën të futet në rend dite një pikë e caktuar. Është e drejtë e grupeve parlamentare, është e drejtë përmes Rregullores që deputetët të cilët mendojnë se një çështje është me interes për të gjend vend në rend dite duhet të procedohet dhe ajo duhet të dalë para Kuvendit dhe sipas asaj që ne jemi ballafaquar deri më tani shpeshherë Kryesia e Kuvendit ka marrë dhe ka rezervuar të drejtën e saj për të vlerësuar se a duhet apo nuk duhet kjo çështje të shtrohet në rend dite. Mendoj se kjo është jashtë kompetencave të tyre. Ata mund ta shtyjnë për një seancë tjetër ndonjë çështje por jo edhe ta largojnë nga rendi i ditës aq më tepër kur ka edhe shumë kërkesa tjera të cilat ndoshta nuk kanë gjend vend për shqyrtim brendapërbrenda Kryesisë së Kuvendit. Dhe në qoftë se vazhdohet kjo praktikë, mendoj se kjo krijon një moment ku edhe ne si grupe parlamentare nuk e shohim më të nevojshme as të drejtohem me kërkesa, derisa nuk rrespektohen ato kërkesa dhe me këtë krijohet një pasivitet i panevojshëm edhe i vetë rolit të deputetëve dhe shkeljeve të procedurave, që mendoj bëhen në mënyrë të panevjuar.

U tha edhe më herët nga deputetët se çështjet duhet ndarë dhe të dihet cilat janë çështjet urgjente. Partia Demokratike e Kosovës ose Grupi parlamentar dy herë ka kërkuar, dy kërkesa i ka që të bisedohet për sistemin e gjyqësisë në Kosovë. Një herë para se ne t'i refuzojmë gjyqtarët dhe prokurorët dhe pastaj, pas një jave, përsëri me kërkesën e njëjtë dhe sot ende nuk e kemi në rend dite. Dhe në qoftë se ky Kuvend nuk mirret edhe me këto probleme, unë mendoj se nuk e ka kryer funksionin e vet Kuvendi i Kosovës vetëm duke nxjerrë ligje të cilat na vijnë nga Qeveria. Është e drejtë edhe e deputetëve të ngrisin qoftë çështje ose pika të cilat mendojnë se janë në interes të paktën për elektoratin e tyre e ndoshta në tërësi për qytetarët e Kosovës sepse në fund të fundit qytetarë të Kosovës jemi të gjithë dhe që mbrojmë secili në fokus grupet e tyre. Ju falemnderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

E ka fjalën kryetari i Grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI:

Krejt demokratë jemi, kjo është kryesorja.

Po sjellim në foltoren e Kuendit një problem shumë të madh për qytetarët e Kosovës i cili është aktual tash 3 vjet e gjysmë, unë kujtoj me intensitet të njëjtë. Mënyra e të folurit ka ndërrue në faza të ndryshme rreth këtij problemi, por unë kujtoj që problemi s'ka pasë ndonjë rënie a çuarje të veçantë në kuptimin kualitativ. Pra është i njëjtë problemi i furnizimit me energji elektrike në Kosovë. Natyrisht që përkrah diskutimin e problemeve të mëdha për qytetarët e Kosovës sepse këtu është vendi që duhet të bisedohet për njerëzit që ne i përfaqësojmë. Po ashtu pajtohem me folësin para meje, kolegun Limaj që ashiqare ne sot këtu mund ta iniciojmë problemin por diçka substanciale në kuptimin edhe të informacionit edhe të analizës e këtë nuk do të mund ta bëjmë asnjëri prej nesh, përkundër vullnetit të shumë të madh që të dijme sa më shumë substancialisht çka po ndodhë, cilat janë perspektivat, cila është gjendja, çka trashëgohet e çka duhet të ndërrohet.

Prandaj, unë e pëlqej mendimin që duhet të gjenden forma e të mblidhen këto informacione nga kompetentët, nga ekspertët dhe nga përgjegjësit – që i shoh tri shkallë dhe atëherë diskutimi ynë do të ishte shumë më funksional dhe shumë më i dobishëm. Menjëherë po them, tash për tash, nuk mendoj se është shumë e dobishme të formojmë komisione të tipeve ad hoc, sepse është njësoj ajo. Nëse ju mendoni se është më i përshtatshmi Komisioni për tregti dhe industri – pse jo. Mund të kalohet përmes këtij komisioni në nivelin e kontakteve të mbledhjeve të informatave e menjëherë po them edhe përmes ministrive gjegjëse sepse këtu duhet të jetë një hallkë në mes të komisionit - Parlamentit – ministrisë gjegjëse, bile edhe kryeministrisë, në mënyrë që ta çojmë seriozitetin e kërkesave tona edhe në instanca ndërkombëtare të cilat janë të involvuara, dhe unë do të thosha, edhe përgjegjëse kryesore për të gjitha.

Sa për vete, unë me një moskënaqësi, me një dhembje në vete do të thosha se KEK-u është bërë njëfarë metafore e dhembshme e Kosovës 2-3 viteve të fundit sa i përket zhvillimeve ekonomike dhe nganjëherë më duket që formula “Kosova-KEK” e jep gjithë lëvizjen që kanë ndodhë me këtuoprobeme dhe këtu KEK-un e shoh njëherë si çështje të ekonomisë e që është një ekonomi e trashëguar dhe me statusin që ka vjen në një kohë tjetër kur duhet disi të transformohet në kuptimin e interesit ekonomik dhe strategjik sepse ju e dini që KEK-un bashkë me “Trepçën” i kemi konsideruar si gjigantë tanë. Kohët janë tjera dhe lëvizjet ekonomike e sociale janë tjera. Është bërë si çështje ekonomike, si çështje sociale, vetëvetiu pas luftës – KEK-u. Sepse ju e dini shummirë që për shkak të gjendjes së popullatës sonë janë ndërmarrë masa që nuk janë ekonomike, e të cilat popullsia, ajo që ka pasë nevojë, i ka marrë krahapur dhe tjetra i ka shfrytëzuar sepse është thënë s'po e di a u bë një vjet a më shumë që - kërkush s'duhet të paguajë rrymë se është gjendja e keqe sociale. Të gjithëve iu ka pëlqyar kjo, por këtu janë shtresat të cilëve është dashur në këtë formë t'u ndihmohet, por janë edhe shtresat që në mënyrë enorme kanë keqpërdorë këtë dhe shkurt t'i bie – e kanë vjedhë rrymën. Këtu ana sociale duhet të definohet dhe unë kujtoj se do të definohet edhe në bisedat tona për këtë problem.

Dhe, tjetra është një çështje kulture. Unë po them – kulture, nuk dua t'i them me emër tjetër. Nuk e paguajnë rrymën edhe njerëzit që kanë. Ju do t'i shihni kur t'i marrim informacionet që rrymën s'e paguajnë edhe institucionet që kanë pare shumë edhe ato vendëse e ndërkombëtare. Nuk paguajnë rrymën ekonomitë që e shfrytëzojnë më së shumti e mund ta paguajnë. Dhe, në fund, krejt në fund, vijnë harxhuesit që ne i quajmë individual siç jemi ne, unë e secili prej nesh. Dhe, kjo është çështje, unë po e quaj kulture dhe kjo do një reagim institucional. Ju e dini që ka urdhëresa të detyrohen njerëzit ta paguajnë dhe prapë nuk ka rezultate. E, këtu tash është problemi se duhet të shqyrtohet edhe ky problem, por në nivele institucionale. Qysh të detyrohen njerëzit të mësohen e të kulturohen që një send që e harxhojnë paguhet me pare. Natyrisht të gjitha këto probleme prapë bien në KEK sepse është ndërmarrja e cila merret me prodhimin, distribuimin dhe eventualisht edhe me blerjen e rrymës.

Unë për këtë kaq, por po them edhe një herë se problemi është shumë i madh dhe me gjendjen, me informacionet që kemi ne sot, nuk dij a mund të kontribuojmë shumë përpos që të kërkojmë që kjo vijë institucionalisht dhe në mënyrë themelore të studiohet në të gjitha instancat dhe të sillet me dokumentacion të fortë në një mbledhje tjetër. Ju falemnderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Fjalën e ka zoti Ramush Haradinaj. Le të përgatitet Fatmir Sejdiu, si anëtar i Kryesisë.

RAMUSH HARADINAJ:

Ju falemnderit,

Dëshiroj të jam racional në këtë fjalë. Pajtohem se gjendja energjetike në Kosovë është e keqe, pra s'mund të thuhet se është e vështirë dhe po ashtu se nuk mund të qëndrojmë indiferent në këtë situatë. Ne jemi të vetëdijshëm se stabilimentet në KEK janë të vjetruara, nuk kanë qenë të mirëmbajtura për mëse 10 vjet. Po ashtu jemi në dijeni apo jemi informuar kohëpaskohe për investime të shumta dhe e dijmë për avarinë që ndodhi dhe të gjitha këto na shtyejnë edhe të shqetësohemi por edhe të interesohemi se si është gjendja. Pasojat e kësaj situatë janë të mëdha. Ato nuk prekin vetëm amvisërinë apo shërbimet publike, por janë duke goditur ekonominë e Kosovës, më konkretisht, nuk lejojnë as inicim të zhvillimit ekonomik në këtë situatë e të mos flasim për investime. Kush do të investojë në një ekonomi ku s'ka energji.

Edhe ne, si Grup parlamentar, në këtë rast, mbështesim marrjen e veprimeve për shqyrtimin e kësaj gjendjeje nga Parlamenti, pra nga vetë ne, ndonjë veprim të mundshëm që do të përgatitet në këtë rast, ndonjë grup pune apo që ndonjërit nga komisionet ekzistues t'i besohet shqyrtimi i kësaj gjendjeje dhe pastaj mbështesim të kërkohet nga Qeveria që të veprojë në këtë drejtim por edhe nga administrata e Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Është me rëndësi të madhe në këtë situatë krize

që opinioni të dijë se ç'po ndodhë e sidomos të krijohet transparencë rreth çështjeve apo arsyeve pse jemi në këtë situatë. Po ashtu, është me rëndësi që pas punës së bërë, të jipet edhe një zgjidhje, pra të sqarohet se si mund të dalim nga kjo krizë. Në të kundërtën, është në dëm të përpjekjeve që bëjmë ne, në rast se kjo çështje politizohet mjaftueshëm apo kthehet objekt i polemikave joproductive sidomos në këtë kohë që është kohë e vështirë për popullatën tonë. Fatki se një numër i madh i qytetarëve të Kosovës e kanë tani energjinë elektrike si burim të vetëm të nxemjes, andaj do të ishte me interes që në ndërkohë të merret ndonjë masë e shpejtë për importimin e rrymës, pra në kohën e reduktimeve edhe para se të veprohet me shtjellimin apo me qartësimin e gjendjes në KEK dhe rreth KEK-ut. Ju falemnderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Urhëroni, e ka fjalën Fatmir Sejdiu.

FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit, zoti kryesues.

Dijmë qartë se edhe në debatin që do ta shtyjmë, çështja nuk do të rregullohet dhe s'kam frikë meqë kemi agregatin nëse ndalet rryma. Mendoj se kemi dy pozicione të qarta: e para se është një temë shumë e rëndësishme dhe pavarësisht nga fakti se ka pasur hezitim në Kryesinë e Kuvendit të mos shtrohet pa përgatitje dhe pikërisht nga ato që ju shtruat zoti Limaj por ka pasur insistim që të hapet si debat dhe u hap. Rruga e dytë është ajo pikërisht e preferuar, që në përgatitjen e gjithë dokumentacioneve, do ta quaja, argumentuese të gjendjes dhe të perspektivës së daljes nga kjo krizë duhet të involvohen shumë faktorë. Edhe Komisioni i Kuvendit, edhe pjesa e ekzekutivit apo qeveria përkatëse më e lidhura ndër to e po ashtu edhe faktori ndërkombëtar në segmentet që mund të lidhen këtu. Në këtë bazë, ne mendojmë se do të bëjmë diçka më shumë sesa në debatin e sotëm. Ju falemnderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Fjalën e ka Xhezair Murati. Le të përgatitet Mahir Jaggjillar

XHEZAIR MURATI:

Gospodine predsedavajući, dragi kolege,
Konačno smo našli jedan problem koji se tiče kvaliteta života a to je problem koji nedvosmisleno predstavlja jedan od najvećih poteškoća sa kojima se suočavamo. Kosovo je u svakom momentu pola u mraku, pod uslovom ako imamo tri i ako nemamo tri sata energije. Šta bi bilo ako bi privreda radila u većem procentu. Kakva bi onda situacija bila? U javnosti kruže razne pretpostavke i priče a kružice još više ukoliko se sa ovim problemom ne suočavamo ovako javno i transparentno.

Ja živim u Prizrenu i Prizren neki zovu "agregat-siti". Ja mislim da je slično i u drugim gradovima Kosova. Neko je izračunao kada bi novac koji smo utrošili u agregate i derivate da bi smo mogli da napravimo hidroelektranu ili termoelektranu koja bi malte ne zadovoljavala potrebe struje koju je nemamo, dakle polovinu. To je jedno. Drugi su opet izračunali nezvanično da su dugovi toliko veliki da bi mogli jednu poveću hidroelektranu da napravimo. Ovde je pitanje kako ukloniti uzroke i pitanje kako naći modus i izići iz svega ovoga. Bilo je priča o tome da je u planu Hidroelektrana "Žur". Postojali su čak i neki konkretni podaci o tome i tako dalje, stalo se – ne znamo! Ovo je institucija i ovo je najviši organ vlasti Kosova i mi moramo ovim problemom da se bavimo. Živim u kraju gde je procenat plaćanja malo veći, znam to sigurno, nego u nekim drugim sredinama. Jednostavno građani kažu treba imati struje onoliko koliko je plaćash. Analogno tome, ta sredina o kojoj govorim, trebala bi da ima u većem procentu struje nego što ima. No moraju da se naprave mehanizmi izlaska iz svega ovoga kao što smo napravili za telefone, kao što smo napravili za neka druga dugovanja, da ubedimo javno mnjenje da ono što je rekao i kolega pre mene, ono što trošimo moramo i da platimo. Naročito boli kada duguju oni koji imaju para. Moraju da se naprave mehanizmi od resornog ministarstva a to je recimo sigurno Ministarstvo industrije i trgovine kako napraviti jednu listu prioriteta i koga da oslobodimo od neplaćanja. Ali one koje ne oslobodimo, onda moramo imati veoma oštre mere ukoliko su oni dužnici neplatiše i tako dalje. U tom smislu mi moramo što pre da izadjemo sa jasnim podacima pred građanima. Na kraju krajeva ovo su problemi zbog kojeg smo i izabrani ovde i svako daljnje zataškavanje stvaraće nove, da ne kažem tabu pitanja, tabu probleme koje građani svakodnevno postavljaju.

Evo, za sada ja toliko, ali stvarno mislim da nam se upalilo crveno svetlo kada je ovaj problem u pitanju. Hvala vam kolege.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

E ka fjalën Mahir Jaggjillar. Le të përgatitet Xhevdet Neziraj.

MAHIR JAGGJILAR:

Sayın Başkan değerli millet vekilleri. Gerçekten bu problem hepimiz için güncel bir problemdir. Gördüğümüz kadar elimizde gereken raporlar yoktur. Sayın Fatmir beyin dediği gibi elimizde raporların olması gerekiyor. Bu raporlar konusunu gündeme almamız gerekiyor. Yanlız KEK in termosantrallerle ilgili sorun değil. Sorun hergünkü hayatta da var. Trafo istasyonları, köylerdeki düşük voltaj, bazı köylerde 240 voltaj bile yok, sadece 120. Hiçbir araç çalışmıyor. Onları da nasıl çözeceğiz. Dolayısıyla bütün bu şeyler içerisinde raporların yapılması gerekiyor. Aynı zamanda Mecliste bu konuların tartışılması gereklidir. Elektriğin fiyatı bizim için uygun mudur, onun için de bir kalkulasyonun yapılması

gereklidir. Kimler ödüyor, hangi belediyelerde nekadar ve nasıl ödeniyor diye bir raporun yapılması uygun olurdu. Bu raporlar toplandıktan sonra sanırım hepimiz burda bu konu üzerine çok daha hazırlıklı konuşabiliriz. Dolayısıyla ilerde de bu konu üzerinde tartışmamız ve daha hazırlıklı olmamız, hem Kosova halkı için, hem de parlamentonun daha iyi çalışması için iyi bir gündem olurdu. İlginize teşekkürler.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

E ka fjalaën Xhevdet Neziraj, le të përgatitet Ramadan Kelmendi.

XHEVDET NEZIRAJ:

I nderuari zoti kryesues, të nderuar deputetë,
Unë dola këtu jo vetëm që ta përkrah këtë që Partia Demokratike dhe zoti Limaj shprehu por desha ta argumentoj edhe atë që zoti Sejdiu theksoi se duhet të kërkohet përgjegjësi edhe ndaj atyre organeve vendore dhe të huajve dhe të vijnë këtu dhe t'i tregojnë shkaqet. Këtu dola që ta argumentoj edhe një gjë, kur ishim në Këshillin transitor të Kosovës, këtu për fat është edhe zoti Kolë Berisha dhe zoti Fatmir Limaj, ku si grup i ekonomistëve kërkua nga Përfaqësuesi special që të na raportohet në lidhje me KEK-un, ai për vetëm një raport të shkurtër nuk na lejoi që të hapim debat dhe aty më ka lindur dyshimi se ka korrupcion edhe në kuadër të personave që vijnë nga vetë UNMIK-u dhe dolën 5 milion për të cilat nuk dijmë se kah shkuan. Prandaj, është i pabazë arsyetimi për këto 3 vite të parrymë, e di që ka amortizim moral dhe amortizim fizik të atij termocentrali por të kishte ndodhur ajo në Gjermani jo vetëm që do të kishte me u ndërtuar një termocentral i ri po ndoshta edhe një central bërthamor. Ndërsa, është e paarsyeshme dhe e palogjikshme të thuhet nëpër media që kualiteti i thëngjillit është i dobët, ndërsa ai termocentral ka funksionuar një kohë të gjatë dhe përveç se ka furnizuar Kosovën me rrymë kemi mbajtur edhe shumë ish republika jugosllave dhe shumë fabrika si Hekuranën e Shkupit dhe fabrika tjera në ish republikën jugosllave. Ju falemnderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Deputeti Ramadan Kelmendi, le të përgatitet Berat Luzha.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë dhe ministër,
Mendoj se nuk kemi vetëm krizën energjetike në Kosovë, por në Kosovë kemi krizën që quhet "Trepçë", krizën që quhet "Feronikel", krizën që quhet "Hekurudhë", krizën që quhet "Doganë", krizën që quhet "Aeroport", krizën që quhet "gjqësi kosovare", krizën që quhet "PTK" dhe kriza e kriza tjera. Megjithatë, unë kam dy propozime të cilat do t'i arsyetoj. E para: mendoj se ne nuk duhet të formojmë komisione por duhet të kemi këtu prezent shtyllën e katërtë, që

do të vijë në Kuvend të paraqesë raporte financiare, raporte të punës, raporte të fuqisë punëtore dhe raporte që kanë të bëjnë me të gjitha këto kriza të lartëcekura. Dhe, e dyta: duhet të kemi raportin e politikës operuese të Agjencisë për Mirëbesimin, i cili do të raportojë këtu dhe në bazë të tyre të rrumbullaksohen të gjitha këto kriza dhe të propozohen rrugëzgjdhje.

Është mëse e vërtetë se kriza energjetike është e rëndë në Kosovë. Tani një kohë të gjatë ne të gjithë qytetarët e Kosovës përjetojmë errësinë dhe të ftohtit. Ne nuk na është e qartë se së paku sa prodhohet rrymë, si shpërndahet kjo, ku shkojnë mjetet e grumbulluara nga qytetarët duke mos e përmbledhur në këtë fjalim ku shkojnë mjetet dhe pse nuk i dhënë mjetet ata që kanë mundësi më të mëdha potenciale prodhuese dhe ekonomike. Po sot ne nuk kemi asnjë ndërmarrje prodhuese në një anë, dhe në anën tjetër, rryma shpenzohet. E dini se dikur "Trepça" dhe "Feronikeli" ishin shpenzuesit më të mëdhenj. Ata nuk shpenzojnë sot rrymë. Çka ndodhë, pra me gjithë këtë rrymë? Por, në anën tjetër, në disa pjesë të Kosovës ka rrymë. Këtë po ua them me përgjegjësi. Për shembull, pjesa veriore e qytetit ku unë jetoj, pra Mitrovica ka rrymë. Nga e merr nuk e di. Asaj pjese, edhe nëse i ndalet, i ndalet vetëm një orë. Flas për Zubin Potokun me përgjegjësinë më të madhe. E ka një hidrocentral të vogël dhe ka rrymë, fshatit Çabër kurrë nuk i ndërprehet dhe po ashtu edhe Zveçani, tash komunë e re. Këto tri lokalitete, gjegjësisht komuna të riformuara çdoherë kanë rrymë. Shtrohet pyetja – pse? Ne interesohemi për Elektroekonominë, Trepçën, Feronikelin, Doganën, Aeroportin, Gjyqësinë e tjera, nga fakti se këto janë begati me tretman shtetëror, prandaj duhet po në këtë mënyrë të përcaktohen prioritetet dhe ky Kuvend të kërkojë një lloj përgjegjësie dhe argumenti.

Po e përfundoj: Jemi dëshmitarë se në Kosovë po ballafaqohemi edhe me disa kriza tjera, të cilat edhe i ceka. Do të ceku njërin të cilën nuk mund ta anashkaloj. Një ndër ato kriza shtangimi i jetës sonë; pengimi i funksionalizimit të shtetit dhe të organeve të tij e kjo quhet kriza e drejtësisë kosovare, e cila rëndon më shumë se rryma dhe errësira. Tri fakte dhe po e përfundoj. Në Kosovë u caktuan gjyqtarët dhe prokurorët....

(Ndërhyn kryesuesi: ju kisha lutur me iu përmbajtur rendit të ditës. Debati ka të bëjë vetëm për një çështje dhe në fund mundesh me propozuar ose si deputet ...)

Mirë, por është një ndër krizat. Tri fjali dhe po e përfundoj. Po propozoj në fund që të diskutohet edhe për këto tri kriza:

1. Në Kosovë u caktuan gjyqtarët dhe prokurorët pa u dhënë pëlqimi i Kuvendit të Kosovës dhe ata përveç që nuk dhanë betimin para këtij Kuvendi dhanë betimin dhe filluan të funksionojnë.

2. Kuvendi i Kosovës ende nuk e ka shqyrtuar dhe miratuar ligjin penal të Kosovës, dhe

3. Drejtësia në Kosovë, mjerisht ende ndahet me ligje diskriminuese të Jugosllavisë, që nuk ekziston dhe të një Serbie që po riformohet si shtet dhe nuk i zbaton as vetë ato ligje.

Prandaj, këto kriza janë baraz edhe me krizën energjetike. Ju falemnderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Unë ju kisha lutur që mos të dalim jasht rendit të ditës. Nuk kam dëshirë askujt t'ia marr fjalën dhe nuk jam i disponuar ta bëj këtë. Megjithat, ne kemi një rend dite dhe unë si drejtues i seancës kam një përgjegjësi për t'iu përmbajtur rendit të ditës që e kemi miratuar bashkërisht. Fjalën e ka Berat Luzha. Le të përgatitet Agim Krasniqi.

BERAT LUZHA:

Të nderuar deputetë,

Problemi energjetik në Kosovë është bërë një problem kancerogjen, i cili vazhdimisht po e mban Kosovën në ankth dhe mendoj se është një nga shkaqet kryesore që Kosova ka mbetur kështu siç është në pamundësi të zhvillimit dhe përparimit, përkundër investimeve të mëdha që janë bërë dhe mendoj investime galopante, të cilat megjithatë janë pa një transparencë të duhur dhe për të cilat asnjëherë opiniononi ynë nuk ka dijeni se sa janë investuar, kush ka investuar, ku kanë shkuar ato. Nga ana tjetër, të gjithë dijmë se paratë që janë gjendur në Gjiblartar, burgosja e Trashlerit dhe problemet tjera, bëjnë të syzozojmë se aty ka korrupsion të madh, ka defekte të mëdha. Përkundër kësaj gjendje ne kishim një përmirësim të gjendjes në fillimin e këtij viti, që zgjati disa muaj, e kjo ishte 7-8 muaj, por që në korrik, me rastin e avarisë që ndodhi në Termocentralin "Kosova-B" u krijua përsëri situatë ashtu çfarë ishte më parë e që po zgjatë me vite të tëra. Faji për këtë avari iu la zotit si një alibi, e mendoj që nuk do të duhej të pranohej nga Kuvendi. Kuvendi është mirë që ka hapur këtë temë dhe mendoj se duhet të vazhdojë edhe në seanca tjera dhe duhet të kërkojë patjetër që organet kompetente, qoftë edhe Qeveria, edhe KEK-u, edhe Bordi mbikëqyrës energjetikë a çfarë është ai, të dalin me shënime të sakta dhe unë përkrahu propozimin që Komisioni i cekur të bëjë hulumtime dhe të nxjerrë raport të sakt për gjendjen çfarë është atje. Ju falemnderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Agim Krasniqi, le të përgatitet Hasan Meta.

AGIM KRASNIQI:

Ju falemnderit. Siç po shihet nga reagimet e kolegëve deputetë kjo pikë e rendit të ditës nuk është përgatitur mirë. Po them jo mirë dhe në të vërtetë kjo aspak nuk është e përgatitur dhe diskutimet tona nuk do të jenë efikase e as nuk do të kenë një qëllim që ne do ta parashtrojmë para veti që të arrihet diç me këtë debat të sotëm. Mirëpo, megjithatë, mendoj se do të jetë e rëndësishme që në fjalën time ose thjesht në dy faqet tekst që do t'i lexoja, ndoshta do të jetë një kontribut i vogël që edhe ky debat, kaq i varfër i sotëm, të jetë një pikënisje që në të ardhmen vërtetë të ballafaqohemi me probleme të mëdha dhe shumë komplekse që energjetika e

Kosovës drejtpërsëdrejti, apo konkretisht, Koorporata energjetike e Kosovës, gjendet në një fazë të vështirë, jo që tash është krijuar por që është prej përfundimit të luftës dhe tani e tri vjet e gjysmë.

Komisioni parlamentar për gatishmëri emergjente, ka shfaqur interesimin e vet që të dijë diç më tepër rreth avarisë që ndodhi më 19 korrik 2002 dhe ne kemi arritur që në bashkëpunim me udhëheqjen e KEK-ut të marrim një informatë të shkurtër rreth asaj se çka ka ndodh por edhe rreth asaj se çka pritet në perspektivë për sanimin e gjendjes dhe si të përgatitemi për dimrin që është në vazhdim e sipër. Po them nga aspekti vetëm i fatkeqësive elementare, fatkeqësive natyrore, që fatkeqësisht ndodhi edhe një avari tjetër – shembja e dheut dhe ajo ka pasoja aspak më të vogla sesa pasojat që ishin nga rrufeja. Këtë e përmendi parafolësi, zoti Berat Luzha, ka qenë apo nuk ka qenë e besueshme ajo që u dha si arsyetim që ndodhi rrufeja, shkaktari i asaj avarie ishte rrufeja, megjithatë ne dy javë pasi ndodhi ajo kemi pasur një informatë nga zoti Shtajner, nga zoti Feler, zëdhënës i policisë ndërkombëtare dhe ekspertë tjerë dhe Komisioni profesional që është formuar në nivel të KEK-ut se vërtetë shkaktar kryesor i avarisë ishte rrufeja. Ajo ka mbet si e tillë dhe të them gati e padiskutueshme që nga atëherë.

Më lejoni që unë të lexoj këtë shkresë që e kam marrë si informatë nga KEK-u e të cilën ne e kemi në Komisionin parlamentar për gatishmëri emergjente dhe me të cilën posedon çdonjëri anëtar i Komisionit. Ndoshta do të zgjasë pak por po provoj që shpejt ta lexoj këtë.

I n f o r m a t ë

Rreth gjendjes së krijuar pas zjarrit në Termocentralin “Kosova-B” më 19.07.2002.

Në orët e mbrëmjes, të datës 19.07.2002 rrethinën e Termocentraleve e ka përfshirë një mot i ligë, i shoqëruar me rrëbesh shiu, breshëri, bubullimë dhe vetëtimë. Në orën 20,22 minuta e 24 sekonda, të jam i sakt, rrufeja ka goditur transformatorin e

ashtuquajtur OBT-220/6.3 KV. Sipas analizave të bëra nga grupi profesional i KEK-ut, në momentin e goditjes rrufeja ka shkaktuar depërtim të izolimit në mes

të kablllove. Nga lidhja e shkurtër e krijuar është shkaktuar ngritje jashtëzakonisht e shpejtë e temperaturave dhe paraqitja e zjarrit. Për shkak të zgjedhjeve teknike ekzistuese, renditja e kablllove, karakteristikave teknike joadekuata të situatae të tilla e tjera, zjarri është shpërndarë me shumë shpejtësi nga nivele të ulëta në lartësi të objektit. Relativisht shpejt në vend kanë arritur ekipet e zjarrëfikësve të KEK-ut, KFOR-it, TMK-ës dhe shërbimet gjegjëse të UNMIK-ut, si dhe pothuaj i gjithë stafi udhëheqës i Termocentraleve dhe KEK-ut. Përkundër masave të marra, zjarri ka mund të lokalizohet vetëm në orët e hershme të mëngjesit të asaj nate. Pasi bloku i Termocentralit "B-2" ka qenë në punë të parregullt, në situatat e tilla, dëmet e tilla, dëmet kanë mund të jenë shumë më të mëdha, por vlen të theksohet se reagimi i shpejtë i personelit operues të cilët në kushte tejet të rënda kanë arritur në ndaljen e dhunshme të blokut ta bëjnë sadokudo të rregullt dhe të shpëtohen pajisjet kryesore: është larguara hidrogjeni nga gjeneratori elektrik; vaji nga turbina e avullit e tjera. 35 punëtorë janë lënduar dhe një, për fat të keq, ka humbur jetën. Ky zjarr ka shkaktuar dëme relativisht të mëdha, mirëpo kur merret parasysh se kanë shpëtuar pajisjet vitale të Termocentralit, si turbina e avullit, gjeneratorët elektrikë, pompat, mullinjt, motorët e tjera, mund të thuhet se dëmet kanë qenë të kompensueshme. Dëmet më të mëdha janë shkaktuar në Termocentralin "B-1" dhe në këtë njësi janë djegur në tërësi sistemi i kablllove elektrike; sistemi i matjeve; rregullimit dhe komandimit; është shkatërruar në tërësi dhoma komanduese, si dhe është dëmtuar një pjesë e konstruksionit të objektit nga temperaturat e larta. Në Termocentralin "B-2" i cili ka qenë në punë normale, dëme më të mëdha janë shkaktuar në sistemin e matjeve; komandimit dhe rregullimit. Është djegur gjithashtu në tërësi dhoma e komandimit, si dhe janë shkaktuar dëmtime tjera nga kontakti me zjarr në sistemin e ventilimit; të izolimeve të objektit; të dyerve, dritareve e tjera. Dëm, po ashtu i madh, është shkaktuar nga paaftësia për një kohë të gjatë për prodhim të të dy njësive.

Pas lirimimit të objektit nga ana e policisë së UNMIK-ut, grupi për riaktivizim të Termocentralit "B" ka filluar punën në objekt dhe ka bërë vlerësimin e dëmit si dhe ka caktuar prioritetet e punëve në drejtim të sanimit të gjendjes. Sipas vlerësimit të këtij grupi, vlera e përafërt e investimeve që duhet bërë për sanimin e gjendjes në të dy njësitë e Termocentralit "Kosova-B" është 35 milion euro. Në këtë shumë përfshihen edhe zgjedhjet e reja teknike si dhe punët tjera që nuk kanë të bëjnë me dëmet nga zjarri por që janë të domosdoshme për t'u bërë.

Dhe parashikimet e udhëheqjes, konkretisht të Drejtorisë operative të KEK-ut janë këto: Deri në fillim të dhjetorit, e ne jemi veç në vazhdim e sipër, është paraparë lëshuarja në prodhim e njësitet të Termocentralit "B-2". Për këtë është nënshkruar kontrata me Konzorciumin Alstom ... në vlerë prej 11 milion euro, nga të cilat rreth 2.5 milion euro do të investohen nga KEK-u për intervenime në disa njësi teknologjike të veçanta. Në tri drejtime kryesore është orientuar aktiviteti për sanimin e gjendjes në Termocentralet "Kosova-B":

1. Riparimi emergjent i "B-2"-shit, i cili pritet të kryhet deri në fillim të dhjetorit. (Kjo është paraparë do të thotë para se të fillojë ky muaj);
2. Hartimi i dokumentacionit teknik për tenderim, që tashmë është publikuar nga AER-i për riparimet që planifikohen të bëhen vitin e ardhshëm në Termocentralin "B-1" dhe Termocentralin "B-2";
3. Përfundimi i riparimeve, sipas kontratave të mëhershme, për Termocentralin "B-1" dhe Termocentralin "B-2" – punët janë në vazhdim e sipër.

Qitja jashtë prodhimit e të dy njësive të Termocentralit "B" e ka detyruar KEK-un që të bëjë ndryshime edhe në planet për Termocentralin "A". Është paraparë dhe është duke u punuar në aftësimin edhe të njësive të Termocentralit "A-2" dhe Termocentralit "A-5" për këtë dimër. Për riparimet e domosdoshme në këto dy njësi është siguruar një fond shtesë prej 9.5 milion euro nga Qeveria Gjermane, përmes Institucionit financiar KfV, pastaj Danidas, si dhe buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Sipas planeve emergjente të hartuara në përputhje me situatën e krijuar pas zjarrit në Termocentralin "Kosova-B" për dimrin e sivjem është paraparë që të futen në funksion të gjitha njësitë e "Kosovës-A" dhe Termocentrali "B-2".

Ky është fundi i informatës, mirëpo kjo ka të bëjë, po them, vetëm për situatën që është krijuar pas zjarrit të shkaktuar në korrik të këtij viti. Kjo është e gjithë që desha ta paraqes. Ju falemnderit. Mund ta keni secili me shkrim. Ju falemnderit shumë.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Hasan Meta, le të përgatitet Fatmir Rexhepi.

HASAN META:

Zoti kryesues, unë nuk do të marr shumë kohë por do të qes punën në një mënyrë krejt tjetër. Pajtohem me gjithë ato që u vlerësua këtu. Për qytetarin e Kosovës është me rëndësi të ketë rrymë. Nuk ka rëndësi në çfarë mënyre vjen drita por duhet të ketë rrymë. Për Kosovën është fundamentale që të ketë rrymë dhe të zhvillohet. Unë këtu i bëj dy pyetje, që kur të përpunohet ai material nga ata njerëz që janë kompetent të japin të gjitha - se a mund ne ta mbajmë në funksion Kosovën me këto termocentrale në të ardhmen, dhe e dyta – a ka deshtim të UNMIK-ut dhe të faktorit vendor në këtë çështje; cilat janë pasojat politike dhe a mos po bëhen shumë gjëra këtu apostafat në mënyrë që drejtimet e ndryshme politike të orientohen atje ku nuk duam ne. Ju falemnderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Fatmir Rexhepi, le të përgatitet Gani Koci. Po, po mund ta merrni fjalën. Urdhëroni zoti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI:

Unë kërkoj falje prej atyre që janë paraqitur për diskutim e nuk dija ka shumë. Pata qëllimin të ndërhyj e të mos bëjmë diskutime të mëdha por thjesht propozimet që kanë dalë gati të unifikuara nga tri grupet parlamentare t'i votojmë dhe të kalojmë tutje, por meqë s'ka shumë të paraqitur për fjalë, unë po tërheqem.

FATMIR REXHEPI:

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Në rend dite kemi debatin i cili kërkon një qasje shumë serioze për shkak të gjendjes së rëndë që vazhdon që nga viti 99 e deri në ditët e sotme në të gjitha fazat në Koorporatën energjetike të Kosovës: terr i përditshëm dhe tërë problematika të cilën e ka përcjell këtë koorporatë, e cila është ndërmarrje me rëndësi për Kosovën, siç u cek këtu, për zhvillimin ekonomik përmes furnizimit me energji elektrike, pra edhe për ekonominë familjare, për qytetarët dhe për zhvillimin e përgjithshëm. Prandaj, kjo gjendje je rëndë është bërë e padurueshme dhe vërtetë nuk mund të gjenden arsyetimet sepse terri vazhdon, kurse ne duhet ndërmarrë atë që mundemi edhe si Kuvend në kuadër të kompetencave dhe këtë ta delegojmë te ata prej të cilëve duhet të kërkojmë përgjegjësinë. Unë mendoj që prej fazës së vitit 1999 e deri në vitin 2002, do të thotë veç e veç, përgjegjësia duhet të ekzistojë ose të kërkohet nga Bordi mbikëqyrës dhe bordet ekzekutive që kanë menaxhuar këtë Koorporatë në transparencën për të gjitha zhvillimet që janë bërë brenda Koorporatës, domethënë edhe ato teknike, afariste, ekonomike dhe të tjera e pastaj në gjithë procesin që nga hallka e prodhimit e deri te faza e distribuimit, shpërndarjes dhe inkasimit të mjeteve duke mos harruar tri çështje që do t'i përmend këtu: Në cilëndo informatë që vjen këtu në Kuvend, unë do të kisha kërkuar përgjegjësi për investimet që janë bërë dhe ato investime pse nuk kanë rezultuar me prodhimtarinë e energjisë elektrike dhe me distribuimin e saj për qytetarët dhe ekonominë e Kosovës. Nga shënimet që kam marrë prej zyrtarëve atje nga departamenti përkatës, do të thotë donacionet dhe subvencionet edhe nga buxheti i Kosovës, që me shumë vështirësi është grumbulluar, për vitin 2001 kanë qenë me miliona e miliona euro. Në kapacitetin prodhues që është jashtë atij instalues e që është më i madh 940 megavatë janë prodhuar diku 2.500 gigovatë orë elektrike e që është diku 50% më pak sesa 10-12 vjet më herët. Përkundër pra investimeve kapitale që janë bërë në këtë Koorporatë. Ka vazhduar pra reduktimi, ka vazhduar terri në Kosovë dhe bilanci vjetor i vitit 2001 është se kjo Koorporatë, apo KEK-u ka punuar me humbje prej 8.4 milion euro. Shtrimi i përgjegjësive për

mua është te humbjet e energjisë elektrike. Konsumi i Kosovës për vitin 2001 është rreth 3.124 gigovatë orë energji elektrike. Humbjet që u thanë këtu, vjedhja, për me kuptuar më drejt, do të thotë vjedhja e madhe që është bërë në rrjetin bartës dhe distributiv deri te shtëpitë atje – është 50% prej kësaj. Këto janë shënime që i kam marrë zyrtarisht. Pra, në fazën e pasluftës janë enorme këto, janë shumë të mëdha, të cilat kanë të bëjnë me dy çështje: të natyrës teknike dhe të natyrës komerciale. Të natyrës teknike, në fillim kanë qenë mungesa e njuhësorëve elektrik dhe shumë punëve tjera, përkundër investimeve po them të mëdha që janë bërë, edhe të natyrës komerciale, i mosleximit do të thotë i njuhësorëve nëpër enklavat serbe dhe shumë çështje tjera që kanë ndikuar drejtpërdrejt në anën komerciale. Tjetra është për mua shtrimi i përgjegjësisë për shkallën e ulët të inkasimit. Pra, organizimi i dobët përkundër të gjitha mjeteve në disponim teknike që kanë ekzistuar në të gjitha qendrat e Kosovës – inkasimi i mjeteve është sjell herë 30%, pastaj 50% dhe nuk kalon mbi 55%.

Si përfundim, unë do të kërkoja si deputet një raport këtu para Kuvendit prej organeve përgjegjëse, qofshin ato vendore apo ndërkombëtare që po e menaxhojnë dhe e kanë menaxhuar KEK-un, një transparencë dhe masa plotësuese, do të thotë në vlerësimin e drejtë dhe me përgjegjësi të plotë të adresohet për çdo vit veç e veç: 1999, 2000, 2001, 2002 dhe atë në fazën që na pret brenda 2-3 muajve kjo punë të bëhet. Vlerësim i drejtë dhe riorganizimin më efikas dhe më ekonomik brenda kësaj Koorporate që duhet të bëhet me një strategji të re nga Bordi; një mbikëqyrje të investimeve të cilat vazhdojnë dhe i duhen Koorporatës e për të cilat janë pikënisje e krejt atyre problemeve dhe keqpërdorimeve dhe në fund serish terri në Kosovë; dhe konsolidimi i prodhimtarisë, do të thotë, në hap me mundësitë maksimale që i duhen Kosovës të ketë rrymë. Prandaj, furnizimi me energji elektrike; inkasimi i mjeteve me masa plotësuese duhet të bëhet në Kosovë sepse pa u paguar rryma serish rrymë nuk kemi me pasë. Pra, unë do të kërkoja edhe një përgjegjësi më të madhe nga Qeveria që të implementohet në çështjen e KEK-ut edhe furnizimi i qytetarëve të Kosovës me rrymë dhe të gjitha këto masa çfarë ka mundësi të bëhen në kuadër të kompetencave. Ju falemnderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Gani Koci, le të përgatitet Bajrush Xhemajli.

GANI KOCI:

I nderuari zoti kryesues, të nderuar kolegë,
Do të përpiqem të jam sa më i shkurtër rreth kësaj çështjeje sepse nuk është kjo ditë që duhet të debatohet deri në fund pa raportet dhe materialet që do t'i përgatiste një komision i veçantë. Dje ishte një titull në të gjitha gazetat se Kuvendi ka shtruar

për debatim çështjen e energjetikës dhe të situatës në KEK dhe ai i pari i thirruri i shtyllës së katërt del me një deklaratë të veten dhe thotë se Kuvendi mund të debatojë vetëm në atë drejtim që t'i nxisë dhe shtyjë qytetarët që të bëjnë pagesën e

energjisë elektrike, kurse për situatën dhe gjendjen në KEK nuk ka kompetenca tjera të flasë Kuvendi. Unë konsideroj, duke u nisur nga kjo deklaratë, për 3 vjet sa funksionon KEK-u vjen në pyetje dhe vjen në shprehje ajo se deri më sot nuk ka as një rregullore të UNMIK-ut që bën rregullimin e menaxhimit dhe funksionimit të KEK-ut, do të thotë është e vetmja kompani ose i vetmi subjekt që nuk ka një rregullore të veçantë dhe ç'është më e keqja nuk lejohet ose nuk aplikohet Ligji mbi energjetikën, që ka qenë një ligj i vitit 1987 që do të mund ta zëvendësonte si po zëvendësohen shumë çështje tjera me ligje të aplikueshme. Dhe, unë konsideroj se një nga këto defekte në KEK është edhe mungesa e rregullativës ligjore për vetë KEK-un. Prandaj, konsideroj se komisioni që do të merret me këtë çështje do të duhej të dalë me një qëndrim të qartë se ka apo s'ka KEK-u rregullativë të veten dhe me çka rregullohet kjo. Sa kam unë njohuri dhe sa unë di, KEK-u sot funksionon dhe ka funksionuar që nga viti i kaluar vetëm me një të ashtuquajtur statut që ka diku një apo dy paragrafe dhe hiq më shumë dhe nuk përshkruhet në atë se ku e ka bazën ligjore, cili ka qenë ai organ që e ka miratuar atë statut për funksionimin e KEK-ut dhe ç'është karakteristikë se aty flitet vetëm për të drejtat dhe detyrat e bordit mbikëqyrës dhe jo të gjitha niveleve të organizimit të KEK-ut dhe çka është ajo më e veçanta se bordi mbikëqyrës na del si pronar i vetëm i KEK-ut i cili vendos gjithçka dhe si i teket për këtë çështje. Konsideroj se në këtë drejtim Kuvendi ka për detyrë që të kërkojë nga ata që thonë se është përgjegjësi e jona kjo një informim se në bazë çfarë rregullative ligjore vepron sot KEK-u.

Kur është çështja te furnizimi me energji elektrike, është një dokument i vitit të kaluar që përfaqësues pikërisht i shtyllës së katërtë dhe udhëheqësi, anëtar i bordit, ka qenë kryetari i bordit ekzekutiv, del me një dokument ku nëpër njësi të KEK-ut, njësi distribuive të KEK-ut, ata që bëjnë inkasimin e energjisë elektrike i njofton se nëpër enklava dhe në pjesët serbe nuk duhet të paguhet rryma. Kjo është vërtetë një diskriminim i pjesës tjetër të qytetarëve. Dhe, pikërisht ato pjesë ku nuk paguhet rryma dhe ku me urdhëresa të tilla s'paguhet rryma ato pjesë vazhdimisht janë të furnizuara me energji elektrike. Është një rast, rast i veçantë në KEK që vitin e kaluar është suspenduar një udhëheqës i një distribucioni pikërisht për shkak se ka bërë ndërprerje, ka shkëputur rrymën edhe në pjesët ku jetojnë serbët. Kjo gjë për mua do të ishte e papranueshme. Unë konsideroj se raporti që do të përgatitet duhet të përmbajë këto çështje: - të analizojë mirë menaxhimin e KEK-ut në këto 3 vjet e gjysmë, sa jemim pas luftës, sepse për këto 3 vjet janë ndërrue 5 drejtorë ekzekutiv të bordit të KEK-ut dhe gati po aq të bordit mbikëqyrës. Është një karakteristikë sepse te bordi ekzekutiv, me përjashtim të rastit të fundit, të gjithë anëtarët e bordit kanë shkuar sipas një rrotacioni prej një divizioni drejtor i një divizioni tjetër dhe pa ndonjë ndryshim tjetër të veçantë në këtë çështje. Prandaj, këtu komisioni do të duhej t'i përmbahej kësaj çështjeje dhe ta analizojë deri në fund. Pastaj, raporti duhet të përmbajë rolin e stafit vendor dhe sidomos rolin e stavit ndërkombëtar në menaxhimin dhe ristrukturimin e KEK-ut. Ka të dhëna dhe informacione, e kjo nuk është fshehtë as nga përgjegjësit e UNMIK-ut se në KEK zvogëlohet numri nga 10.000 në 3.000 dhe prej atyre 3.000 të jenë 1.500 serbë, sipas njëfarë proporcioni ku ta di unë pse është ashtu. Pastaj raporti duhet të përmbajë se kush ka mbikëqyrë realizimin e donacioneve dhe investimeve të shumta që janë realizuar në KEK; kush

e ka bërë realizimin e remonteve në KEK, sepse pas çdo remonti të madh ka ndodhë një avari e madhe, a është bërë pranim-dorëzimi teknik i këtyre remonteve dhe kush e ka pranuar atë si të tillë. Ka informacione dhe këtë mund ta thonë ata që janë përgjegjës sepse janë sjellë pjesë teknike që kanë dalë nga përdorimi prej termocentraleve të shteteve dhe të lindjes atje, por edhe nga Gjermania dhe janë sjellur në Kosovë dhe janë paraqitur me çmime shumë të larta. Këto mund t'i kërkojë nga Komisioni nëse vërtetë i shkon punës deri në fund. Pastaj transparencë të plotë lidhur me kontratat ndërkombëtare për eksport-import të energjisë elektrike. Rolin e agjencioneve të ndryshme që janë kyçur si ndërmjetësues në këtë çështje. Sepse mundësia e keqpërdorimeve më të mëdha është pikërisht në këtë drejtim dhe shfrytëzimi i KEK-ut bëhet pikërisht në këtë drejtim. Unë nuk jam ekonomist, nuk i di këto çështje por problemet dhe keqpërdorimet dhe vjedhjet më të mëdha bëhen pikërisht në realizimin e kontratave për eksport-import të energjisë elektrike. Po ashtu ky raport do të duhej të përmbante rezultatet e ekspertëve lidhur me avaritë e shumta që kanë ndodhur në termocentrale dhe mihjet sipërfaqësore dhe sidomos në Termocentralin "Kosova-B" dhe tash së fundi edhe në Mihjen sipërfaqësore. Për Mihjen sipërfaqësore po them se që një vit a ma shumë eksploatimi i thëngjillit ka qenë kryesisht nën menaxherë të huaj ndërkombëtar. Pse pikërisht ndodhi kjo rrëshqitje, pas kësaj avarie. Unë nuk mund të pajtohem kurrësesi me konstatimet, po them, politike sepse që e ka goditur rrufeja ishte konstatim së pari i Shtajnerit vetëm 6 orë pasi kishte goditur rrufeja, ku ende nuk kishin njerëzit qasje të drejtpërdrejtë në KEK e që edhe ekspertët është dashur... Prandaj, kërkoj që në këtë drejtim të bëhen ekspertiza të veçanta dhe të dalin me fakte dhe të dhëna të cilat edhe për ne do të ishin të pranueshme. Karakteristikë tjetër është se krejt problemi i KEK-ut don të përfundojë vetëm me rastin e quajtur "Gjo Trashler". Unë konsideroj rasti "Gjo Trashler" do të duhej të jetë vetëm nismë për të hulumtuar krejt atë se çka ka ndodhur në KEK. Neve vërtetë na duhet ndihma e ndërkombëtarëve por nuk nuk na duhet ndihma e pensionerëve ndërkombëtar dhe nuk na duhet aq më pak ndihma e ekspertëve, në thojza po e them, "tanë që bëhen servilë të atyre të ndërkombëtarëve". Ju falemnderit.

KRYSUESI XHAVIT HALITI:

Ju falemnderit. Bajrush Xhemajli, le të përgatitet Ilaz Pireva.

BAJRUSH XHEMAJLI:

Ju përshëndes të gjithëve. Do të përpiqem të jam shumë i shkurtër për dallim prej disave. Mendoj se furnizimi me rrymë është çështje shumë urgjente dhe derisa ne debatojmë dhe ndoshta do të ketë edhe ndonjë efekt pastaj edhe me ndonjë vendim e tjera. Mendoj se deri të stabilizohet prodhimi do të shkojë kohë shumë e gjatë dhe në këtë kontekst nuk duhet pritur së paku ata që janë përgjegjës në KEK, por furnizimi mendoj se duhet të bëhet menjëherë me energji, pa prodhim. Këtë e mundësojnë funksionimi i këmbimit energjetik rajonal, do të thotë në aspektin teknik mundësohet një gjë e tillë të importimit të rrymës. Anësat si duket qenka bërë edhe pa diskutue ne këtu fare nga ndërkombëtarët se duhet ne të insistojmë

vetëm për pagesë. Mendoj se është ekzekutivi i mjaftueshëm për me realizuar pagesat dhe ai që harxhon të paguajë, të bëhet një kontroll e tjera, të ndërpritet rryma për atë që s'e paguan. Për raste sociale mendoj se duhet të gjendet një rrugë, përmes komunës të zgjidhet kjo e tjera dhe kjo duhet menjëherë të funksionojë. Nëse nuk funksionon menjëherë e të pritët stabilizimi i prodhimit të "Kosovës-A" e "B", prishu e ndreçu, mendoj se do të jetë një tmerr i territ në Kosovë. Në këtë kontekst, mendoj se ka mundësi të realizohet shumë shpejt por po më duket që dikujt i ka konvencuar, i konvencion dhe do t'i konvencojë, edhe nga faktori ndërkombëtar por mendoj edhe ndonjë pjesë të UNMIK-ut e ku ta dij unë tjera, sigurisht më vonë do të mësojmë për krejt këto kujt i konvencion por do të bëhet vonë. Unë këtu apeloj te ata faktorë që janë relevant për këtë çështje e të bëhet një nismë e menjëhershme në këtë drejtim. Në Komisionit për tregti e industri në një formë së paku deri tash sa u diskutue po na lëhet një barrë e madhe. Me thënë të drejtën nuk po e dij edhe rolin se çka do të bëjë ky Komision edhe t'i ftonte të gjithë relevantët, po çka të bëjmë aty. Do të diskutojmë dhe prej asaj do të dilte një material por çka, unë nuk e kuptoj rolin mjaft të ju them të drejtën nëse dikush e kupton le të dalë e ta shpjegojë pak më mirë. Sigurisht që kisha marr për hirë të kësaj çështjeje shumë të ndieshme t'i ftoj njerëzit kompetent, do të ndihmojë sigurisht ndokush që din më mirë se kë ta thërrasim. Unë mendoj edhe për një çështje tjetër që duhet të thirret në interpelancë këtu ndonjë ministër që ndërlihet me punën e tij në KEK dhe së paku të na jepë përgjigje për shumë çështje. Këto janë ato që desha t'i them. Ju falemnderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Ju falemnderit. Ilaz Pireva, i fundit është Lirak Çelaj, i shkurtër do të jetë po thotë dhe s'ka tjera diskutime.,

ILAZ PIREVA:

Të nderuar deputetë,

Vërtetë do të jam i shkurtër. Mirë është që u hap edhe kjo çështje. Por, kur them – u hap, do të thotë kemi forcë edhe ta zgjidhim. Konsideroj, se kështu e ndiej borxh, e besoj edhe ju, për njerëzit që na punojnë atje duhet të thomë edhe këtu, prej këtij vendi – se kemi forcë për ta zgjidhë këtë problem. Do të thotë kemi mundësi prej punëtorëve atje më të thjeshtë e deri te ekspertët e nivelit më të lartë. Mos të harrojmë se ky ishte një gjigant yni që u bë prej njerëzve tanë, prandja kemi forcë që ky gjigant mos të bëhet dinosaur siç po dëshiron dikush. Prandaj, përkrahu inisiativën dhe formën se si do t'i qasemi këtij problemi përmes komisionit apo strukturave tjera, por gjithnjë duke pasur mbështetjen e njerëzve tanë të cilët i kemi të nivelit më të lartë. Ju falemnderit.

LIRAK ÇELAJ:

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë,
 Vërtetë do të jam i shkurtër kësaj radhe sepse edhe unë u pajtova me mendimin në fillim që të votohet për propozimet konkrete por meqë u hap debat dhe u propozua të formohet komisioni, edhe unë do t'i propozoj dy çështje. Unë kam informacione që KEK-u, megjithë këtë krizë financiare, kërkon mjete prej buxhetit shtetëror për ta ndihmuar blerjen e rrymës dhe kam informacione se janë blerë disa banesa për udhëheqësit e KEK-ut dhe janë në negociim edhe banesa komplet të reja që të blehen për disa udhëheqës të KEK-ut. Prandaj, mendoj se ai Komision duhet t'i hulumtojë pikërisht edhe këto gjëra dhe kam edhe informacione të sakta dhe konkrete për shkeljen procedurale të konkurseve për të udhëhequr, prandaj po na përsëritet ky gabim gjithmonë, do të thotë gjithmonë po jemi në kolaps sepse nuk po rrespektohen procedurat e zgjedhjes së udhëheqësve dhe nuk po udhëheqin njerëz të aftë, madje as ata që kanë konkuruar, por thirren me telefon njerëz që s'kanë konkuruar fare, vetëm pse janë miq apo janë në lidhje, kështu që ta quaj, e njëjta dinasti po udhëheq KEK-un, prandaj po dështon dhe nuk ka kurrfarë suksesi. Ju falemnderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Nga dëgjimi i diskutuesve u pa se është mirë që u diskutua. Shumë çështje që u ngritën këtu ... Urdhëroni, më duhet t'ua jap fjalën.

GANI PREKOPUCA:

Problemi është këtu se turrlifarë njeri qenka i informuar këtu e ne s'kemi kurgjë me shkrim për këtë. Nese dojmë me qitë fall, qesim deri në sabah, s'ka problem. Nëse ka pasur ndonjë dinasti përpara, është mirë me na i qitë këtu. Ekzistuesja këtu, e ardhshmja të qitet këtu e tani ta debatojmë. Këtu fall mundemi me qitë sa të duash. Askush nuk po shoh se ka shënime. I informuar, thotë, jam unë prej mahallës së Muhaxherëve, ai tjetri prej kësaj e asaj. Kjo problematikë kujtoj se është shumë me rëndësi dhe është mirë shënimet të jenë, të shohim ku jemi, çka jemi, ku janë kompetencat e këtij Parlamenti dhe mos të rrimë deri në sabah kështu pa lidhje. Kaq desha, s'desha ta zgjas.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Të falemnderit. Mendoj se shumë çështje që u ngritën mbase janë edhe në rrugë të shqyrtimit të procedurave gjyqësore por edhe disa çështje që janë ngritur nga deputetët të veçantë, pastaj do të duhej ata të merreshin me procedura gjyqësore dhe jo ne si deputetë. Megjithatë unë mendoj, pavarësisht se nuk është përgatitur ashtu siç u tha mirë si seancë dhe nuk janë përgatitur materialet e veçanta rreth

kësaj çështjeje dhe mbase një pjesë të përgjegjësive në Kryesi i kam personalisht sepse kam insistuar vetë që të merremi me këtë çështje dhe jam mbështet normalisht nga komplet Kryesia dhe s'ka qenë askush kundër e të mos shqyrtohet kjo këtu. Mendoj se nuk kemi bërë keq që kemi hapur si problem dhe mos ta zgjas mendoj se duhet formalisht ta hudhim në votim propozimin e mbështetur nga të gjitha grupet pothuaj se parlamentare, propozimin e Fatmirit, që Komisioni konform Rregullores dhe kompetencave që ka të thërras ndonjërin nga bordi i KEK-ut dhe të bisedojë me përfaqësuesit e Qeverisë ose me ministrat përkatës dhe nuk mund ta përjashtojmë edhe mundësinë e thirrjes së ministrave përkatës në interpelancë me pyetjet përkatëse për çështjen e caktuar dhe të vazhdojmë mendoj diku, sipas planit të Kryesisë, të shqyrtohet pas vitit të ri, sepse para vitit të ri edhe s'ka kohë.

A jeni dakord që ta votojmë propozimin e Fatmirit apo ka ndonjë propozim tjetër. A ka kush kundër? Askush. Ju falemnderit.

Njëherit, dua t'ju informoj që Kryesia në mbledhjen gjatë pauzës që patëm, mori vendim që ditën e hënë, do të thotë me datën 23 dhjetor, në ora 11, do ta shqyrtojë, përmes një debati këtu në Parlament, çështjen e buxhetit siç theksuam më herët.

Tani po vazhdojmë me rend të ditës – Parashtrimi i pyetjeve të deputetëve. Janë tri pyetje, dy prej tyre kanë përgjigjen me shkrim. Urdhëroni zonja Zylfije Honduzi.

ZYLFIJE HUNDOZI:

Kryesi e nderuar, kolegë deputetë,
Me përgjigjen që ka dhënë me shkrim ministri i shëndetësisë, në pyetjen e parashtruar nga unë, nuk jam e kënaqur për arsye se përgjigja është e përgjithësuar dhe sqaron në mënyrë sipërfaqësore situatën e vështirë në shëndetësinë kosovare. Njëherit arsyeton parregullsitë e shumta në punën e institucioneve shëndetësore me të cilën gjë në mënyrë indirekte pranon se ekzistojnë dhe nuk tregojnë se çka konkretisht Ministria do të bëjë për realizimin e reformave të cilat janë të domosdoshme në shëndetësi. Gjatë dhjetë muajve të funksionimit të Ministrisë së Shëndetësisë është vërejtur një indiferencë në punën e tyre për tërë situatën që ekziston në shëndetësinë kosovare. Zoti ministër është vetë mjek dhe ka dhënë betimin e Hipokratit dhe kjo e detyron atë që urgjentisht të ndërmerret masa për përmirësimin e kësaj situate të vështirë në shëndetësinë kosovare. Prandaj, unë thërras ministrin që të na japë përgjigje me gojë për pyetjen e parashtruar. Njëherit këtë do t'ia jap edhe Sekretarisë që t'i kalojë procedurat e nevojshme. Ju falemnderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Ju falemnderit. Në radhë kemi pyetjet që janë drejtuar nga deputeti Ismajl Kurteshi, ministrin të arsimit, shkencës dhe teknologjisë. Përgjegjen do ta japë ministri gojarisht dhe për këtë ia japim fjalën.

REXHEP OSMANI:

I nderuari zoti kryesues, të nderuar deputetë, Pyetja është e deputetit nga Gjilani. Në bazë të Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka të drejtë të nxjerrë udhëzime administrative për të përcaktuar kalendarin e vitit shkollor, orët e mësimit, pushimet shkollore, të ditës, pushimet e ndryshme si dhe çështje tjera. Në fillim të vitit shkollor Ministria ka nxjerrë Udhëzimin administrativ. Pyetja është e deputetit: Pse më 29 nëntor nuk është punuar, ditën e premte, një ditë pas festës së Bajramit, e tani nuk po më kujtohet data cila është. E enjte, po ashtu është një javë prapa. Në praktikën tonë shkollore dhe me rastin e shikimit të disa rrethanave, Ministria ka të drejtë që të bëjë korrigjime në udhëzimin e vet dhe nganjëherë jemi të detyruar dhe të obliguar të marrim vendime të cilat na imponon situata dhe na imponojnë rrethanat.

E dini se patë grevë të arsimtarëve dhjetë ditë dhe nxënësit pastaj filluan të punojnë edhe ditën e shtunë dhe ishte një ngarkesë tepër e madhe – gjashtë ditë punë, pastaj erdhën festat e nëntorit, që një pjesë e shkollave shtruan kërkesën për disa kolektiva për të shkuar në Shqipëri për Ditën e Flamurit, pastaj po ashtu patëm edhe kërekesa që edhe dita e premte, një javë më vonë, të zëvendësohet, kështu që Ministria e ka në planin e vet të punës zëvendësimin e këtyre dy ditëve po edhe të ditëve tjera në pranverë, domethënë pasi të përmirësohet edhe koha. Shpeshherë jemi shtrënguar edhe për shkak të nxemjes, temë shumë aktuale të cilën edhe ju e diskutuat, e që po reflektohet shumë ashpër në procesin mësimor në shkollat tona. Unë me kënaqësi kam ardhur t'i përgjigjem kësaj pyetjeje por ministri i industrisë dhe i tregtisë është ai i cili është dashur të ftohet për të dhënë përgjigjen në ato pyetje të cilat ishin shumë aktuale, për të cilat Qeveria ka biseduar dhe mendoj se është temë shumë më e ndërlikuar sesa që mendojmë ne. Qëllimisht e lidha këtë temën që diskutuat edhe me reflektimet që na bëhen në sistemin e arsimit dhe në procesin mësimor. Mendoj se ne do të jemi të kujdesshëm, domethënë edhe kur

është çështja e zëvendësimeve dhe ne do të rrespektojmë 37 javë të mësimit në vit, brenda 45 javëve të vitit shkollor dhe do të insistojmë që të plotësojmë programin e punës edhe atëherë kur ditët zgjaten në fund të vitit shkollor, diku kah fundi i majit. Ju falemnderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI:

Ju falemnderit. A keni ndonjë koment ju zoti deputet që keni bërë kërkesën për interpelancë. Nuk keni nevojë.

Është edhe një pyetje që zoti Sahit Krasniqi, deputet, e ka parashtruar për ministrin e shërbimeve publike, përkatësisht Ministrinë. Përgjigja është bërë me shkrim. A doni të bëni koment, në pyetjen e shtruar?

Atëherë, që mos ta zgjasim me komente, mendoj se seanca e sotme muar fund, sipas rendit të ditës. Të hënën do të ishte mirë që deputetët të marrin materialet e po ashtu edhe Komisioni i buxhetit dhe të vijnë të përgatitur.

Seanca e sotme do të vazhdojë punën të hënën, më 23 dhjetor 2002 dhe fillon në orën rreth orës 11.

===

Pjesa e parë seancës së mbajtur më 19.12.2002 mori fund në orën 14.

Pjesa e dytë e seancës plenare vazhdoi më 23 dhjetor 2002 filloi në orën 11,20.

Vazhdimin e seancës plenare e kryesoi Akademik NEXHAT DACI.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirënjohës dhe mirë se keni ardhur në vazhdimin e seancës plenare të së enjtës. Me kërkesë unanime u zgjerua rendi i ditës – Shqyrtimi i buxhetit të Kosovës. Prandaj sot vazhdojmë me atë pikë të rendit të ditës. Besoj se Qeveria është e gatshme, prandaj ftoj ministrin e financave, zotin Ali Sadriu që të bëjë një briefing deputetëve për çështjen në shqyrtim. Urdhëroni zoti ministër.

ALI SADRIU:

I nderuari kryetar, e nderuara Kryesi, të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë dhe nderin t'ju paraqes Projektpropozimin e buxhetit për vitin 2003. Këtij propozimi i është dhënë një prioritet i veçantë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe përgjithësisht në Qeveri.

Të nderuar parlamentarë,

Ju tani keni në dispozicion në dispozicion një dokument i cili ju mundëson një informim, një tablo të përgjithshme për agjencitë kryesore dhe në mënyrë të specifikuar, për agjenci të veçanta, ju mundëson që ju të bëni komentet tuaja, vlerësimet për buxhetin e vitit fiskal 2003.

Më lejoni që para se të përqëndrohemi në sqarimin e strukturës së buxhetit të propozuar të nënvizoj se jam i vetëdijshëm që Kuvendi i Kosovës ka përgjegjësinë e miratimit të ligjeve dhe jo të rregulloreve apo materialeve informative.

Megjithatë ne dalim para jush me këtë dokument i cili nuk kërkon miratimin e Kuvendit. Dëshira dhe përkushtimi im, si ministër i këtij Parlamenti, është që të sjell një draftligj mbi përvetësimet buxhetore të vitit fiskal 2003 i cili do t'i bashkëngjitet tablos së buxhetit i bazuar në Ligjin mbi menaxhimin e financave publike që dikush këtë e quan me të drejtë kornizë kushtetuese për Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, i hartuar nga një institucion dhe jo dy institucione siç ka ndodhur, duke mos përfillur procedurat e shqyrtimeve siç është miratuar në Kuvend, madje duke u quajtur draftrregullore e jo draftligj mbi buxhetin e vitit 2003.

Ligji mbi përvetësimet buxhetore është baza juridike e buxhetit për secilin vit fiskal veç e veç, përmes cilit shihet cili institucion ka hartuar këtë buxhet, pastaj nga cilat burime krijohet ky buxhet, cili është niveli i përgjithshëm i buxhetit, kujt i dedikohet ky buxhet, duke numëruar agjencitë, cilat janë politikat operuese dhe prioritetet e tyre, cilat janë kompetencat, cilat janë përgjegjësitë për moskryerjen apo mosoperimin jo të drejtë të politikave operuese duke përfshirë të gjithë ata që operojnë prej bashkëpunëtorit profesional, drejtorit të buxhetit, sekretarit të përhershëm dhe duke përfshirë edhe përgjegjësinë e ministrit.

Për vëmendjen tuaj theksoj se këto procedura të operimeve buxhetore që ne po bëjmë tani apo do të bëjmë sot, zakonisht bëhen në muajin tetor. Kjo do të ndodhte, sikur Këshilli ekonomik fiskal i datës 24 qershor 2002, i kryesuar nga PSSP, të kishte vullnetin për shqyrtimin e Ligjit mbi menaxhimin e financave publike, i hartuar nga Ministria në prill dhe i shqyrtuar në maj të këtij viti në Qeveri. Përfaqësuesit vendor në këtë takim kanë kërkuar që të jipen vërejtje konkrete në kapituj dhe nene apo pika të veçanta për vërejtjet eventuale dhe atë në mënyrë të përsëritur, por asnjëherë nuk na është oforuar as nga vetë PSPP-ja e as nga zyra ligjore e tij. Dhe, në fund, del konstatimi nga ky takim se Ministria për Ekonomi e Financa duhet të vazhdojë bisedimet me shtyllën e katërtë për mënyrën dhe nivelin e bartjes së përgjegjësiave, pa përcaktuar ndonjë kohë apo kufizime tjera të nevojshme.

Kam kënaqësinë që përfundimisht Projektligji mbi menaxhimin e financave publike është në Parlament duke pritur afatin kalimtar prej dhjetë ditësh. Këshilltarët me sygjerojnë se Rregullorja e punës e Kuvendit, kreu 22, me kërkesën e ministrit mund të trajtohet si çështje emergjente dhe të trajtohet. Andaj, ju kisha lutur që edhe kësaj çështjeje t'ia bëjmë komentet dhe nëse ka mundësi ta trajtojmë menjëherë.

Materiali që si i tillë është prezentuar para jush, është rezultat i takimeve të mbajtura në mes Ministrisë së Ekonomisë e të Financave, të Qeverisë dhe të Komitetit për buxhet pranë Kuendit të Kosovës, me të vetmin qëllim që Parlamenti të shqyrtojë, komentojë, ndryshojë, sygjerojë apo bëjë komente të veta mbi buxhetin fiskal të vitit 2003.

Të nderuar deputetë,

Para se të vazhdojë me ekspozenë për të sqaruar përmbajtjen e dokumentit për buxhetin për vitin fiskal 2003, do t'ju përkujtoj se kishte shumë takime, shumë sygjerime, shumë sfida të dhembshme pasi duhej të hiqeshin shumë programe të rëndësishme për të sotmen dhe të ardhmen e Kosovës, në mungesë të mjeteve të cilat nuk i kishim. Kam kënaqësinë të falënderoj për mirëkuptim të gjithë kolegët e mij në nivel të Ministrisë dhe Qeverisë që kishim gjatë hartimit të prioritetëve të këtij buxheti. Për vëmendjen tuaj po ju njoftoj se materiali i pjesës së rezervuar, i cili është bashkëngjitur këtij materiali, është hartuar dhe vendosur nga autoriteti qendror fiskal i cili ende nuk është shfuqizuar. Këtij materiali, Ministria e

Ekonomisë dhe Financave, Qeveria dhe Komiteti për buxhet do t'i bëjë një koment të vetin.

Tani, të nderuar deputetë, më lejoni që shkurtimisht t'i them dy-tri fjalë për indikatorët makroekonomikë të cilët e karakterizojnë këtë buxhet. Kosova me rreth 2 milion banorë, me moshës mesatare 24 vjet, shkalla e vjetërsisë mbi moshën 65 vjeçare me 7%, me shkallë të papunësisë rreth 47%, nëse marrim një kategori si të punësuar në ekonomitë e vogla bujqësore të publikuara nga Ministria për Ekonomi e Financa, Banka Botërore dhe Enti Statistikor. Këtu është fjala nëse merret një kategori si të punësuar, atëherë kemi 47%, përndryshe ajo sillet sipas shumë vlerësimeve edhe deri në 60 apo 70% norma e të papunës.

Përkundër kësaj, ekonomia e Kosovës, është duke treguar një progres në raport me pozitivën përkundër varfërisë së lartë në të cilën gjendet, e që është rezultat i të kaluarës së saj. Të dhënat ekzistuese tregojnë një rritje reale të aktiviteteve ekonomike që nga viti 2000.

GDP, i shprehur në miliard euro për vitin 2001, 2002 ishte 1.7 miliard gjegjësisht 1.9 miliard, ndërsa për vitin 2003 parashihet të jetë 2.1 miliard. GDP, për kokë banori për vitin 2002 ishte 1.051 euro kurse për vitin 2003 parashihet të jetë 1.122 euro. Konsumi për vitin 2001 dhe 2002 ishte 2.55 miliard euro, rrespektivisht për vitin 2002 2.74 miliard euro, parashihet që për vitin 2003 të ketë një rënie të lehtë dhe do të jetë 2.72 miliard euro, i cili do të jetë rezultat i proceseve të privatizimit që do të ndodhin, e kjo nënkupton investimet kapitale në një rënie të lehtë.

Investimet në vitin 2001 dhe 2002 ishin 968 milion euro rrespektivisht 938 milion euro për vitin 2002. Për vitin 2003 parashihet të kemi 817 milion euro si rezultat i zvogëlimit të donatorëve.

Neto eksporti për vitin 2001-2002 ishte minus 1.8 miliard, rrespektivisht 1.7 miliard euro, kurse për vitin 2003 parashihet të jetë 1.4 miliard euro. Kjo na tregon për nivelin e prodhimit vendor dhe angazhimit tonë që do të duhej të vazhdojë në këtë drejtim.

Inflacioni për vitin 2001-2002 ishte 11% rrespektivisht 6.5% për vitin 2003 parashihet të ketë një rënie dhe do të jetë rreth 4%.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të përkujtoj se Kosova edhe më tutje nuk ka të drejtën e emitimit të parave, përkundër që operojmë me euro. Kosova po ashtu nuk e ka të drejtën e huazimeve publike, andaj gjithëherë duhet të jemë shumë të kujdesshëm që buxheti ynë të jetë i qëndrueshëm.

Buxheti i konsoliduar i Kosovës për vitin 2003 është mesa vijon:

Nga pozicioni i doganave presim të hyrat 53.4 milion euro dhe do të jetë më i ulët se ai i vitit të kaluar për 2.6 milion euro. Këtu kemi të bëjmë me ndryshimin e politikave fiskale dhe ato ndryshime kanë rrjedhë si nevojë e prodhimit vendor. Të ardhurat nga akciza do të jenë 122.4 milion dhe më të larta për 13.33 milion euro karshi vitit 2002. Të hyrat nga TVSH në importim plasohet të realizohen në shumën prej 178.4 dhe janë më të larta për këtë vit për 18.4 milion euro. Ky pozicion është sipas bindjeve tona edhe më i lartë sepse pretendimet tona synojnë që TVSH e importuar apo e realizuar në kufij të bartet brenda në Kosovë dhe është një synim që duhet të ndodhë me proceset që duhet të pasojnë.

Të hyrat nga TVSH vendore do të jenë 25.1 milion euro dhe janë më të larta për 4.1 mil. Krahasuar me vitin 2002. Tatimi në fitim do të jetë 15.7 karshi vitit 2002 ku ishte 7.2 milion euro.

Tatimi i paragjykuar do të jetë në nivelin e vitit të kaluar dhe kap shumën 27 milion euro. Tatimi në të ardhurat personale do të jetë 16 milion karshi atij që ishte këtë vit 6.1 milion. Taksat tjera dhe denimet parashihen të jenë 21.7 milion karshi atij që ishte këtë vit 18.1 milion. Viti 2003 do të ketë edhe një të hyrë të re që do të aplikohet me aplikimin e tiketave në duhan dhe alkool dhe ajo shumë do të jetë rreth 5.2 milion euro.

Grantet e përgjithësuara nga donatorët për buxhetin e Kosovës për vitin 2003 do të jenë 25 milion. Këto i kemi marrë në momentin e fundit me rastin e hartimit të procesit buxhetor.

Totali i buxhetit të konsoliduar të Kosovës për vitin 2003 do të jetë 489.1 milion përkundër atij që ishte. Në këtë vit 409.3. Pra shohim se kemi një rritje për 19.50%. 95% të buxhetit do të financohet nga të hyrat vendore. 5% do të financohet nga grantet e donatorëve. Viti 2004 parashihet të financohet plotësisht nga të hyrat vendore. Buxheti i institucioneve të përkohshme të qeverisjes për vitin 2003 do të shënojë një rritje prej 28 milion euro, karshi vitit që po e lëmë, që totali i përgjithshëm do të jetë 237 milion euro. Këtu duhet pasur parasysh edhe një grand rezerv që figuron në buxhetin qendror në shumë prej 5.4 milion për investime kapitale që dedikohet si nxitje e investimeve kapitale kuvendeve komunale. Buxheti i përgjegjësive të rezervuara është 138.7 milion euro, përkundër shumës së këtij viti që ishte 125.5 milion euro. Shihet se diferenca është në rritje për 13.2mil. Për ne është e pakuptimt, pa logjikë sepse kemi bartje të përgjegjësive nga institucionet e rezervuara në institucionet vetëqeverisëse. Andaj këtu është dashur të jetë zvogëlim e jo rritje. Shembull mirret shkrirja e AQF në MEF apo shërbimi i zjarrfikësve që kalon nga pjesa e rezervuar nëpër kuvende komunale.

Buxheti për pushtetin lokal për vitin 2003 shënon një progres të dukshëm. Derisa në vitin 2002 ishte 84.8 milion euro, për vitin 2003 parashihet të jetë 141.1 milion euro, e që është më i lartë për 56.9 milion euro. Këtu duhet shtuar edhe një shumë që nuk figuron në këtë buxhet. Është fjala për të hyrat që realizohen nëpër kuvende

komunale nga tatimi në pronë, që ka filluar të aplikohet nga taksat dhe format tjera, dhe parashihet që ai në nivel të jetë diku 28 milion.

Edhe më tutje ndër agjencionet më të mëdha shpenzuese do të jenë mirëqenia sociale, arsimi, shëndetësia, telekomunikacioni, shërbimet publike, Ministria për Ekonomi e Financa dhe kështu me radhë.

Për vëmendjen tuaj do të reflektoj në disa agjenci shpenzuese me qëllim që t'i sqarojmë ato procese pse janë si të tilla. Buxheti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2002 ishte 73.2 milion euro. Për vitin 2003 parashihet të jetë më i madh për 9.40 milion euro. Shprehur në përqindje do të thotë për 12.8% dhe do të kapë shumën e gjithmbarshme prej 82.60 milion euro. Kuptojmë se nevojat për buxhet më të avancuar të kësaj Ministrie janë shumë më të larta. Kjo Ministri gjatë vitit 2003 do të inkorporojë edhe disa kategori, siç janë: invalidët e punës, invalidët me të meta dhe kufizime tjera, pastaj do të ketë sfida të reja të skemave të mirëqenies sociale si rezultat i procesit të privatizimit që në fazën e parë ndikon në kategori në të cilat ka shkurtime të vendeve të punës dhe do të ketë rënie të standardit të familjeve, prandaj do të duhej paraparë edhe skema të reja.

Buxheti i Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji shënon një avancim nga 74.10 milion euro në 82.88 milion euro i paraparë për vitin 2003. Ky avancim kryesisht vjen si rezultat i reformave dhe i dedikohen shpenzimeve për mallra dhe shërbime për investime kapitale në ndërtimin dhe renovimin e disa objekteve. Në këtë dokument nuk janë përfshirë të hyrat vetjake të cilat do të realizohen në kuadër të kësaj Ministrie në emër të participimit që parashihen të jenë diku 2 deri 2.5 milion. Kjo Ministri gjatë vitit 2003 do të përballet edhe më tutje me proceset e racionalizimit të vendeve të punës obligime këto të marrura si rezultat i rekomandimeve të Bankës Botërore dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë po ashtu shënon një ngritje nga 52.79 milion euro në 61.92 milion euro, e që është më i lartë për 9,00 milion euro. Edhe këtu kemi një participim që nuk është përfshirë në vlerën e këtij buxheti dhe parashihet që të jetë diku 3-4 milion euro. Gjithashtu, edhe kjo Ministri do të përballet me rekomandimet e Fondit Monetar dhe Bankën Botërore për obligime që flet karshi stafit në kuadër të kësaj Ministrie.

Ministria e Shërbimeve Publike shënon një rritje për arsyen e nevojave për akomodim dhe vendosje të institucioneve të vetëqeverisjes dhe zgjerimin e programeve ekzistuese, prandaj ka një avancim nga 13.96 milion në 19.80 milion euro.

Në prioritetet e Qeverisë është përmirësimi i infrastrukturës së rrugëve dhe kjo reflektoim në rritjen e buxhetit për transportin dhe telekomunikacionin. Derisa në vitin 2002 kishte buxheti 11.71 milion këtë vit do të ketë 22.89 milioin euro.

Kompletimi i administratës dhe zgjerimi i politikave për regjistrimin e bizneseve rezulton në rritjen e buxhetit për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Ministria për Ekonomi e Financa ka shënuar një rritje të buxhetit për arsye të transferit të përgjegjësiwe nga fuqitë e rezervuara në institucionet vetëqeverisëse, në këtë rast, në Ministrinë për Ekonomi e Financa.

Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësiror ka një rritje të ndjeshme të buxhetit për shkak të zgjerimit të programeve për planifikimin hapësiror, resurset ujore dhe çështjet e banimit.

Rezervat për raste të jashtëzakonshme për buxhetin 2003 (2002) figuronin 8.15 milion. Për buxhetin 2003 kemi një rënie në 3.58 milion por këtu fatmirësisht kemi një bartje të fondit rezerv nga viti 2002 që do t'i bashkëngjitet vitit 2003 dhe përafërsisht do të jetë kjo cifër paë më e madhe. Mund të jetë deri në 10 milion, ta zëmë.

Buxheti për pushtetin lokal shënon një avancim për vitin 2003 dhe kap shumën totale prej 141 milion, përkundër vitit 2001 që kishte 75.18 milion euro. Grande këto nga buxheti qendror dedikuar për pushtetin lokal. Përkujtojmë se pushteti lokal ka edhe të hyra të tjera siç ju thash më herët prej 28 milion euro që priten nga tatimi mbi pronën, taksat dhe format tjera dhe grandit që është paraparë për nxitjen e investimeve në kuvende komunale.

Të nderuar deputetë,

Siç e thash më lartë, buxheti i fuqive të rezervuara nuk është përgatitur nga Ministria për Ekonomi dhe Financa, andaj edhe nuk është paraqitur as nga Qeveria. Kurse, ju e keni materialin tuaj. Nuk dëshiroj të prezentoj para jush buxhetin fuqive të rezervuara sepse ai është përgatitur nga AQF i cili ende ekziston me pretendim se do të shfuqizohet. Megjithatë, ende ekzistojnë tendeca që diçka të komuflohet nga kompetencat e AQF dhe të barten tek një sekretari e KEF. Këshilli Ekonomik Fiskal në vetëvete është një institucion këshilldhënës dhe jo operues prandaj tendencat e tilla janë jo të ligjshme dhe do na sjellin probleme m'u si këtë vit. Materialin të cilin e keni para veti edhe pse është një tablo jo e sqaruar për ne, meriton një përqëndrim të vëmendjes sonë dhe tuajën në dy çështje jo vetëm për shkakun se pozicionet e tilla i kanë penguar agjencionet vendore, të përfshijnë disa nga programet e rëndësishme për nevojat e institucioneve vendore por edhe nga shkakun... Është fjala se buxheti në një pjesë është ndalë në përgjegjësinë e rezervuar. Po të mos ishte ndalë do të kishim mund të kemi mundësi që të reflektojmë në segmente të caktuara të jetës. Pra, jo vetëm nga ky shkak por ne mendojmë se është e palogjikshme dhe nga shkakun se janë në kundërshtim të plotë me rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, të Bankës Botërore dhe të disa donatorëve, ku në mënyrë të qartë sygjerohet që në buxhetin apo nga buxheti i konsoliduar i Kosovës nuk duhet të financohen ndërmarrjet apo kompanitë publike

apo ndërmarrjet shoqërore. Në materialin që ju keni prezent do të shihni, unë do të ju sjell sa për ilustrim për t'i parë disa nga ato pozicione. Ta zëmë:

Për Trepçën janë parapar 12 milion e 590 mijë euro. Ne nuk kemi specifikim as arsye pse ndodh kjo. Për ngrohjen qendrore 3 milion; Për Aeroportin 2 milion; Për RTK-ën 2 milion; për Hekurudhat 2 milion. Dhe, çështja e dytë, që është brengë jona është fondi rezerv për nevojat e rezervuara që kap shumën 11 milion e 320 mijë euro. Siç shihet, këtu kemi të bëjmë me krijimin e një fondi të ri i cili quhet Fond rezerv për pjesën e rezervuar, i panevojshëm dhe në kundërshtim flagrant me Kornizën kushtetuese sepse një fond i tillë rezerv, ç'është e vërteta më i vogël se ky, ekziston në buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Të nderuar deputetë, ju falemnderit për vëmendjen që patët.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ministër, ju falemnderit për informatën e bollshme dhe të sistemuar mirë. Para se të fillojë debati, desha ta paraqes një informaciontë shkurtër për ata që nuk kanë qenë në dijeni ose kanë marrë materialin me vonesë.

Në kohën, siç u sollëm, ishte e paevitueshme dhe e nevojshme të takohej Parlamenti me Qeverinë. Të premtën patëm një takim shumë frytdhënës në Qeveri e ku isha i pranishëm dhe zoti Shatri si kryetar i Komisionit për buxhet. Në rrethana të tilla kur ekzistonte mundësia që të mos jetë as informacioni, minimal, valid për deputetët, u morëm vesh që menjëherë pasdite të premtën t'u shpërndahet materiali deputetëve, kurse Komisioni për buxhet dhe Ministria për financa të jenë në bashkëbisedim të vazhdueshëm dhe të nxjerret një dokument edhe nga ana e Komisionit për buxhet i Parlamentit të Kosovës, e të cilin sot e keni marrë.

Desha vetëm t'ju informoj se në rrethanat në të cilat është sjellë Parlamenti, që janë rrethana jashtë Kornizës kushtetuese, megjithatë, është meritë e Qeverisë dhe Parlamentit që sot të debatohet për buxhetin sepse ishte paramenduar një rrjedhë krejtësisht tjetër dhe të shpresojmë se do ta kemi një debat të mbarë.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Fjalën e kërkon profesor Sabri Hamiti, e pastaj kryetari i Komisionit....

SABRI HAMITI:

Zotri kryetar, kolegë deputetë të nderuar,

Dëgjuam me vëmendje paraqitjen shumë substanciale të ministrit të resorit dhe meqë ekspozea e tij jep shumë të dhëna për të menduar pak më thell dhe meqë materialet i kemi marrë pak me vonesë, mendoj se është mirë të bëhet një pauzë që grupet parlamentare dhe deputetët veç e veç të mendojnë për këto dy dokumente, bashkë me dokumentin që kemi nga Komisioni për buxhet, në mënyrë që të jetë shumë më i frytshëm bisedimi rreth buxhetit. Domethënë, edhe është e këshillueshme dhe praktike sot, në gjendjen çfarë jemi, të bëjmë një pauzë për konsultime të ndërmjetvetshme si deputetë veç e veç por edhe për grupet parlamentare. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Zoti Limaj e ka fjalën.

FATMIR LIMAJ:

Zoti kryetar, nëse vijmë deri te një pauzë mendoj se do të ishte mirë t'ia drejtoj dy pyetje ministrit të ekonomisë dhe financave.

Mendoj se është vendi këtu në këtë Parlament të shpjegohen gjërat qartë. Jo vetëm, në një mënyrë të prekën, por të thuhet komplet me adresë. Këtu po thuhet – "Projektpropozimi i buxhetit 2003". Unë kërkoj ta di, a është projektpropozim buxheti 2003 apo është diçka që vetëm ai ta marrë mendimin e Kuvendit të Kosovës, si një deklaratë, të debatohet dhe definitivisht kjo të jetë si e kryer. A mund deputetët e Parlamentit të Kosovës, me sygjerimet e tyre dhe debatet e tyre të intervenojnë në buxhetin e Kosovës dhe në këtë ligj të Kosovës? Nëse jo, atëherë mendoj se ky Parlament definitivisht duhet ta ndërprejë këtë komunikim sa për sy e faqe.

Mendoj se disa gjëra të cilat i prekët, duhet të adresohen ende më qartë e këto janë: gjërat rreth kompetencave, rreth draftit, rreth formës dhe mënyrës se si ka shkuar deri te miratimi i buxhetit të Kosovës. Dhe, nga pjesa e Kornizës kushtetuese, t'na paraqitni kompetencat e ministrisë përkatëse lidhur me buxhetin e Kosovës – cilat janë të drejtat e Ministrisë dhe Qeverisë së Kosovës? Ku është bërë shkelja e Kornizës kushtetuese; nga kush dhe njëkohësisht ju si Qeveri t'na jepni përgjegjësi pse futeni në shkelje të Kornizës kushtetuese, kur i keni kompetencat.

Këtu thatë, gjatë ekspozesë tuaj, se nuk kërkon miratimin e Kuvendit ky buxhet. Atëherë, pse të diskutojmë ne këtu. Nuk jam për atë që të dalim para qytetarëve tanë dhe të thomë se: ne shqyrtoam për buxhetin kur askush nuk e kërkon

mendimin ose vendimin tonë. Ose të shkojmë me atë që kanë filluar të tallen disa nga zëdhënësit e UNMIK-ut me Parlamentin e Kosovës. Ju keni parë dekaratat e tyre, nga takimi dhe seanca e fundit kur folëm për sistemin energjetik. Prandaj, unë mendoj që me Parlamentin e Kosovës nuk ka të drejtë askush të tallet dhe ne tek e fundit, si deputetë, duhet të dijmë mirë dhe të futemi në kompetenca që ne na takojnë dhe mendoj se gjatë kësaj pauze mundemi edhe si grupe parlamentare, por edhe ministri përkatës dhe kryetari i Kuvendit ta bëjmë një takim dhe të shohim vërtetë se çka vlenë e çka nuk vlenë të diskutohet dhe të dalim para Parlamentit e t'i theksojmë të gjitha mundësitë që i kemi, dhe jo ne të marrim përgjegjësi për një buxhet për të cilin s'kemi pasë kurrfarë të drejte, s'kemi dhënë kurrfarë propozimi dhe pastaj të legjitimohet në Parlamentin e Kosovës ku, në fund të fundit, as që kërkohet mendimi i tij.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Dugolli – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

BUJAR DUGOLLI:

Të nderuar deputetë, i nderuar kryetar,

Edhe ne pamë ekspozenë e suksesshme të ministrit por edhe këtë që dha Komisioni për buxhet. Mendojmë se çështjet janë shumë më serioze, shumë më problematike se sa po mundohemi t'i anashkalojmë në këtë mënyrë. Kam thënë, edhe në seancën e kaluar, se jemi mësuar vetëm të diskutojmë dhe të arsyetohemi para opinionit se: ne thamë v'allahi, por nuk po na lënë ta bëjmë! Unë mendoj se me këtë formë të diskutimit nuk mund të bëjmë kurrfarë ndryshimi të buxhetit në Kuvend. Përkundrazi, duhet shikuar se cilat janë problemet që po vijmë deri te kjo çështje. Mendoj se janë probleme shumë më të mëdha, shumë më fundamentale ato që Kuvendi duhet t'i zgjidhë këtu dhe t'i paraprijë këtyre çështjeve e mos të vijmë para aktit të kryer. Ne mund të takohemi dhe besoj se në pauzë do të takoheshim si grupe, por unë personalisht nuk do t'ia jap besimin këtij buxheti që e kanë bërë duke anashkaluar Kuvendin e Kosovës e që këtu duhet të diskutohet për të gjitha lëmitë dhe t'mos jemi në këtë mënyrë të pakënaqur. Po ashtu mendoj se esenca qëndron në aspektin politik. Ne nuk mund të shkojmë me këto kompetenca të rezervuara kështu më tutje, prandaj kjo praktikë vetëm për të diskutuar sa për sy e faqe duhet të ndërpritet. Duhet t'u paraprijnë gjërave për të hartuar një strategji tonën për aspektin e statusit final të Kosovës dhe ky është problemi ynë kryesor. Përndryshe, ato që i tha edhe ministri dhe Komisioni për buxhet janë të qëndrueshme por ndikimi ynë në këto rrethana, si Parlament, do të jetë shumë i vogël, për të mos thënë, pa kurrfarë ndikimi. Prandaj, si të tillë mendoj se duhet tek ke fundit ta stopojmë, ose pas një konsulte, ta dhëmë një mendim çfarë duhet t'i jipet këtij projektbuxheti dhe ta hartojmë strategjinë se ç'duhet bërë në seancën e ardhshme dhe më tutje. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Xhezair Murati.

XHEZAIR MURATI:

.....U svakom slučaju da stav poslanika ostalih zajednica se donekle podudara sa razmišljanjima o tome kako su nam evo i u ovoj branši ograničene i kompetencije, dakle nadležnosti. Svakako da, kada smo suočeni sa time, mi moramo na isti način u pauzi da iznesemo neko merodavnije mišljenje ovde pred ovim auditorijumom ali svakako ukoliko bude koncenzusa medju poslaničkim grupama. Ja mislim da možemo jedan zajednički stav o tome doneti, zbog čega ovaj auditorijum u svakom momentu je suočen sa odredjenim zidovima sa jedne i druge strane, ljeve i desne i tako dalje. U takvoj jednoj situaciji kada su nam nadležnosti malte ne evo sve više ograničene i mi nemamo velike kompetencije a onda moramo jedan zajednički stav da zauzmemo - kako izaći iz ovog kruga i da mi imamo jedan zvaničan stav o ovome o čemu sada govorimo a koji će biti sigurno meritorniji i detaljniji posle naše konsultacije do koje će doći u pauzi, kao što su i kolege prethodni govornici izneli. Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Do të ishte e preferueshme një pauzë e cila do të zgjaste deri në orën 13 me ç'rast, nëse e shohin të arsyeshme, grupet parlamentare ose udhëheqësit të takohen dhe debatojnë dhe të marrin qëndrimin e tyre, e pastaj të vazhdojmë rreth orës 13. A pajtoheni këtë propozim? Ju falemnderit.

(Vijoi pauza deri në orën 13,00)

(Pas pauze, Seanca vazhdoi punën)

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Të nderuar deputetë po vazhdojmë punën. Fjalën e ka Haki Shatri, nga Komisioni për buxhet.

HAKI SHATRI:

Komisioni për buxhet i Kuvendit të Kosovës, në mbledhjen e jashtëzakonshme, të mbajtur më 23. 12. 2002, shqyrtoi Projektregulloren mbi shpërndarjen e mjeteve

buxhetore për vitin fiskal 2003 dhe lidhur me këtë Kuvendit të Kosovës i propozon këtë:

R E K O M A N D I M

1. Parlamenti është dashur ta ketë rolin qendror në zhvillimin e draftrregullores.

Draftrregullorja është paraqitur pa përfshirjen e Parlamentit. Kjo nuk është në pajtim me Kornizën kushtetuese. Neni 5.1(b) i Kornizës kushtetuese thekson se Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes kanë përgjegjësitë në sferën e çështjeve fiskale dhe buxhetore. Neni 9.1.1. i Kornizës kushtetuese thekson se Kuvendi është përfaqësuesi më i lartë ligjor i institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes. Dhe, neni 9.1.11 thekson se Komiteti i buxhetit i Kuvendit do të ketë kompetencat e përgjithshme në çështjet financiare dhe buxhetore.

2. Dokumenti është dashur t'i dorëzohet Kuvendit si një projektligj dhe jo si një draftrregullore.

Sipas interpretimit të Kornizës kushtetuese nga Kuvendi, Projektregullorja është dashur të dorëzohet në pajtim me procedurat e aplikueshme, si një projektligj për Kuvendin, e jo si një draftrregullore. Dhe Kuvendi është i vetëdijshëm që do të kishte qenë e nevojshme që përmbajtja e projektligjit të koordinohet me PSSP-ën për t'u siguruar se është rrespektuar plotësisht autoriteti final i PSSP për të vendosur parametrat përfundimtarë financiarë dhe politikë, siç është paraparë me nenin 8.1(c) të Kornizës kushtetuese.

3. Kuvendi nuk pajtohet me ndarjen e buxhetit të rezervuar/IPVQ.

Lidhur me përmbajtjen e dokumentit, Kuvendi ka mopajtueshmëri fundamentale lidhur me strukturën e vet të buxhetit. Draftrregullorja ndanë buxhetin e Kosovës në tri pjesë “në buxhetin e fuqive të rezervuara”, “në buxhetin për IPVQ” dhe në “buxhetin për komunat”. Kuvendi është i bindur që krijimi i një buxheti të veçantë “për fuqitë e rezervuara” nuk ka logjikë, në kuptim të implementimit të praktikave më të mira buxhetore dhe kjo as nuk kërkohet, as nuk është në pajtueshmëri me Kornizën kushtetuese. Sipas Kornizës kushtetuese, PSSP-ia ka autoritetin për t'i vendosur parametrat finalë të buxhetit dhe për ta aprovuar buxhetin. Kjo draftrregullore i jep PSSP-ës shumë më tepër autoritete se sa kjo që u tha më lartë dhe vendosja e një “buxheti të veçantë për fuqitë e rezervuara” e përvijon sistemin buxhetor me autoritet të dyfishtë, për të cilin Kuvendi ka besuar se do të përfundojë

me shfuqizimin e AQF, e cila është pritur dhe dashur të bëhet deri në fund të këtij viti.

Kuvendi beson se duhet të ketë një buxhet të vetëm për autoritetet qendrore të Kosovës. Do to jetë një institucion i vetëm i Qeverisë, pra Ministria e Financave dhe Ekonomisë duhet ta ketë përgjegjësinë për zhvillimin e buxhetit. Ministria e Financave dhe Ekonomisë duhet të koordinohet dhe të marrë instruksione nga PSSP gjatë ushtrimit të autoritetit të tij përfundimtar për të vendosur parametrat e buxhetit. Projekti i buxhetit do t'i dorëzohej pastaj Kuvendit si një projektligj. Kuvendi do të koordinonte çfarëdo ndryshimesh që propozon Kuvendi me PSSP për të sigurua se ai pajtohet me ato ndryshime. Pastaj, Kuvendi do të aprovonte ligjin dhe do t'i dorëzohej PSSP-ës për dekretim.

Sa i përket implementimit të buxhetit përsëri këtë përgjegjësi duhet ta ketë një institucion i vetëm i Qeverisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Nëse gjatë rrjedhës së vitit fiskal do të ketë nevojë për rregullimin në buxhet këto do të koordinoheshin dhe aprovoheshin me procedurë të njëjtë, pothuaj sikur edhe nxjerrja e ligjit për buxhetin.

4. Problemet e përmendura më lart ritheksojnë nevojën për nxjerrjen urgjent të ligjit mbi zhvillimin dhe implementimin e buxhetit. Pra ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Është një dokument të cilin e keni marrë nëpër kutiat postale që është shpërndarë nga Qeveria dhe i cili është aprovuar nga Qeveria dhe do të duhej që sa më shpejt Kuvendi ta shqyrtojë dhe miratojë, sepse ai është bazë për të gjitha ligjet buxhetore vjetore që nxirren në periudhat e ardhshme.

Kuvendi shpreh qëndrimin e tij që të përshpejtojë punën për aprovimin e projektligjit mbi menaxhimin financiar publik, pasi që shumë nga problemet që u përmendën më lart nuk do të kishin ndodhur po qe se kishte qenë në fuqi një ligj i tillë. Nëse ligji do të kishte qenë në fuqi, rolet legjitime të Kuvendit dhe Përfaqësuesit special tashmë do të kishin qenë të përcaktuara qartë dhe do t' ishte vendosur orari për zhvillimin e buxhetit. Për më tepër, ligji do të qartësonte rolet e të gjitha palëve në procesin e zhvillimit dhe të implementimit të buxhetit.

Është një çështje shumë pragmatike. Në Komision dhe në strukturat tjera të Ministrisë së Financave dhe në Qeveri janë vërejtur disa shkelje nga ana e atyre që kanë përpiluar këtë drafttregullore dhe këtë projektbuxhet, ti cilat bijnë ndesh me syzjerimet e institucioneve financiare ndërkombëtare që na ndihmojnë.

5. Nga rishikimi pra i buxhetit të "fuqive" të rezervuara, pjesa e veçantë Kuvendi thekson se mbi 23 milion euro janë propozuar për t'iu ndarë AMK-ës dhe më tepër se gjysma e këtyre, ju keni shifrat aty, të parave do t'i alokohen kompleksit të Trepçës, diku mbi 12 milion. Kjo është plotësisht në

kundërshtim me këshillat e Fondit monetar ndërkombëtar sipas të cilave nuk duhet të ketë subvencione për ndërmarrjet publike dhe shoqërore.

Kuvendi pra kërkon edhe respektimin me forcë të rekomandimeve të institucioneve të specializuara ndërkombëtare. Me këtë formë, këtë dokument që iu ofrohet me titullin e Komisionit për buxhet e që është dakorduar edhe me institucionet tjera, kërkoj që ky Kuvend ta miratojë në formë të një rezolute dhe t'u dërgohet strukturave për komente dhe procedurë të mëtejshme. Ju falemnderit për vëmendje.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Zoti Shatri, ju falemnderit. Për debat është paraqitur Ramadan Kelmendi, le të përgatitet Fatmir Rexhepi. Mendoj se zoti Dugolli ka të drejtë, dhe vazhdimisht po e shiko, zoti Hamiti, ka ulur kryet dhe shkruan, zoti Limaj nuk ishte fare. Ju Dugolli tek tash u paraqitet prandaj plotësisht është me vend, në qoftë se keni mbajtur takim, grupet parlamentare do të ishte mirë që t'i paraqitnin qëndrimet. Prandaj, urdhëro zoti Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

Ju falemnderit zoti kryetar,

Grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, pas shqyrtimit gjatë pauzës të kësaj çështjeje, erdhi në përfundim se duke marrë për bazë vërejtjet që u dhanë nga Komisioni përkatës dhe nga Ministria e financave dhe vërejtjet tjera të shumta që patën deputetët këtu në sallë dhe që i kemi edhe ne si Grup parlamentar, do të ishin: Mitrovica i ka dy buxhete; Trepça ka buxhet më shumë se sa Trupat Mbrojtëse të Kosovës, duk marrë për bazë se Trepça në çfarë gjendje është tash dhe shkojnë ato mjete; pastaj "buxheti i rezervuar" që është 20% i kontrolluar nga Shtajneri, pa dhënë hollësi se ku e çon këtë buxhet dhe shumë çështje tjera problematike në këtë draftrregullore, ne si të tillë – Grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk e mbështet në këtë seancë plenare dhe kërkon nga Qeveria e Kosovës që të hartojë Projektligjin për këtë çështje duke marrë për bazë vërejtjet e Komisionit për buxhet dhe vërejtjet tjera të grupeve parlamentare dhe të deputetëve dhe, në seancën e ardhshme kurdo që mbahet kjo, ne ta dhëmë fjalën tonë. Nuk jemi për atë që ta mënjanojmë këtë nga rendi i ditës apo të heqim dorë, pasi që ndokush do të thotë: po përzihen në kompetenca. Ne jemi ata që këtë çështje duhet çuar deri në fund duke marrë nga Qeveria, jo në formë të projektrregullores, por projektligj për këtë çështje.

Prandaj, si të tillë, pas këtij shqyrtimi, pas vërejtjeve apo plotësimeve që do t'i japë Qeveria e Kosovës, shpresojmë që si Grup parlamentar do ta mbështesim. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Urdhëroni, zoti Hamiti a dëshironi fjalën?

SABRI HAMITI:

Unë mendoj se do të bisedojmë sigurisht për segmente të ndryshme të këtij projekti të buxhetit sepse jemi ne që me votë unanime kemi kërkuar këtë diskutim dhe kujtoj se kemi bërë fort-fort mirë që kemi kërkuar. Kemi përpara sot ekspozenë dhe një propozim në formë rekomandimi të Komisionit përkatës të buxhetit të Parlamentit tonë. Mendoj se diskutimi duhet të vazhdojë dhe për këtë kemi shansë, sepse ka çka të bisedohet në segmente të caktuara të propozimit të buxhetit.

Në anën tjetër, unë flas në emrin tim por tash edhe në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës – e mbështesim rekomandimin e Komisionit të buxhetit dhe e konsiderojmë shumë esenciale rreth problemeve më të rëndësishme që dalin rreth aprovimit të rregullativës përcjellëse edhe rreth projektit të buxhetit. Këtë do ta votojmë dhe si dokument i Kuvendi dhe le të shkojë deri te zyrat themelore që kanë përgjegjësitë ndërkombëtare për punën në Kosovë, në këtë rast, në këtë lëmi. Për tash kaq. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Urdhëroni zoti Limaj.

FATMIR LIMAJ:

Unë edhe në fillim të seancës paraqita çështje parimore. Pa dyshim, të bisedohet për këtë ligj është shumë me rëndësi, mirëpo para se të bisedohet duhet definitivisht të qartësohen disa gjëra në këtë Kuvend. Ne kemi hapur diskutimin, sepse vetë kemi kërkuar këtë çështje të jetë në rend të ditës. Shtrohet pyetja, – nga diskutimi që sot ne do ta bëjmë për këtë propozim ose këtë buxhet që na ka arritur - sa do të kenë ndikim deputetët e Parlamentit të Kosovës që këto vërejtjet dhe sygjerimet tona të gjejnë vend këtu. Kam përshtypjen se këtij Kuvendi ende nuk i është e qartë se çka në realitet po ndodhë jashtë Parlamentit të Kosovës. Dhe ne pothuaj në çdo ligj Parlamenti i Kosovës është sfiduar dhe unë si deputet dhe në emrin e Grupit Parlamentar nuk dëshiroj që ky Parlament vazhdimisht të sfidohet ose të bëhet objekt i talljes nga të tjerët. Prandaj, mendoj se ka ardhur koha ndoshta që ky Parlament ta nxjerrë Komisionin për të parë mirë dhe njëherit për ta bërë interpretimin e kompetencave në Kornizën kushtetuese. Këtu s'ka dilemë që ka

komplikim të kompetencave, ka mosqartësi të kompetencave, ka shkelje të kompetencave, marrje të kompetencave, tejkalim të kompetencave e s'di si ta quaj më. Prandaj, ndoshta është mirë që Parlamenti i Kosovës, në bashkëpunim me Qeverinë dhe me UNMIK-un dhe me ndonjë komision, të ulen e të definojnë qartë kompetencat e secilit organ veç e veç dhe neve këtu të mos na krijohen probleme të panevojshme dhe Parlamenti që ka nxjerrë sa e sa ligje, ato të mbeten në sirtarët e Përfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm, zotit Shtajner.

Bisedohet për buxhetin dhe punët janë kryer. Të gjithë jemi dëshmitarë që para dy javësh ose një muaj kemi dëgjuar përmes mjeteve të informimit, kemi dëgjuar edhe ministrin e ekonomisë e të financave, kemi dëgjuar edhe ministrat, edhe AQF-ën të cilët kanë thënë – ky është buxheti i Kosovës, është i miratuar, është i kryer, është i ndarë ashtu siç e kemi ne sot. Bile, po të mos ishte kërkuar në seancën e kaluar nga ne nuk do ta kishim as këtë që kemi sot para veti, sepse në këtë çështje edhe nuk llogaritet Kuvendi i Kosovës. Sipas tyre, nuk ka kompetenca. Prandaj, unë mendoj se nuk jam vetëm për të diskutuar këtu dhe për të krijuar opinion gjoja se Kuvendi i Kosovës miratoi buxhetin e Kosovës. Sepse, nëse ne do të futemi të diskutojmë pikë më pikë kjo do të mbetet... Unë mbështes rekomandimet e Komisionit për buxhet, megjithëse jam i bindur ... i tha zoti Shatri, dhe ne ishim të vonuar në mbledhjen e grupit, se as Komiteti për buxhet e financa nuk është involvuar në tërësi në këtë, si duket prej të premtës apo prej ndonjë ditë tjetër. Kjo tregon sa është serioze kur flitet për një buxhet njëvjeçar dhe komiteti për buxhet dhe financa vetëm dy ditë. Unë s'besoj as dy ditë nuk i kanë pasur të plota, dhe shqyrtohet buxheti! Nuk jemi injorantë. Sepse kjo praktikë do të ndiqet. Unë ia bëra disa pyetje ministrit dhe ministri i ekonomisë dhe financave është mirë të na paraqesë si ka shkuar çështja e hartimit të buxhetit me Autoritetin Qendror Fiskal, me përfaqësuesin zotin Shtajner dhe këtu këtij Kuvendi t'ia bëjë transparencën sepse janë organet e këtij Kuvendi, ky organ iu ka zgjedhë. Nuk mjafton të thuhet i përgjigjem Kuvendit. Duhet t'i përgjigjej këtu: Si ka shkuar komplet procedura e hartimit të buxhetit; sa janë marrë parasysh kërkesat tuaja; cila ka qenë influenca juaj në hartimin e buxhetit; kush e ka hartuar – në tërësi; si kanë shkuar propozimet e Qeverisë; a janë miratuar propozimet e Qeverisë; ku keni hasë në konflikt kompetencash; cilat kanë qenë sygjerimet tuaja dhe si nuk janë pranuar. Kush i cakton taksat në këtë buxhet? Kush mirret me caktimin e taksave doganore? A është për këtë Qeveria e Kosovës, a është ministria përkatëse apo është dikush tjetër. Pastaj, ndarja e buxhetit. Si është bërë ndarja e buxhetit në organet qendrore dhe ato komunale?

Për shembull, unë vërejtja gjatë pauzës që patëm, një çështje shumë enigmatike. Kur ndahen çështjet buxhetore, thotë: për energjetikën ka zero-zero. Çka është kjo. Si lejohet një segment aq i rëndësishëm. Flitet për energjetikën dhe buxheti thotë "00", domethënë - jepi sa të duash dhe ne këtu ta miratojmë! Kjo është shkelje ligjore. Bile-bile, më tepër se shkelje ligjore.

Ky ligj ka ardhur këtu dhe duhet t'na sqarohet mirë. Parlamentin dhe opinionin në tërësi nuk duhet ta gënjejë. A ka ardhur ligji pa lejen e Shtajnerit në Kuvend? Cili

është fati i këtij buxheti, në qoftë se Parlamenti i Kosovës e miraton apo hudhë poshtë? S'do ta nënshkruajë zoti Shtajner. Dhe, çka mbetet? Neve na mbeten këtu këto diskutime.

Prandaj, zoti kryetar dhe të nderuar kolegë deputetë,

Ne si Grup parlamentar kërkojmë që ky Kuvend të fillojë të diskutojë përmbajtësisht dhe mendimet e qëndrimet e tij që janë autoritative, janë mendime dhe qëndrime të qytetarëve që i përfaqësojmë këtu dhe momentin kur ne të votojmë të rrespektohen nga të gjithë. Ne nuk jemi që të futemi në gjërat të cilat edhe pse i votojmë pastaj të bëhen tallje dhe anashkalohen nga të tjerët.

Në emër të kësaj, kërkoj përsëri, të ndërtohet një komision për t'i qartësuar njëherë e mirë kompetencat e Kuvendit të Kosovës, të Qeverisë dhe të organeve të UNMIK-ut dhe pastaj ky Kuvend të fillojë përmbajtësisht të punojë dhe vendimet e qëndrimet e tij të jenë të pranueshme dhe të respektueshme nga të gjithë dhe njëkohësisht kërkoj nga ministrinë përkatëse të Qeverisë së Kosovës të jenë transparente në Parlamentin e Kosovës. Të jenë transparente e jo të vijnë dhe të thonë se jemi të zgjedhur nga ky Kuvend dhe se ne kemi votën tuaj dhe si t'na thoni. Dëshiroj komplet, procedura e këtij ligji të shpjegohet para Parlamentit si ka shkuar. Unë e di cilat janë kompetencat tuaja por është mirë këtu t'i thuhet Kuvendit dhe pastaj ky Kuvend të shprehë mendimin. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Murati.

XHEZAIR MURATI:

Mislam da smo čuli veoma razložno diskusije mojih prethodnih sagovornika kao i veoma argumentovano mišljenje odnosno stav Komisije za budžet koji je izneo predsednik, gospodin Šatri, čiji sam i ja član. Naravno da smo i mi poslanici ostalih zajednica u pauzi se sastali, razmenili mišljenja i doneli stav koji ću vam izneti ovde. Dakle, većina poslanika Bošnjačke, Turske, Romske, Aškalijske zajednice u pauzi je analizirala nastalo stanje povodom razmatranja predloženog budžeta za iduću godinu i mi smo saglasni sa primedbama Komisije za budžet na Nacrt pravilnika o budžetskoj raspodeli za 2003.godinu a s obzirom da smo gotovo svi podosta udaljeni od Prištine i u ovoj prilici nismo bili u mogućnosti da detaljno analiziramo dokument koji nam je ponudjen, što je i ovde pomenuto i od drugih kolega.

Pošto je isti problem i sa drugim zakonima i dokumentima, predlažemo da Skupštinska služba u buduće dostavlja svu poštu poslanicima u opštinskim centrima kako bi smo bili u mogućnosti da damo veći doprinos rešavanja problematike sa kojom smo suočeni.

I treçe, poslanici ove grupe smatraju da eksperti iz ovih zajednica nisu dovoljno uključeni u pripremi i izradi projekata zakona. Naročito smo nezadovoljni kontaktima sa najvišim predstavnicima UNMIK-a. Napomenimo samo na primer, da nismo imali nijedan kontakt sa gospodinom Štajnerom, koji je Specijalni predstavnik Generalnog sekretara i da je, ja mislim jedna manjkavost, koja bi trebala da se otkloni. Hvala. To sam ja hteo da iznesem.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit, zoti Murati. Ramadan Kelmendi, pastaj le të bëhet gati Fatmir Rexhepi.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë dhe ministra,

Dëgjova diskutimet rreth propozimit mbi buxhetin. Megjithatë, unë kam disa vërejtje konkrete dhe disa të përgjithshme.

E para, mendoj se buxheti i Kosovës po shqyrtohet me vonesë të madhe dhe ky material nuk mund të shqyrtohet sepse është dorëzuar me vonesë.

E dyta, buxheti i Kosovës për vitin 2003 duhet të bëhet në bazë të ligjit, u tha këtu, e jo të rregullores. Pasi që e kam përpunuar, po e citoj: Në propozimbuxhet për vitin 2003 nuk shihen shumat e tërësishme të buxhetit, çka do të thotë se nuk dihet sa janë të hyrat dhe të dalurat. Në buxhetin e propozuar nuk figurojnë të hyrat sipas kategorive nga të cilat përbëhet buxheti. Pra nuk figurojnë sa janë të ardhurat e buxhetit. Kishte me qenë e udhës që ne të kemi në shqyrtim llogarinë përfundimtare të mjeteve të shpenzuara buxhetore për vitin 2002. Duhet të dihet se nëse është shënuar suficit, pra nëse ka pasë tepriçë të buxhetit të vitit të kaluar 2002, pse nuk janë shfrytëzuar ato mjete dhe nëse nuk janë shfrytëzuar çfarë planifikohet me to.

Po ashtu, kemi edhe disa vërejtje tjera. Për shembull, në buxhet duhet të parashihet një shumë e cekur për rastet e fatkeqësive elementare, e tjera. Kisha edhe disa vërejtje por meqë u theksuan këtu, nuk dua t'i përsëris.

Do të jam konkret. Me këtë propozimbuxhet është paraparë: - për spitalin rajonal të Mitrovicës. Ju lutem spital rajonal të Mitrovicës nuk ka. Është spitali i cili administrohet nga serbët, ku nuk punon asnjë shqiptar nga ai vend, nga ajo qendër spitalore janë përjashtu 931 punëtorë shqiptarë. Të gjithë këta punojnë sot në shtëpinë e shëndetit në pjesën jugore në kushte të mjerueshme por janë për admirim për kontributin që dhënë. Nuk di se sa Qeveria dhe ne jemi të informuar me këtë. Këtë do të mund ta elaboroj edhe me fakte. Nëse këto mjete shkojnë në pjesën veriore do të jenë në duar të Millovan Jakshiqit i cili është drejtor i asaj

qendre. Se si do të distribuohen këto, ne mund të mendojmë dhe t'i thomë shumë gjëra të argumentuara. Shkojmë më tej. Flitet për minierën Trepça. Trepça dhe miniera nuk ka koncept. Është koorporata, komponata, organizata e punës së bashkuar e si doni "Trepça" e cila sot është e ndarë tri pjesë: pjesën veriore që e administron dhe udhëheqë Dinkiqi, pjesën jugore që e administron dhe udhëheq Mikullovcit dhe për ku janë dedikuar këto 12 milion euro, kur dihet se në pjesën veriore të Mitrovicës 2.160 punëtorë marrin paga nga Serbia dhe nga buxheti i Kosovës. Po ashtu janë të kthyer në punë 1.023 serbë, 982 shqiptarë, kurse kanë mbetur dhe janë të lajmëruar në entin për punësim, ku edhe unë punoj, 5.537 punëtorë të ish kombinatit "Trepça".

Nga kjo rezulton se 11.278 punëtorë shqiptarë bredhin rrugëve pa punë, kurse ndahen këto shuma të mëdha të mjeteve dhe për këtë do të ishte mirë të dihen Gjërat. Në kontekst të njëjtë janë mjetet prej 300.000 euro dedikuar minierave. Bëhet pyetje për cilat miniera: Laposaviq, Albanik apo cilat miniera do të ishte më e mirë...

Dhe, do ta shkurtoj. Të përmend diçka që është vërtetë edhe më drastike. Në Mitrovicë flitet për integrim. Me këtë buxhet, Mitrovica është e ndarë. Kemi buxhetin që i është dedikuar pjesës veriore dhe jugore. Të gjithë e keni materialin përpara dhe ne kemi një kryetar komune legjitim të zgjedhur nga votat dhe tani ky buxhet nga kush do të administrohet. Këtu figuron nga UNMIK-u.

Të gjitha këto janë probleme që vërtetë me rastin e aprovimit të këtij buxheti duhet t'i kemi parasysh. Megjithë vërejtjet që jipen dhe janë dhënë, Kosova duhet ta ketë një buxhet, por këto janë vërejtje shumë të mëdha që luhasin ligjshmërinë e këtij buxheti. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Fatmir Rexhepi, le të përgatitet profesor Arsim Bajrami.

FATMIR REXHEPI:

I nderuar kryetar, zonja dhe zotërinj deputetë,

Mendoj se Kuvendi i Kosovës duhet të diskutojë dhe të aprovojë buxhetin e Kosovës sepse është me interes për vetë financimin e institucioneve dhe shoqërisë së Kosovës, do të thotë të gjithë aktiviteve që janë në Kosovë. Sa i përket aprovimit të buxhetit, unë mendoj se në radhë të parë është dashur të jetë jo me 2 dhjetor, sikur që shkruan në materialin e dërguar, por me 2 tetor Qeveria e Kosovës të dërgojë projektligjin për buxhet në mënyrë që të kemi kohë ne si Parlament ta aprovojmë ligjin deri më 2 dhjetor, të jetë i nënshkruar dhe sot të debatohet vetëm për buxhetin në kuadër të asaj se si është përgatitur dhe si distribuohet buxheti.

Prandaj, meqë kjo nuk është bërë, mendoj se është çështje dhe vonesë e Qeverisë, e cila është dashur këtë ta bëjë. Rregullorja të cilën e ka dërguar Përfaqësuesi special këtu, atëherë është dashur dhe duhet ta mbështesim atë aneks të cilin e përmendi edhe kryetari i Komisionit të buxhetit. Por, në materialin që kemi marrë, para 2-3 ditësh, po ashtu mungon do të thotë pjesa e parë se si krijohet buxheti i Kosovës. Burimi potencial i të hyrave nuk figuron askund si dhe nevojat për donacione ose grantet për donacione në buxhetin e Kosovës sepse nuk është e lartë lufta që ka ndodhur dhe gjenocidi serb në Kosovë, pra 3 vjet dhe Kosova ende ka pasë nevojë që në buxhetin e vet të ketë donacione më shumë se ky 5%, që u tha këtu.

Një zhvillim shumë i vështirësuar ekonomik, pas kësaj që ka ndodh, një ekonomi e ndërmarrjeve, pra që janë 400 të cilat janë në procesin e transformimit dhe privatizimit, të cilat po vonohen, edhe ky burim potencial pra nuk ka mund të hyjë në Kosovë, pra janë faktorë të cilët japin argumente se është dashur të ketë grante më të mëdha në buxhetin e Kosovës. Po ashtu, në politikën fiskale që u përmend këtu e që nuk e kemi në materiale, të cilat i dëgjuam nga ministri dhe ekspozeu i tij, por do t'kishim mund të japim sygjerimet tjera, pra siç ishin shkalla e doganës, aktciza, tatimet tjera, përmbushje, si dhe taksave që do të hyjnë për rrugë, për shfrytëzimin e Aeroportit dhe të tjera. Në mungesë të kësaj ne duhet të flasim vetëm për pjesën e dytë apo diçka të veçantë që ka munguar këtu, ndoshta do të ishte mirë të jenë edhe të hyrat nga tatimi në fitim për disa kompani shumë interesante në Kosovë, pra të figurojnë diku siç është PTK, siç janë kompanitë e sigurimeve apo Aeroporti dhe të tjera. Kjo mungesë nuk na ka dhënë mundësinë që sot të japim vlerësime më të drejta lidhur me pjesën e parë.

Sa i përket shpenzimeve buxhetore dhe investimeve për hartuesin, kush është hartues u tha këtu, unë kam vërejtjet të ndara të cilat u cekën këtu e mos t'i përsëris por edhe vërejtjet tjera të ministritë, planifikimi për shpenzime të të ardhurave personale që janë shumë të mëdha e po t'i shiqojmë atje brenda numrat e të punësuarve në administratën qendrore nuk kemi ekonomizim, nuk kemi pra efikasitet në këtë qasje ndaj buxhetit prandaj ato shpenzime janë më të mëdha diku sesa në veprimtaritë tjera. Po të shikojmë materialin, për të mos marrë kohë, keni disa ministri ku numri i shpenzimeve për të ardhura personale për numrin e të punësuarve në administratën qendrore është më i madh, pra është diku 2 milion në një ministri kurse për veprimtarinë të cilës i dedikohen janë 1 milion e 900.000 euro, diçka e paqëndrueshme të cilën mendoj dhe s'e di që ka mundësi që ajo të ndërrohet. Kështu i keni 3-4 ministri përkatëse. S'po ua përmendi emrin por në materiale figurojnë.

Vërejtja ime është po ashtu se a është përfshirë edhe financimi i partive politike dhe këtë s'kam mund me pa këtu, përkundër propozimeve për ministrin. Ndërsa një dallim shumë i madh të investimet vetjake nëpër komuna. Po të merrni tabelën dhe të shikoni Prishtinën, Prizrenin, Pejën, Gjakovën, Ferizajin sa janë domethënë investimet vetjake, e shihni se Prishtina i ka 17% të hyrat vetjake në buxhetin e shpenzimeve totale, Prizreni 30%, Peja 38, Gjakova 20, Gjilani 30, Ferizai 23%. Një

krahasim: Prizreni ka për 131% koeficientin më të madh të hyrave vetjake sesa Prishtina në shpenzimet buxhetore të veta. Apo, për shembull, Peja 111 më shumë se Prishtina. Diçka e paarsyeshme sa i përket pikëpamjes sime, do të thotë, duke ditur potencialin ekonomik që e ka Prishtina. Prandaj, kjo ndarje në kuadër të kësaj çka është dhënë këtu, mendoj se duhet të ndryshohet, por a janë mundësitë - nuk e di.

Dhe, së fundi, po ashtu unë ndaj mendimin që suficiti i këtij viti për atë vonesë që e kemi bërë nga Ministria dhe nga kryetari i Kuvendit përcillet me kohë dhe 5 milion për terrmetin në Gjilan mos të vonohen dhe të jipen në fazën e parë të vitit të ardhshëm. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit, zoti Rexhepi. Profesor Bajrami e ka fjalën, le të bëhet gati Ibush Jonuzi.

ARSIM BAJRAMI:

I nderuari kryetar, të nderuar kolegë,

Unë nuk do të ndalem në pozicionet konkrete të buxhetit, por do të flas rreth asaj se në çfarë procedure dhe në çfarë kontesti po diskutojmë për buxhet. Do të ishte krejt normale për ne në Kuvend çfarë jemi ne që kjo çështje të diskutohet si çështje e rregullt, meqenëse baza ligjore që të diskutohet si çështje e rregullt ekziston edhe në vetë Kornizën kushtetuese e cila njihë përgjegjësitë e Kosovës dhe të Kuvendit të Kosovës për të diskutuar dhe të marrë vendime për buxhetin, duke mos kontestuar se autoritetet përfundimtar në këtë çështje është Përfaqësuesi special.

Do të ishte krejt normale që këtë debat ta fillonim diku në muajin nëntor dhe të kemi kohë që të diskutojmë dhe të kemi një ndikim edhe ne por ta fakturizojmë edhe Qerverinë e Kosovës e cila duhet të jetë krijuese e buxhetit. Jo vetëm ta marrë nga Përfaqësuesi special dhe Autoriteti qendror fiskal dhe të na njoftojë neve se nuk ka pasë mundësi ta bëjë por ajo të ketë një rol dhe ndikim që ta krijojë buxhetin aq më parë kur siç tha edhe ministri tani 95% e buxhetit mbushet nga burimet vendore. Në qoftë se ne mbushim buxhetin tonë, atëherë si është e mundur që ai të menaxhohet dhe të kontrollohet nga Përfaqësuesi special. Këtu nuk dua të lë anash edhe Kryesinë e Kuvendit. Kryesia e Kuvendit duhet të krijojë në agjendë më afatgjate të punës të Kuvendit e jo të takohet vetëm të martën dhe ta bëjë agjendën për të enjten. Dhe, në këtë agjendë serioze ajo duhet të përfshijë dhe është dashur të përfshijë edhe diskutimin për buxhetin meqenëse të gjitha parlamentet në rajon aktualisht diskutojnë për buxhetin. Muaji dhjetor është muaj në të cilin parlamentet kohën më të madhe e kalojnë duke diskutuar dhe miratuar buxhetin. Në këtë drejtim, mendoj se mungesa e një ligji që propozohet tani nga Qeveria është faktor limitues dhe ky ndoshta ka bërë që të mos kemi mundësi që vërtetë këtu të kemi

ndikim. Unë nuk di se nëse qoftë se shtyjmë këtë çështje, nuk e dijmë se çfarë procedure do të ketë, sepse nuk jam i sigurt se para vitit të ri do të mund të miratojmë ligjin e propozuar nga Qeveria. Po ashtu nuk di cili është efekti i vërejtjeve tona që do t'i japim nëse vënë para aktit të kryer dhe në qoftë se ky diskutim bëhet post festum, në qoftë se ajo çështje është prezentuar si e kryer dhe i është dhënë Parlamentit vetëm për t'ia bërë formën, vetëm për ta diskutuar, vetëm për të krijuar një arsyetim se edhe Parlamenti i Kosovës është konsultuar apo është pyetur për këtë çështje.

Sa i përket pozicioneve, dua të diskutoj vetëm për një pozicion e ai është pozicioni i mjeteve të dedikuara për çështjen e arsimit. Ministri na tregoi se ka një rritje por ajo rritje është shumë e vogël. S'e di, ndoshta ajo mbrrin 10%, derisa, po e zëmë, rritja për pushtetin lokal pothuaj është 100%. Si duket akoma do të vazhdojë në Kosovë të udhëhiqet një politikë e padrejtë ndaj arsimit. Akoma dëshirojmë të prodhojmë arsimtarë dhe mësues që do të jenë raste sociale. Ne i dijmë problemet me të cilat jemi ndeshur dhe në qoftë se ne duhet të pyetemi për arsimin atëherë seriozisht duhet të mendojmë që në buxhetin për vitin 2003 të parashohim një ndryshim substancial të pozitës së arsimtarëve në mënyrë që të mos ndeshemi përsëri me grevën dhe mos të bëjmë nën kërcënimin e grevës zgjidhje ad hok por të gjejmë një zgjidhje sistemore që sadopak do ta përmirësoj pozitën e arsimit në të gjitha nivelet. Aq më parë, kur tani arsimi kosovar në të gjitha nivelet ka hyrë në një proces të reformave dhe kjo reformë gjithmonë e ka çmimin e vet dhe ajo kushton. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Ibush Jonuzi, pastaj Hydajet Hyseni.

IBUSH JONUZI:

Zoti kryetar, Kryesi e punës, deputetë të nderuar dhe ministra,

Përshëndes ekspozenë e ministrit të financave e po ashtu përkrahu edhe rekomandimin e grupit respektivisht Komisionit për financa, por ç'më shtyri të diskutoj është pikërisht çështja e Trepçës, sepse këtu është dhënë një shifër prej 12.590 million eurosh. Mendoj se nuk është shifër për nënçmim por mirë ka qenë, sikur që u tha edhe më herët, të dihet destinimi i mjeteve për çka është menduar, a është menduar për investime të reja, a është menduar për rikonstruim, a është menduar për mirëmbajtje sikur deri tani dhe këto mjete mendoj se duhet të shfrytëzohen prej një burimi, jo si u tha, prej disa burimeve por pikërisht prej një burimi. Nëse ndokush duhet të ketë mirëkuptim dhe tolerancë në Kosovë atëherë duhet të kenë minatorët e Trepçës. Po thërras në atë aspektin e përgjithshëm sepse ata kanë bërë shumë, kurse sot i janë lënë në mëshirë kohës.

Dhe, çështja e dytë, gjithashtu që u debatua, shifra prej 300.000 eurosh, është “minierat dhe mineralet”. Nuk e kuptoj pse atje Trepça, e këtu “minierat dhe mineralet”, kurse që si tërësi është dashur të ketë shifër të përbashkët.

Dhe, çështje tjetër që më intereson, është çështja e kulturës. Mjetet që janë ndarë për trashëgimi kulturore, mendoj se është shifër shumë e varfër prej 300.000 eurosh. Po flas vetëm për Vushtrrinë. Kemi monumentet historike e kulturore të cilat i kanë mbetur në mëshirë kohës. Nëse nuk kujdeset Ministria respektivisht Qeveria e Kosovës dhe të gjitha organet shtetërore atëherë një ditë do të vijë që ato të jenë si rrënojë e asgjë tjetër. Pranaj, kemi obligim edhe ndaj monumenteve historike.

Dhe, krejt për fund, kam një pyetje për ministrin. Në bazë të cilës llogari është bërë ndarja e mjeteve nëpër komuna, kur në pesë komuna nuk dihet numri i punëtorëve të punësuar e është ndarë buxheti për vitin 2003? Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Hydajet Hyseni. Le të bëhet gati Xhevdet Neziraj.

HYDAJET HYSENI:

Të nderuar deputetë, kryetar e Kryesi,

Unë dua të shpreh keqardhjen për herën e dytë, pse ne detyrohemi të shqyrtojmë çështje të tilla kështu, me nguti t’i improvizojmë dhe disi post festum. Duhet t’ju informoj se në Kryesinë e Kuvendit këtë çështje e kemi shtruar shumë më herët dhe kemi kërkuar që të procedojmë me rregull. Nuk është bërë e mundshme. Tani droj se po bëjmë muhabet. Por, meqë e kemi nisur, le ta vazhdojmë.

S’dua të zgjas rreth kompetencave, por dua të përsëris edhe një herë atë që kemi thënë edhe më parë që t’i interpretojmë saktë ato kompetencat që quhen “të rezervuara” dhe ato që i janë përshkruar institucioneve të Kosovës dhe të mos lejojmë interpretim të njëanshëm që pastaj po na kushton shumë.

Një shikim edhe i përcipt i buxhetit të propozuar çon në përfundim se burimi kryesor i vështirësive dhe anomalive të shumta atje, është buxheti i vogël. Ku është kulaçi i vogël – ndaje si të duash, do të ketë të pakënaqur. Dhe, shtrohet çështja për të cilën s’kemi marrë asnjë herë përgjigje. A i kemi shfrytëzuar t’gjitha mundësitë për ta rritur qesen? Dhe, veçanërisht do të shtroja një pyetje këtu: Çka ka ndodhur me fondet e famshme të Kosovës, për të cilat njerëzit kanë dhënë vite të tëra e ne kurrë nuk jemi informuar ç’ka ndodhur me to. Do të dëshiroj t’ju përkujtoj ju se Kryesia e Kuvendit, në fillim të këtij viti, ka marrë një parashtresë lidhur me një pjesë të fondit të ish Qeverisë së Kosovës dhe kjo parashtresë i është bartur pastaj

Ministrisë për Financa dhe Qeverisë dhe ne kurrë nuk kemi marrë një përgjegje çka ka ndodh së paku me këtë pjesë të vogël të fondit të Kosovës. E vogël – e vogël, por megjithatë janë miliona.

Për pasojë, kemi këtë buxhet që kemi dhe kemi këtë ndarje që kemi. Unë nuk jam ekspert i fushës së ekonomisë dhe financave, por nga një shikim kështu të them, prej diletanti, kam vërejtur një fenomen të çuditshëm. Ka një rritje, në krahasim me buxhetin e vitit 2002 në disa zëra. Kryesisht në zyret e kryetarit të Kuvendit, e tjera, kanë madje rritje edhe dyfish – 200%, kurse ka zvogëlim apo rënie në disa sektorë që për mua janë shumë indikativë. Trupat e Mbrojtjes së Kosovës kanë rënie të ndieshme dhe Departamenti i Çështjeve Jorezidente dhe është fat që kemi këtu ministrin dhe e mbulon, s'di me rregull a pa rregull, këtë departament – mërgata. Dhe, për mua është shumë indikative.

S'kam çka të them për Trupat e Mbrojtjes së Kosovës, ju e dini këtë çështje sa është e ndieshme dhe e rëndësishme për të ardhmen e Kosovës. Por do të dëshiroja të ndalem edhe për çështjen e mërgatës. Është më së paku një e treta e popullatës së Kosovës jashtë. Përnga potenciali ekonomik e financiar, jo vetëm kaq madje, është më shumë se një e treta. Dhe ju e dini se Kosova nuk ka asnjë rrjet të përfaqësimit jashtë. Asnjë rrjet as të komunikimit me mërgatën tonë, përveç tjerash dhe në radhë të parë mbase, siç na është thënë disa herë, sepse nuk ka buxhet. Dhe do të duhej një buxhet fare i vogël që ne t'kishim përfaqësitë në vendet kryesore ku kemi gjithë ata njerëz dhe tani le të jetë të thuash rast edhe për reflektim për secilin prej nesh: A është më mirë që në të ndajmë para me arsye e paarsye, nëpër zyra e për ta rritur byrokracinë edhe ashtu të fryer, apo që të bëjmë megjithatë atë që është hendikep për Kosovën. Po të kujdesemi më mirë për mërgatën ne mund të sigurojmë edhe kushte pastaj që në formë adekuate edhe të rrisim buxhetin e Kosovës dhe ta gjallërojmë ekonominë e Kosovës me investime e forma tjera të angazhimit të potencialit të tyre.

Dhe, një çështje tjetër, veçanërisht e ndieshme për mendimin tim, është fakti se ne po bisedojmë për buxhetin pa pasë informacione elementare për buxhetin. Ne dijmë se praktikisht është aprovuar bilanci i buxhetit të vitit 2002 dhe ky buxhet duhet të jetë bazë edhe për ndërtimin e buxhetit të ardhshëm. Po ne na ndodhë e njëjta gjë në Kuvendin e Kosovës. Kuvendi i Kosovës do t'duhej të ishte edhe shembull i funksionimit të institucioneve tjera. Si Kuvend, ne kemi kërkuar disa herë në Kryesinë e tij që të kemi një informatë për buxhetin e Kuvendit. Kurrë nuk e kemi marrë! Tani shohim parametra të rinj, shifra të reja. Nuk e dijmë si janë bërë, në bazë të cilave analiza, në bazë të çfarë kërkesave, e tjera. Dhe, nëse në Kuvend ne nuk lejojmë transparencë e rregullsi, nëse nuk sigurojmë, më falni, transparencë a rregullsi, si mund të kërkojmë ne pastaj që të ndikojmë siç duhet edhe në institucione tjera të Kosovës.

Dhe, për fund. Do të dëshiroja që ne t'ishim të përgatitur për ta aprovuar një rezolutë dhe ajo rezolutë pastaj të kishte edhe fekte të duhura, por dyshoj se teksti që është sjell prej Komisionit mund të shërbejë si bazë për rezolutë. Shikojeni, ju lutem, përmbajtjen dhe do të shihni se do të jetë vështirë. Prandaj, nëse duhet të ndërtojmë qëndrime mendoj se na duhet një formë tjetër e harmonizimit të qëndrimeve midis grupeve parlamentare dhe eventualisht t'i harmonizonim qëndrimet. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Para se t'ia jap fjalën zotit Xhevdet Nezirajt, do t'lutja deputetët mos të katalizohen nga diskutimet e parafolësve. Ata që janë të përgatitur, nuk kemi asnjë përkufizim të debatojmë sot, nesër apo pasnesër, por jo duke dëgjuar njëri-tjetrin e të paraqiteni tash në vazhdimësi. Le të përgatitet pastaj Blerim Baruti.

XHEVDET NEZIRAJ:

I nderuari zoti kryetar, deputetë të nderuar,

Unë me vëmendje dëgjova ekspozëun e zotit ministër dhe pajtohem me sfidat që ballafaqohet ai. Mirëpo, mospërfshirja në kornizë Kosovën, sepse Kosova përveç identitetit kulturor e gjuhësor duhet ta ketë edhe identitetin e vet ekonomik, e që ka qenë një lëshim nga ndërkombëtarët dhe vendorët; mosnënshkrimi i Ligjit mbi tregtinë ende; me reduktime; mostransparenca e buxhetit dhe një kohë shumë e shkurtër e punës së buxhetit kur e dijmë se vendet shumë të zhvilluara ekonomikisht bëjnë përgatitje me 5-6 muaj lidhur me buxhetin – nuk diç se Kosova ku po shkon në pikëpamje ekonomike e ku zhvillimi ekonomik është një prej elementeve shumë të rëndësishme për Kosovën.

Lidhur me buxhetin dhe pjesën e rezervuar të buxhetit, nuk është e sqaruar se ku do të shkojnë këto mjete. Do ta sjell vetëm një pjesë nga komuna e Pejës, ku buxheti i vitit të kaluar është ndarë apo tentuar të ndahet në popullatën shumicë dhe në popullatën minoritare, kurse ajo pjesë në bazë etnike që e kemi kundërshtuar, është shfrytëzuar dhe buxheti i zyreve lokale, faktikisht vetëm për një grup etnik të cilin s'dua ta ceku këtu dhe do të thoja se buxhetet nuk duhet të ndahen në grupe të tilla etnike dhe nuk ka komunitet të privilegjuar apo komunitet më me qenie njerëzore se sa tjetri. Prandaj duhet përfshirë të gjithë dhe në këtë buxhet nuk duhet të bëhen këso lëshimesh. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Blerim Baruti, le të bëhet gati Besa Gaxherri.

BLERIM BARUTI:

I nderuar kryetar, e nderuara Kryesi, të nderuar ministra dhe deputetë,

Më lejoni që në kuadër të shqyrtimit të buxhetit për vitin fiskal 2003 të paraqesim edhe disa vështrime tona të cilat rrjedhin në bashkëpunim me kryeshefin e ekzekutivës së komunës së Mitrovicës, doktor Mustafë Pllana dhe ato do të jenë me pak qasje në disa vështrime.

Për sektorin e arsimit, është ky pozicion: Për pjesën e mallrave dhe shërbimeve buxheti, krahasuar me vitin 2002, është më i vogël. Ku qëndron shkaku i kësaj, athua pjesa tjetër e nevojshme do të mblidhet nga buxheti komunal nëpërmes të hyrave vetjake të komunës ose nga granti i ministrisë ku parashihen grantet kapitale për komuna, i paraparë në vlerë prej 2 milion euro, që janë në kuadër të subuencioneve dhe transfereve. Prandaj, rreth kësaj është mirë të qartësohet se cila do të jetë politika e shpërndarjes së këtyre granteve sipas komunave.

Për pjesën e Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit është kjo qasje: Rreth programit të rehabilitimit të rrugëve, shohim se aty si shpenzime kapitale parashihet vlera tyre diku rreth 1 milion euro. Ne sygjerojmë që kjo, nëse ka mundësi, të rritet për arsye se kemi edhe diç konkrete nga se Mitrovica është e interesuar për projektin e rrugës së filluar me karakter regjional, pra meremetimin e rrugës së Shëpolit dhe ku Mitrovica do të lidhet. Natyrisht se është një rrugë shumë-shumë e dëmtushme dhe e pakalueshme për transportin dhe për qytetarët e asaj pjese dhe natyrisht se bën pjesë në lidhjen e Kosovës me Malin e Zi dhe qendrat tjera të Kosovës e që ka një pozicion strategjik. Në këtë vit, nga kjo Ministri, është ndarë vlera prej 500.000 euro, në fillim premtim, kurse janë realizuar vetëm 300.000 euro. Ndërsa, nga Kuvendi Komunal, deri më tani, janë realizuar 400.000 euro. Vlera e përgjithshme e projektit është 1 milion e 440.000 euro. Pra kanë mbetur edhe 740.000 euro që duhet të realizohen. Në kuadër të kësaj kemi planifikuar që Kuvendi Komunal të participojë me 300.000 euro, ndërsa Ministria përkatëse me 300.000 euro dhe 140.000 euro do të jenë donacione të mbledhura nga komunitetet. Pra shpresojmë se gjatë këtij viti do të intervenohet dhe mundësia e rregullimit të kësaj rruge të realizohet.

Po ashtu, kemi qasjen për ministrin e kulturës, sportit dhe çështjeve rezidente dhe ë një vështrim se në çfarë përkujdesjeje do të jetë i planifikuar kujdesi rreth Stadiumit të vetëm Olimpik në Kosovë, i cili është në Mitrovicë dhe i cili është në dëmtim të vazhdueshëm. I vetmi Stadium në Kosovë që ka edhe shtegun e atletikës në nivelin olimpik.

Ndërsa, sa i përket Trepçës, ne shohim se 12 milion e 590.000 euro janë të dedikuara, mirëpo në kuadër të saj - mallrat dhe shërbimet janë 3. 590.000 euro, subuencionet dhe transferet 4 milion e 70.000 euro, shpenzimet kapitale 493.000. Nuk ka dedikime të caktuara. Po ashtu shohim se për minierat dhe mineralet janë të

ndara 300.000 euro, ndaras nga minierat e Trepçës. Këto a do të jenë për hulumtime gjeologjike e minerale apo për çka nuk e dijmë arsyen. Mirë është që të qartësohen se ku do të dedikohen. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Besa Gaxherri, le të përgatitet Flora Brovina.

BESA GAXHERRI:

I nderuari kryetar, të nderuar kolegë deputetë,

U fol mjaft dhe sipas mendimit tim, pas rezymesë së ministrit dhe rekomandimeve të Komisionit të buxhetit, si edhe të parafolësve, mua për veti më mbeti shumë pak për të shtuar për mangësitë që ka ky material lidhur me buxhetin. Për të mos marr kohë, unë për veten time përveç atyre vërejtjeve që dhanë parafolësit, kryesisht isha ndalur për shembull te suficiti. Dhe që të mos përmendi të gjitha, suficiti për shembull, Komisionit të buxhetit nuk i vjen së paku për 3 muaj të shqyrtohet dhe ta shohim ku shkojnë ato mjetet. Tani kur është rekapitulimi i mjeteve të buxhetit kurse ne absolutisht nuk dijmë për këtë vit të kaluar, ku ka shkuar ai suficiti, ku janë ato mjete dhe ku janë të shpërndara.

Dua të jam e sinqert, për këtë material që sot shqyrtojmë, jam e bindur se diku 70% të deputetëve sot e kanë marrë materialin. Sepse, edhe unë jam ndër ata që ka marrë sot këtë material, edhe pse të premtën paradite kam qenë në Kuvend dhe duhet të kemi parasysh se udhëtojmë nga 200 kilometra, dhe të udhëtojmë për një material deri këtu e të përgatitemi për seancën e sotme është e pamundshme. Unë për veten time edhe ashtu nuk jam aq e përgatitur për këtë çështje dhe këtë e ceku që edhe pse jemi vonuar, bile së paku materialet duhet të vijnë më shpejt dhe të njoftohemi me kohë me materialet e tilla.

Pastaj, për mendimin tim kemi ardhur në këtë situatë dhe jemi në një pozitë tepër të pasqaruar. Buxheti duhet miratuar, ligj për këtë çështje nuk kemi, Kuvendi nuk shqyrton rregullore dhe çfarë duhet pra të bëjmë. Për mendimin tim, të mos debatoh më tepër, nuk e shoh të arsyeshme të bisedojmë më tepër përveç asaj se t'i aprovoj më këto konkluzë që ka propozuar Komisioni i buxhetit dhe unë për mendimin tim nuk mund ta aprovoj këtë buxhet. Me keqardhje e them por vërtetë ka mangësi të mëdha. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zonja Brovina, le të bëhet gati Sabit Rrusterai.

FLORA BROVINA:

I nderuari kryetar, të nderuar kolegë,

Dola në foltore vetëm ta them një fjalë: “Kjo gjellë nuk ka kryp”. Domethënë, ne dijmë se jemi mbledhur jo për ta aprovuar ose mosaprovuar buxhetin për vitin e ardhshëm, por për të thënë se kjo “gjellë nuk ka kryp”. Ky buxhet për vitin e ardhshëm, po të shtrohej në diskutim, asnjë nga parlamentarët s’besoj që do ta votonin. Mirëpo, ne duhet ta themi fjalën tonë. Pajtohemi të gjithë me vërejtjet që u dhanë nga Komisioni për buxhet dhe kujtoj se këtu jemi mbledhur pikërisht për të diskutuar rolin tonë si parlamentarë dhe për të vërtetuar shkeljen e Kornizës kushtetuese në relacion Parlamenti dhe Korniza kushtetuese, kur është fjala për buxhetin.

Do ta marr një shembull, në një shoqëri ku 60% të popullatës janë të papunë; si shoqëri e dalë nga lufta dhe në transicion; ku çështjet sociale janë në rend të parë në krye të listave të problemeve; ku kemi një numër aq të madh të çështjeve ende të pazgjithura, për shembull mbrojtjen institucionale të familjeve të dëshmorëve, të invalidëve të luftës, të invalidëve të punës, të familjeve të personave të zhdukur e tjera e tjera, të cilat ende as nuk i kemi marrë në shqyrtim e ku për shembull vetëm në mbrojtjen sociale parashihet rritje e buxhetit për 12% e në anën tjetër rritja e administratës parashihet 15% - është e pakuptueshme. Prandaj, ky buxhet nuk do të aprovohej. Gjithashtu, është e pakuptueshme që buxheti lokal të shtohet në 56%. Prandaj, si përfundim, unë propozoj që të formojmë një komision për ç’gjë edhe parfolësi im propozoj e ky do të ishte komision për shqyrtimin e shkeljes kushtetuese në relacion me buxhetin dhe këtë propozim pasi ta diskutojmë në një mbledhje të ardhshme t’ia dërgojmë si raport Kofi Ananit, domethënë Kombeve të Bashkuara.

Megjithatë, kam edhe një vërejtje: Ne duhet ta pranojmë paaftësinë ose gabimin tonë që si Parlament nuk shtruam në rend dite para 3 muajsh ose edhe më herët këtë çështje, e pse u bë kështu, edhe Kryesia e ka fajin e vet. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Sabit Rrustemi, le të përgatitet ministri Behxhet Brajshori, e besoj s’ka më të paraqitur.

SABIT RRUSTEMI:

I nderuari kryetar, Kryesi, ministra dhe deputetë,

Më duket se edhe kësaj radhe po ndeshemi me atë fjalën popullore “hesapi pa hanxhiun”. Po shqyrtojmë buxhetin për vitin 2003 të Kosovës, me kërkesën tonë dhe ndoshta s’ është tepër për ta shprehur një shqetësim toni. Nuk jemi pyetur fare për këtë buxhet, dhe se sa që këtë ta kenë kërkuar përpiluesit real të këtij buxheti. Unë nuk di, një material që kam marrë sot, nuk e kam marrë të premtën sepse të premtën s’kam qenë këtu, nuk shoh asnjë shkresë përcjellëse qoftë nga zyra e zotit Shtajner, qoftë nga Kryeministri apo Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nga ato instanca që kanë mund të jenë të involvuara në këtë buxhet. Prandaj, ne s’na ka ftuar askush ta aprovojmë buxhetin, por ne kemi thirrur vetëveten që t’i shprehim shqetësimet dhe reagimet tona, pikërisht nga fakti se nuk jemi pyetur fare për këtë.

Prandaj, po të ishte biseduar realisht për çështjen e buxhetit, pajtohem do të ishte dashur të fillohet qysh para 2 muajve dhe të shkohet në ato forma procedurale që ministrinë përkatëse t’i përcjellin edhe propozimet e veta buxhetore nëpër komisione të Kuvendit në mënyrë që komisionet e Kuvendit dhe ne si deputetë të përgatitemi si duhet dhe të japim kontributin tonë në ato lëmi për çka jemi të thirrur, por kjo gjë nuk është bërë. Edhe sot, kur e bisedojmë këtë çështje, shihet se vërtetë jemi të varfër nga të gjitha këto aspekte. Në rend të parë, diskutimi për buxhetin do të duhej ta kishte komplet këtu Qeverinë e Kosovës, prej kryeministrit e deri te ministri i fundit e që fatkeqësisht nuk i kemi, me përjashtim të këtyre dyve, sepse kujtoj që për buxhetin e Kosovës nuk është i autorizuar vetëm ministri për ekonomi e financa por janë të gjithë ministrat bashkë me komisionet parlamentare të Kuvendit. Mirëpo, siç po anashkalohe mi shpeshherë si institucione vendore, edhe kësaj here jemi anashkaluar tërësisht nga ajo që ne realisht është dashur ta bëjmë. Prandaj, ky debat më tepër ka formë të një proteste se sa një kontribut që ne mund ta japim si kuvendarë.

Për t’u ndalur në gjëra tjera rreth këtij materiali, që thash e kam shfletuar me shpejtësi gjatë kësaj seance, do të përqëndrohesh vetëm te sfera që më tepër mund të jam i thirrur e kjo është çështja e kulturës. Pavarësisht prej asaj se tërësisht në këtë ministri shuma është jashtëzakonisht e vogël, te çështjet që janë të ndara në Departamentin e kulturës ose vetëm për zhvillimin e kulturës - shihet se për avancimin e kulturës, ne si Kosovë, ndajmë mjete përafërsisht sa mund të realizohet një film i mirë. Po them, përafërsisht sa mund të realizohet një film i mirë e jo një film që do të mund cilësohej shumë i mirë apo i shkëlqyeshëm. 300.000 euro për avancimin e kulturës janë pak edhe për një nga shtatë qendrat më të mëdha komunale të Kosovës, e lëre më për vetë Kosovën si tërësi. E njëjta gjë ndodh me trashëgiminë kulturore, por më tepër mbështeten institucionet për kulturë që kryesisht mund të jenë paga apo s’e di çka, ndoshta ministri do ta sqarojë këtë më tepër. Kurse më habit e dhëna, mua personalisht, çështja e administratës qendrore që kap një shumë bukur të madhe, diku 2 milion 150.000 euro. Atëherë, ne a

investojmë për administratë qendrore apo investojmë për kulturë dhe çështje që i përkasin kësaj ministrie, besoj kjo nuk do koment.

Prandaj, meqë nuk jemi të thirrur për ta aprovuar buxhetin dhe për të votuar, sigurisht vota ime do të mungojë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Udhëroni, zoti Behxhet Brajshori.

BEHXHET BRAJSHORI:

I nderuari kryetar, e nderuara Kryesi, të nderuar kolegë deputetë,

Nuk do të ndalem në ato çështje se sa jemi të autorizuar sepse mendoj që Parlamenti duhet të jetë i autorizuar dhe nuk ndalem në atë sa jemi vonuar në diskutimin e këtij dokumenti tepër të rëndësishëm për vendin, sepse dihet që jemi vonuar në këtë drejtim. Do të ndalem te pozicionet kryesore, sigurisht te Ministria që unë mbuloj dhe nuk do ta zgjas dhe kërkoj interesimin tuaj për një apo dy minuta.

Unë kam një kërkesë kështu të përgjithshme, jo vetëm për ne këtu në Parlament, por për tërë shoqërinë tonë, e më pastaj për Parlamentin, për Qeverinë, për ministrinë përkatëse e deri te Ministria jonë:

Absolutisht, nëse ne nuk ndryshojmë qasjen ndaj zhvillimit të kulturës nuk do të kemi zhvillim të kulturës. Nëse ne nuk ndryshojmë qasjen ndaj zhvillimit të sportit në Kosovë nuk do të kemi zhvillim të sportit dhe nuk do të kemi as qasje në hapësirën e gjerë ndërkombëtare të sportit. Nëse nuk merremi, në pikëpamje financiare flas në këtë rast, me problemet e rinisë, sigurisht se nuk do të kemi një rrjet të ndërtuar të qendrave rinore në tërë Kosovën dhe nëse nuk merremi më shumë me diasporën tonë, pra me forma të ndryshme të kontakteve, qoftë përmes zyreve të ndryshme, qoftë me kontakte tjera sigurisht se diaspora jonë natyrisht do të shikojë më me vëmendje ndaj Parlamentit dhe ministrive përkatëse në përgjithësi. Diaspora ka bërë shumë, por mundësitë financiare deri më tani vërtetë nuk premtojnë.

Unë do të bëj apel, edhe në pikëpamje financiare Ministria e Kulturës të mos jetë në renditje e radhitur e fundit, por të mos jetë po ashtu as me mjete financiare e fundit. Shumën të cilën kemi tash këtu të paraparë nuk është absolutisht më e madhe se sa që është në vitin 2002, kurse nevojat janë dukshëm më të mëdha. Këto mjete janë të parapara vetëm për paga, mallra, shërbime dhe për ndonjë investim të programeve të caktuara e jo për investime kapitale, për infrastrukturë e që është

nevojë shumë e madhe në Kosovë, qoftë në fushën e kulturës, qoftë të sportit, qoftë të rrjetit rinor në tërë Kosovën.

Pra, apelin e përgjithshëm e kam: si shoqëri ta kthejmë kokën dhe mendjen nga zhvillimi i kulturës sonë në Kosovë, nga zhvillimi i sportit në Kosovë, i problemeve të rinisë dhe diasporës e cila për kohë të gjatë dhe gjithmonë ka vazhduar bindshëm të.....përmirësohen. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit ministër. Zonja Shukrije, urdhëroni.

EDI SHUKRIU:

Ju falemnderit zoti kryetar,

Desha vetëm një çështje në parim. Po flasim për buxhetin, të gjithë jemi të vetëdijshtë se kemi Qeverinë, kemi ministrinë dhe të vetëdijshtë se nëpër ministri ndarjen e buxhetit nuk e ka bërë vetëm UNMIK-u apo si po mundohemi të paraqesim se nga ndokush tjetër varet si do të ndahen çështjet. Sa e dijmë, në secilën ministri kanë qenë kosovarët ata që kanë dhënë propozimet, si do të alokohen, të themi, në Ministrinë e Kulturës. Dihet si është korniza por si do të alokohet për promovimin e kulturës, apo për segmente të tjera. Unë shtroj një pyetje ashtu si ia kam shtruar edhe vetes deri tani si kryesuese e Komisionit për kulturë: Cilët përfaqësues të ministrive janë konsultuar apo kanë biseduar me parlamentarët, me komisionet përkatëse se si do të bëheshin këto ndarje të tilla. Sa di, një gjë të tillë, konsultime të tilla nuk janë bërë. Prandaj, mendoj se duhet një bashkëpunim dhe bashkëveprim i ministrive me Parlamentin që të mos vijmë në situatë e të diskutojmë për gjëra të caktuara për të cilat ne duhet të parapërgatitemi më parë. Ndodhin pra gjëra non sens, vetëm të përmendi themelimin e Institutit të Arkeologjisë, për ç'gjë arkeologët fare nuk kanë pasur dijeni. Pra duhet një bashkëpunim më i thellë ndërmjet kosovarëve. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit, zonja Shukriu. Ministri Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU:

Të falemnderit zoti kryetar,

Mendoj se u tha në mënyrë analitike dhe potencuan problemet për të cilat edhe unë isha i interesuar të diskutohen. Jam këtu vetëm për t'i dhënë 2-3 sqarime të shkurtëra. Buxheti për pushtetin lokal është shumë i avancuar dhe rezultat i asaj që për herë të parë bëhet bartja e përgjegjësive në sferën e arsimit parashkollor, të ulët dhe të mesëm. Bëhet bartje e mjekësisë primare dhe bëhet bartje e shërbimit të zjarrëfikësve. Pastaj, ky buxhet ka edhe një avancim, sepse për herë të parë startohet me tatimin mbi pronën, i vetmi tatim që iu dedikohet kuvendeve komunale. Mendoj se në raport me pushtetin komunal është punuar mjaft dhe është punuar mirë. Ju vetë jeni dëshmitarë se para disa ditësh u liçencuan apo certifikuan 24 komuna, kanë mbetur edhe 6 dhe shpresoj se afati i liçencimit edhe i tyre nuk do të jetë i largët. Është një hap shumë i madh, sepse kuvendet komunale, për herë të parë, do të kenë mundësi të menaxhojnë financat publike të nivelit komunal. Nuk do të habitem nëse nesër ndodh që arsimi, shëndetësia apo segment tjetër të ndryshojë komuna nga komuna. Kjo është një praktikë që zbatohet në vendet e zhvilluara e pse të mos ndodhë edhe te ne.

Sa i përket buxhetit të fuqive të rezervuara, unë ju thash se ai është bërë pa ndikimin tonë dhe ne i prezentuam komentet rreth atyre pozicioneve. Mos të harrojmë se me Kornizë kushtetuese Shtajneri ka autoritetin final për parametrat e përgjithshëm. Do të shkojë edhe kohë e gjatë dhe ai do të vendosë pozicionet që ndoshta neve nuk na konvenojnë.

Jam këtu për të dhënë edhe një sqarim tjetër për buxhetin e pushtetit qendror. Në ekspozitë time u mundova të reflektoj dhe t'ju bëj me dije se ka pasur shumë takime, shumë sygjerrime me të gjitha agjencitë shpenzuese, me të gjitha ministratë dhe fatmirësisht të them se Qeveria është një qeveri e marrëveshjes ku reflektojnë edhe ministrat e të gjitha grupacioneve, jo vetëm tri shqiptare por është edhe i nacionaliteteve joserbe dhe serbe dhe sa i përket buxhetit të pushtetit qendror, kanë qenë vendime të dhembshme sepse na janë dashur para të cilat nuk i kemi pasë dhe të lëmë shumë programe jashtë. Por, megjithatë, nga shuma që kemi pasur në disponim, në mënyrë racionale dhe unike i kemi prezentuar ato shifra dhe Qeveria qëndron prapa këtyre, qëndron edhe Komiteti për buxhet, sa e dij unë.

Ç'është e vërteta, për t'u quajtur buxhet i duhet ligji mbi përvetësimet buxhetore, gjë që ne nuk e kemi dhe nuk mund ta kemi derisa nuk e nxjerrim ligjin mbi menaxhimin e financave publike. Pse nuk është nxjerrë ai, unë e sqarova. Është në agjendë shqyrtimi në Kuvend, prandaj unë apeloj t'ju marr vëmendjen të gjithë juve që të përqëndrohemi në të dhe të nxirret sa më shpejt. Sikur të ishte ai i nxjerrur, dhe ne sot të bëjmë këtë diskutim që po bëjmë dhe dihet se ai ligj ka një ventil që e lë mundësinë edhe të kalimit jashtë vitit të ri për një muaj si mundësi që i kërkohet në këtë rast pjesës së rezervuar të jepë sqarime shtesë. Pse ai fond rezerv

... cilat janë arsyet, pse në Trepçë të shkohet ajo... Ndoshta mund të shkojnë edhe më shumë por ne nuk dijmë pse. Dhe, njëri këtu e potencoj dhe tha: për energji dy zero. Jo dy zero, zotëri. S'ka zero hiq, bardhë e kanë lënë. Bindja ime intimisht është se ka pasur tendenca të mëdha që aty të shkohet me një shumë shumë të madhe, siç ka shkuar përpara. Reagimet e para që sadopak janë bartë disa kompetenca kanë bërë që ai të mos mund të futet aty. Pse po e them këtë? Po e them këtë sepse është mirë të kemi vëmendjen se ndoshta dikujt që i intereson që edhe më tutje proceset t'i shtyjë ashtu siç janë shtyrë, i konvenon që Kuvendi të mos nxjerrë një vendim të urtë, e që unë kam bindjen se ka forcën dhe potencialin ta nxjerrë një vendim të urtë karshi sfidës me të cilën gjendet. Unë do të isha ithtar i atij rekomandimi që prezntoi Komiteti për buxhet - të miratohen dhe të shkojnë si një sinjal se cilët hapa duhet ndërmarrë në të ardhmen.

Ndërkaq, sa i përket pjesës tabelare, unë thash se është mendim i Qeverisë për pjesën e buxhetit qendror dhe komunal. E marrim përgjegjësinë dhe jemi të gatshëm të diskutojmë për të gjitha tjerat. Për tjerën, mund të kërkojmë por mos të harrojmë prap se ai mbanë të drejtën finale të nënshkrimit si të çdo ligji. Pra, nuk ka buxhet pa e pasë ligjin mbi përvetësimet buxhetore, mekanizëm që sqaron si përdoret ai buxhet, në çfarë forme. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Urdhëroni, shefi i Grupit parlamentar të LDK, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI:

Nuk do ta zgjas shumë, por nuk mund t'mos i them dy-tri fjalë, sepse herën më parë dola të sygjeroj çka do të bëjmë e këtë edhe si njeri dhe si deputet, kam të drejtë ta them mendimin tim. Unë dy herë, edhe atë ditë edhe sot kam dëgjua një fjali lapidare të ministrit, i cili ka thënë "dokumenti nuk kërkon miratim nga Kuvendi" që i bijke: mos të flasim kot. Megjithatë, unë kujtoj që edhe diskutimi dhe paraqitja sot e ministrit dhe diskutimi sidomos ky i fundit i tij, dëshmojnë që ka nevojë shumë të bisedohet në këtë formë dhe në këtë institucion për këto probleme. Sepse, inicimi ynë ka patur qëllim e ju e dini mirë, me orare s'dua të bisedoj, e din Kryesia, e din kryetari i Kuvendit, e dijmë ne si ka ndodh kjo. E dijmë dhe kemi përvojë çfarë ndodh kur t'qesin para aktit të kryer dhe t'bijnë në dy-tri ditët e fundit të vitit dhe të thonë: hajt bëni nëse keni ç'të bëni. Ne kemi dëshmuar dhe kujtoj është e dobishme që kot është të luhet loja në këtë formë. Sepse, ne duhet të japim mësim, jo për sivjet, por të japim mësim që Parlamenti do të marrë përgjegjësitë, tutje bile, të sivjetit po.

Këtu çfarë kam pa unë, nga evidenca që ka dhënë ministri ynë tregon një skemë që më bën përshtypje shumë: skifra e përgjithshme e buxhetit është 4.9 milion e tjera. E tash, të rezervuara janë: 13.7 milion tjera. Nuk e ka dhënë shifren fare sa janë

mjetet që i qeverisë organet e Kosovës, nuk ekziston. Ndoshta e ke shifren, por s'e ke dhënë ta dëgjojmë ne. Unë bëra shpejt një matematikë, i mbledha këto dyja, i zbrita prej tjetrës dhe më doli që organet tona i qeverisin përafërsisht 210... sepse kaq mbesin. Unë tash shtroj vetëm si problem këtu: mbi një e treta janë të rezervuara. Vetëm 5% i buxhetit krijohet me të dhëna, keni kujdes. Mua më intereson pse në një buxhet që mblidhet në këtë Kosovë që është 95% duhet një e treta të administrohet si çështje e rezervuar. Pse? Dhe pse plus të jenë edhe 11 milion të rezervuara për t'rezervuarit, plus? Kjo është çështje për të cilën duhet menduar mirë dhe të gjithë të mendojmë. Kjo mua më intereson.

Dhe e dyta, ne s'kemi pasur shansë të analizojmë në pika, por ja po nisem te Ministria e Kulturës. Unë kam parë atje që për Televizionin e Kosovës janë dhënë 2 milion e gjysmë sivjet dhe do të jipen 2 në vitin e ardhshëm. Dhe në të njëjtën ministri unë kam parë që të jipen më pak se 2 milion për kulturën. E le të mendojë edhe Ministria edhe ne të gjithë, edhe të mendojmë edhe për Televizionin që thotë është publik, thotë është i paanshëm, që s'merr financa – që merr financa nga Kuvendi, e që i ka marrë sivjet 2 milion e gjysmë, që i kërkon ose do t'i jipen 2 milion herën tjetër, plus ky Kuvend financon bile edhe Grupin për media, që quhet jopartiak, që duhet ta zgjedhë Kuvendi, por qe: – paret i merr prej Kuvendit. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Nëse shefat tjerë mendojnë të diskutojnë, mos të dalin fare. Në qoftë se kanë ndonjë rekomandim, le të urdhërojnë. Fatmir Limaj e ka fjalën dhe pastaj Dugolli.

FATMIR LIMAJ:

Ne diskutimin e kryem më herët, zoti kryetar, por s'jam i kënaqur me përgjigjen ose më mirë me thënë ministri i ekonomisë dhe financave nuk dha përgjigjen në pyetjen që ia bëra. Po ashtu, propozimin që bëra, ju, zoti kryetar, nuk e vëtë në procedurë të votimit. Ishte një propozim që do t'u ndihmonte, para se gjithash, juve por edhe neve si deputetë për të dalë nga një pozitë e tillë. Sepse, shtrohet pyetja dhe unë e kam si dilemë dhe po e bëj gajlen tënde se si do ta rrumbullaksosh tash këtë pikë të rendit të ditës. Sinqerisht është dilemë se si do ta rrumbullaksojmë këtë rend dite. Dhe, idea është e këtille. Mendoj se është momenti që ta bëjmë një gjë të tillë, ta ndërtojmë një komision, jo vetëm për ligjin për buxhet por kemi edhe shumë probleme që po na paraqiten. Unë e di se edhe udhëheqja e Kuvendit ka probleme të tilla në raport qoftë me Qeverinë, qoftë me Zyrën e UNMIK-ut. Dihet se kemi Komisionin për kushtetutë dhe legjislacion i cili do t'i definojë qartë kompetencat tona dhe, si e tha më herët edhe kolegu Hamiti, duhet ta kenë të qartë të gjithë se Parlamenti i Kosovës do t'i marrë gjërat në duart e veta dhe nuk do të lejojë që

vazhdimisht të dalë para aktit të kryer me këto veprime ose me anashkalimin e ligjeve ose me vonimin e nënshkrimeve të ligjeve për të cilat ka nevojë Kuendi ynë. Prandaj, mendoj se është e domosdoshme, të paktën unë mendoj, që propozimi ynë të paktën të votohet dhe i takon vetë Kuendit nëse don ta miratojë e nëse jo, atëherë është çështje tjetër.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit, a dëshiron ndokush tjetër fjalën? Urdhëroni zoti Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

Ne edhe një herë po përsërisim qëndrimin tonë: si të tillë nuk e përkrahim. Kërkojmë që Ministria e Financave dhe Qeveria t'na e dërgojë këtë në formë të projektligjit, sepse tek e fundit draftregulloren e UNMIK-ut as që kemi mundësi ta ndryshojmë, dhe në atë formë, shembull si projektligj i kësaj çështjeje, në seancat e ardhshme t'i jipet besimi në këtë Kuvend. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E tani të rezymojmë.

Unë mendoj se të gjithë diskutantët, në mënyrë të kondenzuar, kanë grumbulluar përvojat njëvjeçare të punës në Parlament dhe në Qeveri. E gjithë kjo tregon se institucioni i Parlamentit është në fund të rrugës njëkahëshe, në të cilën ka qenë i futur. Do të thotë, seanca e sotit është fund i praktikës së këtillë që vazhdimisht të neglizhohet ose të bjerë gjithmonë në pozicion që një orë apo një minut para 24-shit të reagojë. Megjithatë, vlerësoj se debati i sotëm është shumë më frytdhënës sepse shumica prej nesh, në këtë moment mendojmë dhe jemi të vetëdijshëm për shumë arsye. Kjo tregon përvojën njëvjeçare tonën edhe atë negative edhe atë pozitive. Thash, jemi në fund të rrugës njëkahëshe. Do të thotë, 2003-shi do të varet nga Parlamenti se cilat kahje do t'i marrë dhe nga ata që vazhdimisht po na vënë në pozicione të këtilla. Është një rekomandim i shkëlqyeshëm: serioziteti i debatit të sotëm, profesionalizmi dhe vullneti për të bashkëpunuar, por në mënyrë të duhur.

Po ju njoftoj se Ligji ka arritur në Parlament, por duhet t'i nënshtrohet procedurës dhe një ligj aq i rëndësishëm nuk ka mund të futet në debat para se të gjithë deputetët ta lem në dorë, ta shqyrtojnë dhe analizojnë. Prandaj, është në procedurë dhe është ndër ligjet më prioritare.

Dhe, formulimi i tretë, ju lutem. Ne kuptuam mesazhin që na është dërguar. Por këtë shansë e kemi ofruar vetë ne. Insistimi këmbëngulës i Parlamentit të Kosovës dhe përkrahja e fuqishme e Qeverisë së Kosovës, për çka meriton kompliment,

megjithatë e ka prurë në këtë gjendje dhe fazë të debatit. Do të thotë, nuk ka teori që edhe një buxhet i këtillë ta gjejë Parlamentin e Kosovës dhe institucionet në këtë gjendje.

Për këtë arsye, unë po formuloj dhe propozoj që: duhet të përkrahen konkluzat e Komisionit për buxhet, me një redakturë të qëlluar, në të cilën do të ndihmojnë katër grupet parlamentare, gjegjësisht kryetarët e grupeve parlamentare.

Kush është për këtë vendim, i lutem le të çojë dorën. Siç shihet, nuk ka nevojë të numërohen votat.

A ka ndokush kundër? Asnjë votë kundër. Ju falemnderit.

A abstenon ndokush nga votimi? Abstenon: një (1). Ju falemnderit shumë.

Votimi – Glasanje - Voted:

Për – Za – For.....	Të gjithë – Svi – All.
Kundër – Protiv – Against.....	00
Abstenuan – Uzdržanih – Abstained....	01

(D u a r t r o k i t j e)

Kryesia, në seancën e nesërme, do të vendosë për hapa të mëtejme, përkatësisht për caktimin e seancës së ardhshme të Kuvendit. Ju falemnderit edhe një herë për punë produktive.

Seanca përfundoi në orën 14,35.